

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI XII (XXVI) 2024, NR. 38 (191)

Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare

www.zaninalte.al

Tiranë, 2024

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI XII (XXVI), janar - qershor 2024 nr. 38 (191)

Nën kujdesin e: H. Bujar Spahiu

Drejtor: Dorian Demetja

Kryeredaktor: Andrin Rasha

Bordi editorial: Prof. Dr. Gjergj Sinani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër
Dr. Skender Bruçaj, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
PHD. Cand. Elton Karaj, Universiteti Bedër
H. Jusuf Zimeri, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut
MA. Ramadan Shkodra, Bashkësia Islame e Kosovës

Redaktor: Andrin Rasha
Mehmet Disha

Në anglisht: Redaksia

Zani i Naltë

Bordi shkencor: Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati
Prof. Asc. Dr. Saimir Shatku, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Prof. Asoc. Dr. Majlinda Peza-Perriu, Universiteti “Al. Xhuvani”, Elbasan
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Ana Uka, Universiteti Bedër
Dr. Agron Tufa, Zvicër
Dr. Ardian Muhaj, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike
Dr. Atakan Derelioglu, SHBA
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Ilirjana Kaceli, Universiteti Bedër
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, Universiteti Bedër
PHD. Cand. Hysni Skura, Universiteti Bedër
MS/MA Fatos Kopliku, Washington DC, SHBA
MA. Sabri Bajgora, Instituti për Hulumtë dhe Studime Islame, Prishtinë
Msc. Lorela Shehu, Universiteti Florida
H. Resul Rexhepi, Prishtinë
Xhemal Balla, Tiranë

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi / Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Erzen Carja

Fotoja në kopertinë: Medreseja e Tiranës, viti 1931

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50, Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al

Web: www.zaninalte.al

Përmbajtja

Editorial

1. Me rastin e 100 vjetorit të Medresesë së Tiranës, **Msc. Ndiriçim Gjimi, Drejtor i Medresesë Tiranë** 07

Filozofi

2. Në fillim ishte vetëdija, **Seyyed Hossein Nasr** 10

Studime

3. 100 vjet Medreseja e Tiranës (1924 - 2024), **Msc. Dorian Demetja, Drejtor i Kulturës - KMSH** 20
4. Roli i mektebeve në zhvillimin e arsimit shqip, **Mr. Habib Ebibi** 29

Sociologji

5. Trajtimi i çështjeve të familjes në gazetën “Drita Islame” (1992-2011) në aspektin edukativ, **Msc. Migena Jani** 44
6. Ndikimi i gjuhës së fesë në ndryshimet shoqërore, **Prof. dr. Muhamed Mustafi, Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup** 63

Jurisprudencë

7. Legjislacioni Shqiptar në lidhje me Komunitetin Mysliman, në vitet 1944-1967, **Dr. Denald Prifti** 73

Jurisprudencë islame

8. Poligamia në histori dhe në perspektivën islame, **Prof. dr. Bekir Topaloglu** 85

Histori

9. Ndikimi i reformizmit dhe iluminizmit të Hafiz Ali Korça, **Dr. Azmir Jusufi** 93

Personalitete

10. Haki Sharofi, Drejtor i Medresesë së Tiranës, Drejtor i Revistës “Zani i Naltë” 106

Retrospektivë

11. Randsi e martesës, **Ferit Vokopola** 110

- Abstracts in English** 114

- Rregullat e shkrimit** 122



Me rastin e 100 vjetorit të Medresesë së Tiranës

Msc. Ndiriçim Gjimi, Drejtor i Medresesë Tiranë

Abstrakt

Pavarësisht sfidave dhe ndryshimeve në rrugën e saj 100-vjeçare, Medreseja e Tiranës ka mbetur një qendër e arsimit të lartë dhe e ndërgjegjshme për nevojat e shoqërisë së saj. Ajo sot funksionon si gjimnaz i përgjithshëm, aktualisht me 329 nxënës, nga të cilët 75 janë në ciklin e mesëm të ulët dhe pjesa tjetër janë në arsimin e mesëm të lartë. Meqenëse ofrohet akomodimi si shërbim, nxënësit vijnë nga të gjitha trevat e Shqipërisë, duke e bërë atë një vatër ku kultura të ndryshme shkrihen për të krijuar një kulturë të amalgamuar që karakterizon çdo medresist që e përvetëson atë. Shkolla ka një infrastrukturë moderne, me klasa digjitale, me të gjithë laboratorët përkatës, me salla sportive, salla multimediale dhe sallë konferencash. Nxënësit e diplomuar nga kjo shkollë, në fund të shkollimit të tyre, janë të aftë të konkurrojnë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit... Suksesi i kësaj shkolle është kthyer në traditë; duke e bërë atë ndër shkollat më të veçanta, si për nga cilësia e mësimdhënies dhe nga arritjet e nxënësve.

Ky 100-vjetor shënon një moment të rëndësishëm për të reflektuar mbi kontributin e madh të Medresesë së Tiranës në historinë dhe arsimin shqiptar, si dhe për të shprehur respektin dhe vlerësimin për të gjithë ata që kanë punuar dhe kontribuar në këtë institucion gjatë dekadave.

Në vitin 1924, u hap një dritare e rëndësishme për arsimin dhe besimin në Shqipëri, u hap Medreseja e Tiranës. Sot, kur ky institucion shënon 100-vjetorin e tij, krenohemi me kontributin e

vyer që ka dhënë për shumë breza: në formimin e shumë intelektualëve, liderëve fetarë dhe akademikëve të njohur. Gjatë këtyre viteve, ajo ka qenë një frymëzim dhe pikë referimi për shumë breza të shkolluarish, ka shërbyer si një shkollë ku nxënësit

janë përgatitur jo vetëm për sfidat e një bote të ndryshme, por edhe për të ruajtur e promovuar vlerat e trashëgimisë kulturore dhe fetare.

Medreseja, duke qenë një nga institucionet arsimore më themelore, ka drejtuar dhe ndriçuar rininë dhe shoqërinë që nga viti 1924. Është fakt që shoqëria shqiptare, madje e gjithë bota, ka nevojë të pamohueshme për breza që mund të ndërthurin me sukses zemrën me mendjen, shpirtëroren me fiziken dhe fenë me shkencën.

Modeli i qytetarit që medreseja synon të ndërtojë, duhet të perceptojë shumë mirë botën në të cilën jetojmë, duke ndjekur teknologjinë më të fundit dhe të jetë i vetëdijshëm për shkencën e fesë, duke përfaqësuar praktikat morale islame në mënyrën më të mirë, ndërkohë që është i lidhur thellësisht me Krijuesin. Duke mos u dhënë pas kënaqësive tokësore, komoditetit ose luksit, por pas Zotit, ai do të punojë për të mirën e njerëzimit dhe do të mbjellë farën për një të ardhme të lumtur, duke qenë i ndershëm dhe i çliruar nga ndikimet e jashtme të modernizmit. I pavarur me të vërtetë nga çdo forcë tokësore, ai do të mendojë dhe veprojë lirisht, ndërkaq që liria e tij do të jetë në proporcion të drejtë me robërinë të Zotit, domethënë, sa më të robëruar ndaj Zotit, sa më të lidhur pas Tij, aq më të fuqishëm në personalitet dhe në jetesë të rrugës së drejtë.

Duke u mbështetur mbi arsyen, përvojën dhe ndërgjegjen, ky model qytetari kërkon përsosjen në çdo gjë, vënien në ekuilibër të kësaj bote dhe asaj që vjen më pas. Duke qëndruar i patundur në këto vlera të përjetshme, duhet të vështrojë gjithmonë të ardhmen dhe të ndriçojë errësirën që ka mbuluar botën.

Kurrë nuk do të jenë të kënaqur me dijet e tyre, ata vazhdimisht do të jenë në kërkim të dijeve të reja, dije për veten, natyrën dhe për Zotin. Me një këndvështrim të drejtë për kohën në të cilën jetojnë dhe për kushtet që i rrethojnë, me përkushtimin ndaj vlerave esenciale të tyre dhe me besimin më të lartë të Zotit, ata do të jenë në gjendje për të vazhduar vetëpërtëritjen.

Pavarësisht sfidave dhe ndryshimeve në rrugën e saj 100-vjeçare, Medreseja e Tiranës ka mbetur një qendër e arsimit të lartë dhe e ndërgjegjshme për nevojat e shoqërisë së saj. Ajo sot funksionon si gjimnaz i përgjithshëm, aktualisht me 329 nxënës, nga të cilët 75 janë në ciklin e mesëm të ulët dhe pjesa tjetër janë në arsimin e mesëm të lartë. Meqenëse ofrohet akomodimi si shërbim, nxënësit vijnë nga të gjitha trevat e Shqipërisë, duke e bërë atë një vatër ku kultura të ndryshme shkrihen për të krijuar një kulturë të amalgamuar që karakterizon çdo medresist që e përvetëson atë. Shkolla ka një infrastrukturë moderne, me klasa digjitale, me të

gjithë laboratorët përkatës, me salla sportive, salla multimediale dhe sallë konferencash. Nxënësit e diplomuar nga kjo shkollë, në fund të shkollimit të tyre, janë të aftë të konkurrojnë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Fakti që lëndët shkencore bëhen në gjuhën angleze, ka bërë që një pjesë e konsiderueshme e nxënësve të ndjekin studimet universitare jashtë vendit. Suksesi i kësaj shkolle është kthyer në traditë; duke e bërë atë ndër shkollat më të veçanta, si për nga cilësia e mësimdhënies dhe nga arritjet e nxënësve.

Ky 100-vjetor shënon një moment të rëndësishëm për të reflektuar mbi kontributin e madh të Medresesë së Tiranës në historinë dhe arsimin shqiptar, si dhe për të shprehur respektin dhe vlerësimin për të gjithë ata që kanë punuar dhe kontribuar në këtë institucion gjatë dekadave.

Ndërsa shënon këtë ngjarje të rëndësishme, le të përqafojmë trashëgiminë e Medresesë së Tiranës dhe të përkujtojmë angazhimin tonë të përbashkët për të ndërtuar një shoqëri më të arsyeshme dhe më tolerante për të gjithë!

Në fillim ishte vetëdija

Seyyed Hossein Nasr

Abstrakt

Mënyra sesi e shohim realitetin ka një peshë të drejtpërdrejtë mbi atë sesi ne jetojmë si qenie njerëzore. Për mijëvjeçarë të tërë, njerëzit kanë jetuar në një univers të mbizotëruar nga ideja e parësisë së vetëdijes përmbi gjithçka që është trupore dhe materiale. Ata bënë luftëra dhe vuajtën nga sëmundje, por jetuan në një botë që kishte kuptim dhe bukuri. Krijuan arte tradicionale prej një bukurie të pashoqe dhe jetuan kryesisht në harmoni dhe paqe me mjedisin e tyre natyror. Ata e dinin se kush ishin, nga vinin dhe se ku po shkonin. Mohimi i epërsisë dhe parësisë së vetëdijes, dhe fronësimi i një reduksionizmi në vend të kësaj, u ka dhënë qenieve njerëzore sundim më të madh mbi natyrën dhe disa rebati tokësore, ndërsa, afërmendsh ka krijuar siklete të reja. Ka kuruar shumë sëmundje, duke u çelur derën lëngatave të panjobura më parë. Dhe kjo është justifikuar si një udhë drejt paqes, teksa, paralelisht ka mundësuar luftëra me një shkallë dhune dhe pasojash vdekjeprurëse të paimagjinueshme për paraardhësit tanë të lashtë. Por mbi të gjitha, ka shkatërruar marrëdhënien harmonike, jo vetëm ndërmjet njeriut dhe Zotit dhe botës shpirtërore, por edhe ndërmjet njeriut dhe natyrës, duke lejuar krijimin e një shkence që nuk mbështetet mbi urtësinë, por mbi pushtetin dhe zbatimet e tij si një teknologji e re që ka fuqinë të shkatërrojë vetë rendin e jetës në tokë. Në nivelin individual, i ka zhveshur qeniet njerëzore nga kuptimi themelor i jetës dhe ka rrënuar shtëpinë që ata e konsideronin si universin e tyre të premtuar, duke i bërë qeniet njerëzore alienë brenda një botëkuptimi të skacuar nga vetë mendjet njerëzore.

Duke mohuar parësinë e vetëdijes, materializmi modern ka hedhur dyshim edhe mbi realitetin e pavdekësisë së shpirtit njerëzor dhe mbi jetën e përtejme... Përveç pasojave më tragjike për shpirtin njerëzor që i mohon realitete të tilla, dobësimi i besimit te jeta e përjetshme ka një pasojë të drejtpërdrejtë edhe në mënyrën sesi jetojmë në këtë botë, dhe në veçanti, në shkatërrimin e mjedisit natyror. Nëse jeta në këtë tokë është e vetmja që kemi, atëherë duhet të bëjmë gjithçka kemi në dorë për ta jetuar ekzistencën e kësaj bote në mënyrën më të plotë që mundemi...

Sikur ta prananim të vërtetën që “në fillim ishte vetëdija” dhe që “kjo është tani siç ishte në fillim”, nuk do të ndiheshim më si alienë në një kozmos të vdekur dhe armiqësor, si aksidente në një univers të pajetë... Marrëdhënia jonë me kafshët, bimët, madje edhe me botën e pafrymë, do të ndryshonte nga një realitet i mosmarrëveshjes dhe konfliktit, dhe i nevojës për kontroll dhe sundim, në një tjetër të karakterizuar nga harmonia dhe ekuilibri, me mundësi tejet më të larta të njohjes së ndërsjellë me më shumë qenie njerëzore nga sa mendësia e tanishme lejon.

Një i vetëm është Agu që rrezit mbi gjithçka është. Është Një i pashoq që veçmas bëhet gjithçka.

Rg-Veda, VIII, 58:2

[Tao] i paemër është fillimi i Qiellit dhe Tokës, [Tao] i emërtuar është mëma e 10 mijë gjërave.

Tao Te Çing, kap. 1

Në fillim ishte Fjala, dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi.

Ungjilli i Gjonit, 1:1

Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t'i thotë “Bëhu!” – dhe ajo bëhet.

Kur’ani, 36:81

Sa herë që u kthehemi shkrimeve të shenjta të besimeve të ndryshme, zbulojmë aty që, në çdo rast, origjina e kozmosit dhe e njeriut është identifikuar si një Realitet që është i vetëdijshëm dhe që, në fakt, përbën vetëdijen e kuptuar në nivelin më të lartë si Vetëdije absolute, e cila është transcendentë dhe megjithatë, burimi i të gjitha vetëdijeve të përveçme të sferës kozmike, përfshi tonën.

Për më tepër, formulimi “në fillim” kuptohet jo vetëm si përkatësi e së shkuarës, por edhe i çastit të tashëm që është e tanishmja e përjetshme. Kjo është arsyeja përse “në fillim” duhet kuptuar edhe si “në parim”, sikundër përkthimi latin i vargut hapës të Ungjillit të Gjonit shpall, “*in principia erat verbum*”. Qoftë kur flasim për Allahun që i urdhëron gjërat të jenë dhe ato janë, apo për Taon, apo për Fjalën, përmes të cilave të gjitha gjërat u krijuan, apo për Brahmën, ne po flasim për Vetëdije të së gjithëjetshmes dhe të së tanishmes, një e vërtetë kjo që bëhet veçanërisht eksplicite në Hinduizëm, ku Realiteti parësor, që është burimi i të gjitha gjërave, përshkruhet njëherazi si Qenësi, Vetëdije dhe Ngazëllim. Por as kjo njëzëshmëri e vizionit të Origjinës së gjithçkaje, siç identifikohet me vetëdijen, nuk mund të kufizohet te shkrimet e shenjta. Si filozofët orientalë edhe ata perëndimorë tradicionalë, flasin për të njëjtën të vërtetë. Kështu, *Agatoni* i Platonit nuk është vetëm Mirësia e Epërme, por edhe vetëdije e epërme e Mirësisë, ashtu si kuptimësia apo intelekti, me peshë kaq qendrore

në filozofinë greke, është sigurisht i pandashëm nga vetëdija. Filozofët islamë e konsiderojnë qenien të pandashme nga dija, dhe prej këtej, nga vetëdija, duke i konsideruar nivelet kozmike të ekzistencës edhe si nivele të dijes dhe vetëdijes. Sikurse nga pikëpamja e Hinduizmit për ekzistencën e diçkaje, qoftë edhe një gur është gjithashtu një gjendje e vetëdijes.

Dikush mundet që paskëtaj, me siguri të thotë që në botën tradicionale kishte dakordësi të brendashkruar rreth parësisë së vetëdijes në marrëdhënie me çka sot e quajmë “materie”. Realiteti i njohur nga të gjitha këto religjione dhe filozofi si origjina e gjërave, njëherësh kalimtar dhe rrënjësor, është, po ashtu, Vetëdije e Epërme, që mund të arrihet vetëm kur qeniet njerëzore janë në gjendje që të lartësojnë nivelin e tyre të vetëdijes. Edhe në Budizëm, i cili nuk flet për një Realitet Suprem objektiv dhe për kozmogjenezën siç kuptohet në religjionet abrahamike dhe iraniane, apo edhe në Hinduzëm, nirvana është gjendja e epërme e vetëdijes, dhe ngritja në nivelin e Budës, është, po ashtu, e pandashme nga vetëdija. Përjashtimi i vetëm ndaj këtij vështrimi unanim tradicional, në kohët e vjetra mund të haset në disa filozofi kundër-metafizike të antikitetit të vonë që shoqëronin agonitë e qytetërimeve helene dhe romake, si edhe ndër pak shkolla

margjinale të Indisë së lashtë, po ashtu, totalisht të kundërshtuara nga shkollat ortodokse të mendimit mbizotërues hinduist.

Privilegji i mohimit tërësor të parësisë së vetëdijes i mbeti botës moderne, veçanërisht në formulimin e filozofive materialiste dhe shkenciste që dolën në pah pas Revolucionit Shkencor të shekullit të 17. Shto këtu, që ky transformim nuk u jetësua para idesë moderne të materies – për të mos u ngatërruar me kuptimin e kësaj në filozofinë dhe shkencën helenistike – e shtjelluar me Dekartin dhe Galileon. Duke zhvatur nga ekzistenca trupore të gjitha aspektet e saj cilësore dhe duke e reduktuar këtë vetëm në sasi, personat në fjalë, të ndjekur edhe nga shumë të tjerë, krijuan një botëkuptim ku mund të ekzistonte diçka si materia vërtetësisht inerte, tërësisht e veçuar nga jeta dhe vetëdija, por në një farë mënyrë misterioze, gjithashtu e njohur nga subjekti njohës apo mendja. Bigëzimi Kartezian krijoi një dualizëm ndërmjet mendjes dhe materies, i cili e ka mbizotëruar mendimin perëndimor që nga shekulli i 17; një dualizëm që ka shpënë shumëkënd të zgjedhë parësinë e materies mbi mendjen dhe themelimin e një pikëpamjeje, sipas së cilës, në fillim ishte materia dhe jo vetëdija, edhe nëse disa prej këtyre njerëzve ende i qëndrojnë nocionit të një Zoti Krijues.

Mbizotërimi i këtij materializmi të supozuar shkencor, i cili, megjithatë, nuk është tërësisht i konfirmuar prej shkencës si shkencë, madje as prej pseudo-teologjisë apo filozofisë, mori vrull në shekullin e 19 me teorinë evolucioniste të Darvinit, e cila në vetvete është një ideologji në mbështetje të këtij të ashtuquajturit materializëm, sikurse edhe vetë e bazuar në të. Depërtimi i pikëpamjes që të gjitha gjërat e kanë filluesën nga materia, e cila pastaj evoluon në jetë dhe paskëtaj në vetëdije, sipas botëkuptimit mbizotërues në Perëndim, ka qenë e tillë sa pavarësisht refuzimit tërësor të këtij vrojtimi klasik rreth materies nga mekanika kuantike moderne, në arenën publike ende përvaret një bindje përkrahëse ndaj perspektivës materialiste që thelbësisht i redukton të gjitha gjërat në “materie”. Ky reduksionizëm është bërë pjesë thelbësore e mendimit modern, madje edhe e atij postmodern. Njerëzit mendojnë se është e mundur që diçka të kuptohet vetëm përmes analizës dhe shkërmoqjes së diçkaje në pjesët e saj “themelore”, të cilat janë [medoemos] materiale. Ata janë udhëzuar të besojnë që e tëra nuk është tjetër pos shumatorja e pjesëve të saj, dhe fizikanët vazhdojnë të qëmojnë identifikimin e grimcave elementare apo të njësisive ndërtimore të universit, të cilat, për publikun më pak të sofistikuar, mund të shëmbëllojnë topthat e

bilardos që duke u vendosur tok arrijnë të krijojnë të gjitha qeniet në univers. Mbi një perspektivë të tillë të mbështetur në reduksionizëm materialist, si jeta ashtu dhe vetëdija, shihen si epifenomene të faktorëve materialë, qofshin materie apo energji. Raporti tërësor ndërmjet vetëdijes dhe ekzistencës trupore është, si rrjedhojë, i përmbysur.

Në kozmologjitë tradicionale, Vetëdija e Kulluar, e cila po ashtu është Qenësi e Kulluar, zbret, duke mbetur transcendentë në Vetvete përkundër manifestimeve të Saj nëpër nivelet e ndryshme të hierarkisë kozmike për të arritur në botën fizike; kurse në pikëpamjen reduksioniste moderne, gjërat ngrihen nga çorba kozmike parahistorike. Edhe nëse ndonjë shkencëtar i përveçëm beson se një Qenie e vetëdijshme dhe inteligjente e bëri Big Bang-un të ndodhë dhe i dha fill kozmosit, sërish vetëdija nuk luan rol në të ashtuquajturin evolucion të kozmosit, që nga agregimi fillestar i molekulave dhe deri te shfaqja e qenieve njerëzore në planet. Sipas botëkuptimit tradicional, qeniet njerëzore kanë zbritur nga një sferë më e lartë e qenies dhe e vetëdijes. Ndërsa sipas perspektivës moderniste, kaq e përhapur në shoqërinë e sotme, ato janë ngritur nga poshtë. Këto janë dy pikëvështrime diametralisht të kundërta, njëra e mbështetur në parësinë e vetëdijes dhe tjetra në

parësinë e agjentëve, forcave dhe proceseve të pavetëdijshme dhe të verbra.

*
* *

Mënyra sesi e shohim realitetin ka një peshë të drejtpërdrejtë mbi atë sesi ne jetojmë si qenie njerëzore. Për mijëvjeçarë të tërë, njerëzit kanë jetuar në një univers të mbizotëruar nga ideja e parësisë së vetëdijes përmbi gjithçka që është trupore dhe materiale. Ata bënë luftëra dhe vuajtën nga sëmundje, por jetuan në një botë që kishte kuptim dhe bukuri. Krijuan arte tradicionale prej një bukurie të pashoqe dhe jetuan kryesisht në harmoni dhe paqe me mjedisin e tyre natyror. Ata e dinin se kush ishin, nga vinin dhe se ku po shkonin. Mohimi i epërsisë dhe parësisë së vetëdijes, dhe fronësimi i një reduksionizmi në vend të kësaj, u ka dhënë qenieve njerëzore sundim më të madh mbi natyrën dhe disa rehati tokësore, ndërsa, afërmendsh ka krijuar siklete të reja. Ka kuruar shumë sëmundje, duke u çelur derën lëngatave të panjohura më parë. Dhe kjo është justifikuar si një udhë drejt paqes, teksa, paralelisht ka mundësuar luftëra me një shkallë dhune dhe pasojash vdekjeprurëse të paimagjinueshme për paraardhësit tanë të lashtë. Por mbi të gjitha, ka shkatërruar marrëdhënien harmonike, jo vetëm ndërmjet njeriut dhe Zotit dhe botës shpirtërore, por edhe ndërmjet njeriut dhe natyrës,

duke lejuar krijimin e një shkence që nuk mbështetet mbi urtësinë, por mbi pushtetin dhe zbatimet e tij si një teknologji e re që ka fuqinë të shkatërrojë vetë rendin e jetës në tokë. Në nivelin individual, i ka zhveshur qeniet njerëzore nga kuptimi themelor i jetës dhe ka rrënuar shtëpinë që ata e konsideronin si universin e tyre të premtuar, duke i bërë qeniet njerëzore alienë brenda një botëkuptimi të skicuar nga vetë mendjet njerëzore.

*
* *

Le t'i shqyrtojmë më tej pasojat e zëvendësimit të parësisë së vetëdijes me realitetin parësor të materies apo të materies/energji, sipas perspektivës shkenciste moderne. Duke e parashtruar materien si bazën e të gjithë realitetit kozmik, dhe për shumëkënd si të vetmin realitet, është formësuar një reduksionizëm që e zvogëlon shpirtin në psikikë, psikikën në procese biologjike, jetën në veprimtarinë e agjentëve kimikë, dhe elementët kimikë në thërrmija fizike. Njerëzit vijnë të flasin për zbulimin e njëjësive ndërtimtare "themelore" të universit, të cilat mund të agregohen hap pas hapi, për të mbërritur deri te më të mëdhenjtë e profetëve, shenjtorëve, të urtëve, mendimtarëve dhe artistëve. Kështu, realiteti i niveleve më të larta të qenies shihet si asgjë më shumë sesa fenomenet që rezultojnë nga entitete dhe procese tërësisht materiale.

Jeta shihet si aksident dhe vetëdija si epifenomen i jetës. Universi përshkruhet si i “vdekur”, që do të thotë, pa kuptim, shpirt apo vetëdije. Për pasojë, qeniet njerëzore janë shtrënguar të ndihen si një ishull në mesin e një oqeani të pamat dhe kërcënues të përbërë prej materies së verbër dhe të vdekur. Ata nuk kanë një shtëpi në kozmos, siç e kishin paraardhësit e tyre, dhe ndihen të tëhuajtur nga gjithçka që nuk është njerëzore. Për më tepër, kjo tëhuajtje nuk ka të bëjë me tëhuajtjen e njeriut shpirtëror nga bota, siç kuptohet në besim. Dhe as që lidhet në çfarëdo mënyre me thënien e Krishtit, “Mbretëria ime nuk është e kësaj bote”. Kjo tëhuajtje e re ndaj botës, e cila vjen nga reduksionizmi shkencist, i përket një rendi krejt të ndryshëm. Burrat dhe gratë tradicionale e gjetën shtëpinë e tyre te Hyjnorja, por, po ashtu, ata njohën te kjo botë një sferë të sunduar nga Zoti dhe përplot shpirtra dhe frymë që u përkonin aspekteve të ndryshme të natyrave të përveçme. Ata kurrë nuk u ndjenë sikur ishin fillikat në një univers krejtësisht të verbër ndaj dëshirave dhe aspiratave të tyre më të thella. Format moderne të tëhuajtjes njerëzore, qofshin ato psikologjike apo shoqërore, burojnë nga izolimi kozmik i krijuar nga një botëkuptim që mohon parësinë e vetëdijes.

Qeniet njerëzore kanë nevojë për kuptim po aq sa kanë nevojë për ajër dhe ushqim. Reduksionizmi

materialist modern ka rezultuar jo vetëm në ushqim të prishur nga kimikatet dhe ajër të ndotur, por edhe në humbjen e kuptimit, sipas domethënies së tij rrënjësore. Në fakt, nuk mund të ketë një kuptim themeltar pa pranimin e së Gjithëmbarshtes në kuptimin metafizik. Është vërtet një paradoks i hatashëm sesi vetëdija njerëzore në kohët moderne ka ravijëzuar një këndvështrim të kozmosit që nuk ka hapësirë për vetëdijen. Dhe kur qeniet njerëzore rreken ta gjejnë vetëdijen në botën objektive, apo kur përjetojnë çka i quajnë takime me qenie të vetëdijshme jashtë sferës njerëzore, ato marginalizohen dhe sikterisen në kategorinë e burrave dhe grave haluçinuese që kanë nevojë për përkujdesje psikiatrike. Por, kur paraardhësve tanë u ndodhte të hasnin në engjëj apo edhe qenie të një natyre më modeste, atëbotë kur takime të tilla ishin të pranueshme brenda *Weltanschauung*¹-ut ku jetonin, ata nuk takonin “alienë” në domethënien moderne, dhe as që ndjenin nevojën që t’i konsideronin si të tillë. As nuk ndodhte që ata të marginalizoheshin si jonormalë në shoqëritë përkatëse. Dhe qeniet e vetëdijshme që takonin, për ta nuk ishin alienë. Mohimi i parësisë së

1. Mund të shpjegohet pak a shumë si perceptimi dhe kuptimi gjithëpërfshirës i botës nga një pikëpamje specifike, përfshi këndvështrimin vetjak të një individi apo atë të një bashkësie/kulture të përveçme.

vetëdijes, njëherazi në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, ka rezultuar në desakralizimin e natyrës dhe në zhgradimin e saj në diçka që thelbësisht është thjesht një “gjë”, mall që qeniet njerëzore e përdorin sipas nevojës. Përkujdesja për natyrën u shndërrua në përdhunimin e saj, teksa këndvështrimi mbizotërues mbi natyrën u bë përherë e më shumë shpërfillës ndaj cilësive të saj shpirtërore, ndaj misterit të saj, ndaj harmonisë dhe bukurisë së parëlindur të saj. Gjithë ato aspekte të natyrës, të kremtuara përgjatë shekujve nga të urtët, shenjtorët, poetët dhe artistët, u subjektivizuan dhe u paraqitën sikur të ishin objektivisht joreale. E shndërruar në mall për t’u përdorur nga grykësia përherë e më lakmitare e njerëzimit modern si konsumator, ekosistemi natyror shpejt filloi të vuajë, duke çuar te kriza mjedisore që tani kërcënon ekzistencën e jetës në tokë. Edhe në ditët tona, pak janë ata që duan ta pranojnë marrëdhënien e drejtpërdrejtë mes vrojtimit materialist të natyrës dhe shkatërrimit të saj në atë shkallë të paprecedente që sot e hasim kudo në glob.

Botëkuptimi materialist dhe mohimi i parësisë së vetëdijes kanë pasur një peshë të drejtpërdrejtë edhe mbi dobësimin e normave dhe praktikave etike. Ndër gjithë njerëzimin mbarë, moraliteti ndërli dhej me besimin dhe një botëkuptim filozofik ku e mira dhe e

keqja, e drejta dhe e gabuara, mbanin një dimension sa kozmik edhe njerëzor. Mund të shquajmë shembuj të qartë të kësaj marrëdhënieje jo vetëm ndër fetë abrahamike, por edhe në Hinduizëm, Konfucioanizëm, Budizëm dhe Zoroastrianizëm. Etika është kurdoherë e lidhur, në një mënyrë apo tjetër, me metafizikën. Duke mohuar parësinë e vetëdijes në favor të materiale, paradigma moderne ka dobësuar suazën objektive të etikës njerëzore, jo vetëm duke marginalizuar dhe dobësuar besimin, por edhe duke e reduktuar kozmosin në një realitet tërësisht “material”, ku e mira dhe e keqja nuk kanë më shumë kuptim nga sa mban bukuria. Sipas Galileos dhe Dekartit, të gjitha këto kategori zbresin poshtë në sferën subjektive dhe syrgjynosen larg realitetit objektiv. Kësisoj, etika është dobësuar sa herë që ky botëkuptim ka lulëzuar, ndërsa në anën tjetër, etika e sekularizuar që mbështetet mbi një këndvështrim kaq të cunguar të realitetit, nuk ka qenë asnjëherë e aftë që të fitojë çfarëdo mbështetjeje përfaqësuese. Për më tepër, e gjitha kjo ndodh në një kohë kur qeniet njerëzore kanë nevojë urgjente për etikë mjedisore, e cila do të kishte kuptim jetik për pjesën dërrmuese të familjes njerëzore, shumica prej të cilëve ende e identifikojnë etikën me Zotin dhe me ligjet dhe mësimet e shenjta të besimeve të ndryshme. Dhe as nevoja për etikë nuk kufizohet

te mjedisi. Është, gjithashtu, me rëndësi të skajshme që t'i japim theks të shtuar etikës në marrëdhëniet mes qenieve njerëzore në një kohë kur, falë teknologjisë moderne, armët e luftës dhe konfliktet janë bërë vdekjeprurës në një shkallë që sfidon imagjinatën.

Nëse në fillim ekzistonte vetëm çorba e molekulave, atëherë edhe zjarrmimi i dëshirave dhe përndritja e aspiratave tona më të thella, kuptimet tona të dashurisë, të së bukurës, drejtësisë dhe mirësisë nuk janë tjetër veçse gjendje subjektive efemere të shkaktuara nga forca të verbra evolutive, ndërsa e vërteta ka kuptim vetëm kur përcaktohet brenda një suaze operationale. Ajo që e konsiderojmë si humanizmin tonë nuk është tjetër veçse një iluzion. E vërtetë është vetëm çka përjetojmë prej botës së jashtme, e parë kjo si një sferë entitetesh dhe forcash materiale në ndërveprime dhe procese të llojllojshme që janë krejtësisht shpërfillëse ndaj humanizmit tonë. Të mohosh parësinë e vetëdijes është faktikisht të konfirmosh, me apo pa dashje, çnjerëzoren tonë, dhe të pranosh që gjithçka që peshojmë ndër elementët më të thellë të mendimeve, emocioneve, apo të vetë realiteteve tona shpirtërore, është thelbësisht iluzore dhe joreale, duke qenë subjekt i reduktimit në faktorë dhe forca materiale. Që do të thotë t'i dorëzohemi gjendjes nën-njerëzore, të cilën faktikisht e shohim

të shfaqet, sigurisht joaksidentalisht, në një shkallë të shtuar brenda rendit njerëzor, teksa e njëjta po e zvarg njerëzimin me shpejtësi përherë e më të madhe drejt humnerës.

Nëse vetëdija në kuptimin e saj më të lartë nuk është alfa e ekzistencës kozmike dhe njerëzore, atëherë nuk mundet, nga një domethënie metafizike, të jetë as omega. Duke mohuar parësinë e vetëdijes, materializmi modern ka hedhur dyshim edhe mbi realitetin e pavdekësisë së shpirtit njerëzor dhe mbi jetën e përtejme. Në Perëndimin e sotëm, edhe shumë ndër fetarët nuk i marrin seriozisht realitetet eskatologjike. Përveç pasojave më tragjike për shpirtin njerëzor që i mohon realitete të tilla, dobësimi i besimit të jeta e përjetshme ka një pasojë të drejtpërdrejtë edhe në mënyrën sesi jetojmë në këtë botë, dhe në veçanti, në shkatërrimin e mjedisit natyror. Nëse jeta në këtë tokë është e vetmja që kemi, atëherë duhet të bëjmë gjithçka kemi në dorë për ta jetuar ekzistencën e kësaj bote në mënyrën më të plotë që mundemi. Për shumicën, një jetë e tillë nënkupton hedonizmin dhe konsumerizmin në atë maksimum që rrethanat e lejojnë. Ndopak agnostikë mund të mjaftohen me “jetën e mendjes”, por për shumicën e njerëzve, humbja e frikës ndaj gjendjeve skëterrore dhe e shpresës për parajsën, rezulton në yryshin e pasioneve të tyre sensuale dhe

në përmbushjen e lezeteve, të cilat më vete, rezultojnë në pritshmëri edhe më të mëdha për “përfitime” materiale nga mjedisi përreth, gjithashtu me pasoja katastrofike për botën natyrore si edhe për faktorin njerëzor brenda asaj bote. Pasojat e humbjes së vizionit të origjinës së Shenjtë të kozmosit dhe mohimi i parësisë së vetëdijes janë kaq të shumta dhe të larmishme sa nuk mund të përmenden këtu. E megjithatë, kundërshtia ndaj kësaj qasjeje është aq e fortë brenda kalasë së paradigmes së shkencizmit modern, sa edhe argumentet shkencore mbi skicimin inteligjent të universit – kjo sigurisht duke nënkuptuar parësinë e inteligjencës apo vetëdijes – hidhen poshtë në mënyrë dogmatike nga shumë priftërinj të lartë të pseudo-religjionit të shkencizmit. Pavarësisht kësaj situatë negative, e vërteta e parësisë së vetëdijes duhet shpallur kurdo dhe kudo që bëhet e mundur. Dhe ka shenja që përherë e më shumë njerëz mendjehollë po zgjohen nga “dremitja dogmatike” për të rrokur këtë të vërtetë.

Nëse e vërteta e parësisë së vetëdijes, në një kuptim kozmik dhe ontologjik si edhe mikrokozmozologjik, do të rikonfirmohet dhe pranohet sërish në një shkallë të gjerë në botën bashkëkohore, jeta njerëzore do të ndryshonte cilësisht, dhe shumë prej pengesave me të cilat njerëzimi

përballet, do të largoheshin. Jeta njerëzore do të kishte kuptim përtej gjendjeve kalimtare psikologjike dhe përvojave jetëshkurtra ndijore. Jeta njerëzore do të rifitonte edhe aspektin e gjithëmbarësisë që çdo religjion beson që e përmban në thelbin e vet. Arsyeja e shenjtërisë së jetës njerëzore do të bëhej e qartë, dhe natyra e shenjtërisë do të kishte një bazë ontologjike në vend se të ishte thjesht e vetëm sentimentalizëm siç është sot, parë në kontekstin e një këndvështrimi strikt shkencist. Dhe aluzionet për përjetësinë do të njiheshin si realitet i pamohueshëm, në vend që të vrojtoheshin si një dëshirim shpresëmirë sentimental që shpesh vjen i ndërthurur me dyshimin. Sikur ta prananim të vërtetën që “në fillim ishte vetëdija” dhe që “kjo është tani siç ishte në fillim”, nuk do të ndiheshim më si alienë në një kozmos të vdekur dhe armiqësor, si aksidente në një univers të pajetë. Kërcënjë nga të qenët alienë, do të ndiheshim sërish në shtëpinë tonë brenda kozmosit, ashtu si burrat dhe gratë tradicionale përgjatë epokave pararendëse. Marrëdhënia jonë me kafshët, bimët, madje edhe me botën e pafrymë, do të ndryshonte nga një realitet i mosmarrëveshjes dhe konfliktit, dhe i nevojës për kontroll dhe sundim, në një tjetër të karakterizuar nga harmonia dhe ekuilibri, me mundësi tejet më të larta të njohjes së ndërsjellë me

më shumë qenie njerëzore nga sa mendësia e tanishme lejon.

Më në fund, do të rifitonim dimensionin kozmik të ekzistencës sonë. Vlerat tona më të thella, tërheqja dhe gjakimi ynë ndaj së bukurës, paqes dhe drejtësisë, dhe përvoja e vetë dashurisë në të gjitha nivelet, nuk do të shiheshin më si thjesht gjendje subjektive të zbrazëta nga çfarëdo realiteti objektiv, por përkundrazi, si përkatësi të realiteteve kozmike dhe thelbësisht metakozmike. Dhe veprimet dhe normat tona etike, krejt larg mbështetjes vetëm në standarde të vendosura nga vendime dhe marrëveshje thjesht e vetëm njerëzore, do të njiheshin brenda rendit të origjinës së tyre hyjnore dhe të shkëmbimeve kozmike, dhe si shumë më reale sesa thjesht akomodime të volitshme të krijuara nga shoqëritë njerëzore për hir të mbijetesës apo interesave vetanake. Nëse qeniet njerëzore nuk do të jetonin poshtë nivelit njerëzor, por do të arrinin të kuptonin mundësinë plotësore të të qenit njerëzor, ato do të ishin në gjendje që intuitivisht ta rrokin të vërtetën e parësisë së

vetëdijes. Dhe vetë vetëdija e tyre do të lartësohej në një shkallë ku ata do të mund të njihnin përmes intelektit të drejtpërdrejtë që alfa dhe omega e realitetit kozmik nuk mund të jetë asgjë tjetër pos Vetëdijes Supreme që është gjithashtu Qenësi e Kulluar, dhe që të gjitha qeniet në univers posedojnë një nivel vetëdijeje në pajtim me gjendjen e tyre ekzistenciale. Ata do të kuptonin se si qenie njerëzore na është dhënë inteligjenca për të njohur Atë i Cili është Origjina dhe Fundi i të gjitha gjërave, që është Sat (Qenësi), Çit (Vetëdije) dhe Ananda (Lumturim); dhe do të kuptonin që vetë kjo dituri është qëllimi themeltar i jetës njerëzore, vetë kurora e ekzistencës njerëzore, dhe që çka thelbësisht na bën qenie njerëzore që mund të kuvendojmë me pemët dhe zogjtë, sikurse edhe me engjëjt; dhe që në më të lartin nivel, jemi, bashkëbisedues të atij Realiteti Suprem që na ka mundësuar të themi “Unë”, por që është gjithëmbarsisht Uni i të gjithë Uneve.

(Përktheu: Ervin Qafmolla)

100 vjet Medreseja e Tiranës (1924 - 2024)

Msc. Dorian Demetja

Abstrakt

Ideja e hapjes së medresesë shtronte nevojën e rishikimit të metodave, hartimit të programeve mësimore dhe përcaktimit të objektivave për edukimin e nxënësve me ndjenja fetare e kombëtare. Medreseja nuk u hap brenda një dite; u desh shumë mund, shumë bisedime, dubeshin zgjidhur shumë çështje e nën çështje financiare, duhej siguruar personeli pedagogjik, ambienti i mësim, literatura mësimore didaktike, etj. Ideatorët, flamurtarët e pastaj nismëtarët e kësaj lëvizjeje për ta çuar përpara problemin, u bënë ata që kishin marrë mësim në shkolla të përparuara të botës islame ose që kishin dhënë leksione ndër kësi shkollash si mësues e pedagogë. Autorë të veçantë prezantonin përvojën personale se si mund të themelohet një medrese në shërbim të Islamit, në shërbim të Atdheut.

Medreseja e Naltë në Tiranë u hap më 01.03.1924 me vendim të Kongresit të Parë të Myslimanëve Shqiptarë dhe me lejen e Ministrisë së Arsimit N. 105/1, datë 25.02.1924, për të plotësuar nevojat për kuadro fetarë. Kjo shkollë islame u hap me një personel tërësisht shqiptarë dhe shpenzimet për ecurinë e saj u përballuan nga të ardhurat e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Brenda disa vitesh, Medreseja e Përgjithshme e Tiranës formoi fizionominë e vet si një institucion serioz, ku merrej një formim i shëndoshtë fetar dhe kombëtar. Ajo që në fillim punoi në bazë të një plani mësimor të nivelit bashkëkohor.

Nga regjimi komunist, ashtu si feja e besimi në përgjithësi, edhe Medreseja e Tiranës pati goditje me ashpërsi në rritje, duke nisur me reformën arsimore të vitit 1946, e cila ia kufizoi ndjeshëm lëndët fetare. Pushteti komunist i imponoi me vendim të veçantë një plan-program mësimor, që prekte thellë fizionominë dhe përmbajtjen e saj. Ministria e Arsimit gradualisht u përpoq që programi i shkollës të shkojë drejt laicizmit.

Sipas vendimit nr. 1 dt. 22.08.1964 të Këshillit të Përgjithshëm, Medreseja e Tiranës

hëpërbë mbyllet për arsye të forta buxhetore dhe se tani për tani ka kuadro të bollshëm. Një goditje e fortë iu dha Komunitetit Mysliman, kur më 27 dhjetor 1965 konfiskohet nga shteti pa asnjë shpjegim godina e Medresesë së Tiranës, duke iu kaluar në dispozicion Fakultetit të Mjekësisë, dega Stomatologji, gjendje e cila vazhdoi edhe pasi vendi kaloi në një regjim demokratik. Kjo frymë ateiste vazhdoi deri në vitin 1990.

Në shkresën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë të datës 10.10.1991, me numër 1 të protokollit, drejtuar Myftinisë Tiranë, H. Sabri Koçi citon: “Me vendimin e marrum nga ky Komunitet, është vendosur që në qytetin e Tiranës do të ngrihet shkolla e mesme MEDREZE e emërtueme ‘Haxhi Mahmud Dasbi’. Personeli që do të japi mësim në kulturën e përgjithshme, do i sigurohet paga nga ana e këtij Komuniteti simbas orëve dhe normave në fuqi për arsimin e përgjithshëm.”

Komuniteti i myslimanëve shqiptarë ka hyrë në vitin jubilar të 100 vjetorit të themelimit të Medresesë së Tiranës, e cila qysh nga fillimi dhe deri në ditët e sotme ka qenë dhe vazhdon të jetë një model i shkëlqyer e frymëzues për shoqërinë shqiptare. Historikisht, si pedagogët ashtu edhe nxënësit e Medresesë së Tiranës, janë vlerësuar për merita të veçanta dhe ndikimin pozitiv që kanë përhapur te të tjerët, duke u bërë në këtë mënyrë shembuj për t’u ndjekur denjësisht prej tyre.

Në Shqipëri, disa shekuj më parë, institucionet mësimdhënëse fetare kanë qenë pranë xhamive dhe në to mësohej kryesisht Kur’ani Famëllartë dhe njohuritë bazë të fesë islame. Kurse për medresetë, si institucione serioze të arsimit kombëtar fetar islam, mund të flasim vetëm pas Shpalljes së Pavarësisë.

Ideja e hapjes së medresesë shtronte nevojën e rishikimit të metodave, hartimit të programeve

mësimore dhe përcaktimit të objektivave për edukimin e nxënësve me ndjenja fetare e kombëtare. Medreseja nuk u hap brenda një dite; u desh shumë mund, shumë bisedime, duheshin zgjidhur shumë çështje e nën çështje financiare, duhej siguruar personeli pedagogjik, ambienti i mësimin, literatura mësimore didaktike, etj. Ideatorët, flamurtarët e pastaj nismëtarët e kësaj lëvizjeje për ta çuar përpara problemin, u bënë ata që kishin marrë mësim në shkolla të përparuara të botës islame ose që kishin dhënë leksione ndër kesi shkollash si mësues e pedagogë. Autorë të veçantë prezantonin përvojën personale se si mund të themelohej një medrese në shërbim të Islamit, në shërbim të Atdheut.¹

Drejtorja e Përgjithshme e Vakëfeve në shkresën e datës 2 qershor 1923, i raporton Këshillit

1. Faik Kasollja, *Hoxhallarët, kategori e respektuar e shoqërisë shqiptare*, revista “Zani i Naltë”, nr. 8 (161), korrik-gusht-shtator 2014, f. 21-22.

të Naltë të Sheriatit mbi ndërtimin e Medresesë:

“1) Sot për sot, pasi pasuria e Xhema’atit Mysliman nuk mund të përballojë shpenzimet që duhen për ndërtimin e Medresesë së Përgjithshme dhe për institutin në fjalë ekziston një nevojë e madhe dhe e ngutshme, mendojmë përsëri se, sa të përmirësohet gjendja financiare e xhema’atit, të merret këtu në kryeqytet me qira një godinë e favorshme e të formohet në të medreseja.

2) Në këtë medrese të merren prej çdo prefekturë nga 5 nxënës, duke u siguruar shpenzimet e tyre prej vakfit të prefekturave.

3) Mësimet të ndahen në 3 kategori - fillore, lice e universitet dhe periudha mësimore e secilës kategori të jetë 4 vjet.

4) Nxënësit që kanë mbaruar filloren në medrese të vendit, të pranohen në rendin e prapmë të kategorisë fillore.

5) Përveç atyre që do të vazhdojnë studimet me kursimet e vakëfeve të qarkut, të pranohen edhe nxënës të pasur që dëshirojnë të ndjekin mësimet në Medrese, me kusht që të paguajnë shumën e shpenzimeve që u përkasin. Presim vendimin e Këshillit të Naltë të Sheriatit që të nisim marrëveshjet me zyrat e qarkut.”²²

Në vendimin e Këshillit të

2. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 76, fleta 37.

Naltë të Sheriatit nr. 52, të datës 4 qershor 1923 citohet: “Këshilli i Naltë i Sheriatit lexoi shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të datës 2 qershor 1923, nëpërmjet së cilës propozohet që të merret një vendim nga ana e Këshillit të Naltë të Sheriatit për pranimin e formimit të një Medreseje të Përgjithshme në Tiranë, sipas konditave të treguara në shkresën e sipërpërmendur, që kështu Drejtoria në fjalë të fillojë pa humbur kohë përgatitjet e duhura. Mbasi u pa i arsyeshëm e i pëlqyeshëm propozimi i lartpërmendur, u vendos pranimi i formimit të Medresesë së sipërtreguar prej tri klasash, e cila do të funksionojë sipas një programi e rregulloreje të posaçme dhe me këtë mënyrë autorizohet Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve për të bërë marrëveshjet e duhura me të gjitha prefekturat për sigurimin e nxënësve si edhe për shpenzimet e duhura, duke njoftuar Këshillin në përfundim.”²³

Në bazë të vendimit nr. 34, datë 24.02.1924 të Këshillit të Naltë të Sheriatit, numri i nxënësve në Medresenë e Naltë ishte 24, të ndarë në 3 klasa, dhe si drejtor i saj ishte caktuar z. Qamil Bala, anëtar i Këshillit të Naltë të Sheriatit, si dhe mësues e figura të shquara si: H. Ali Korça, Haki Sharofi, Haxhi

3. AQSH, fondi 482, viti 1923, dosja 3, fleta 74.

Mahmud Dashi, Sulejman Kadiu, Haxhi Tahiri, Rexhep Berati, Haki Tefiku, etj.

Medreseja e Naltë në Tiranë u hap më 01.03.1924 me vendim të Kongresit të Parë të Myslimanëve Shqiptarë dhe me lejen e Ministrisë së Arsimit N. 105/1, datë 25.02.1924,⁴ për të plotësuar nevojat për kuadro fetarë. Kjo shkollë islame u hap me një personel tërësisht shqiptarë, me programe e organizim bashkëkohor, të hartuara e administruara nga teologë shqiptarë dhe, shpenzimet për ecurinë e saj u përballuan nga të ardhurat e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Fillimisht, Medreseja filloi nga puna në ambientet e ndërtuara në shtëpinë e Haqim Maçit, lagjja Sulejman Pasha⁵ (pranë xhamisë së Sulejman Pashës dhe godinës së vjetër të Komunitetit Mysliman). Ndërtesa e specifikuar për Medresenë e Tiranës u përrua më 20.12.1931 në prani të të gjithë elitës së kohës.⁶ Inaugurimi i godinës së Medresesë së Tiranës u përshëndet nga kryetari i Komunitetit Mysliman të asaj kohe Dr. Behxhet Shapati dhe figura të tjera të shquara si Mehdi Frashëri, ku ndërmjet të tjerash do të citonte:

4. *Ceremonia e shpërdamjes së diplomave maturantëve të medreses*, revista “Zani i Naltë”, nr. 3-4, nëntor-dhjetor 1932, f. 460.

5. *Medreseja e Përgjithshme (Universite) e Komunitetit Mysliman*, revista “Zani i Naltë”, nr. 5, shkurt 1924, f. 146.

6. *Inaugurimi i ndërtesës së Medresesë*, revista “Zani i Naltë”, nr. 5, janar 1931, f. 111.

“Ky qe një s'ihariq për tërë botën islame shqiptare. Përparimi i vrullshëm për ne shqiptarët është një nevojë e jetës. Medresetë do të jenë foleja e prijësve të fesë islame në Shqipëri, e duhet të konformohen me frymën e shekullit brenda të cilit jetojmë.”⁷

Sipas informacioneve që kalojnë në revistën e parë zyrtare të Komunitetit Mysliman Shqiptar “Zani i Naltë”, të muajit prill 1927, gjendeshin 12 medrese në qytetet: Shkodër, Vlorë, Gjirokastër, Kavajë, Durrës, Tiranë, Krujë, Shijak, Peqin, Elbasan, Korçë dhe Berat.⁸ Në kuadrin e riorganizimit të rrjetit arsimor fetar në Shqipëri, në Kongresin e Tretë të Myslimanëve Shqiptarë më 1929, u vendos të suprimohen të gjitha medresetë e qyteteve të lartpërmendura dhe të mbetej vetëm ajo e Tiranës, e cila do të quhej “Medreseja e Përgjithshme”.

Brenda disa vitesh, Medreseja e Përgjithshme e Tiranës formoi fizionominë e vet si një institucion serioz, ku merrej një formim i shëndoshë fetar dhe kombëtar. Ajo që në fillim punoi në bazë të një plani mësimor të nivelit bashkëkohor. Plani mësimor i grup-lëndëve të kulturës së përgjithshme u gërshetua me grup-lëndët që karakterizonin shkollat e mesme shtetërore, licetë

7. *Gjykimet e fundit të z. Mehdi Frashëri mbi Fenë Islame*, revista “Zani i Naltë”, nr. 6, shkurt 1932, f. 154-158.

8. Salih Vuçiterni, *Nji pergjigje Z. Hafis Xhaferit*, revista “Zani i Naltë”, nr. 9, prill 1927, f. 275.

klasikë, siç ishin gjuha dhe letërsia që merreshin gjatë gjithë periudhës së studimit dhe kishin përparësi ndaj lëndëve të tjera. Medresistët, duke shfrytëzuar festat fetare e kombëtare, zhvillonin një veprimtari të gjerë jashtëshkollore – shkencore e artistike dhe e prezantonin para një publiku të gjerë.⁹ Nga bankat e Medresesë së Naltë kanë dalë figura të shquara të shkencës shqiptare si historiani Vexhi Buharaja, akademiku Shaban Demiraj etj. Disa nga maturantët e parë të kësaj Medreseje që u diplomuan në vitin 1932, pasi kryen studimet e larta, punuan po këtu me përkushtim si mësues apo drejtues të saj.

Rihapja e Medresesë së Tiranës pas çlirimit të vendit

Rihapja e Medresesë së Tiranës pas çlirimit të vendit, u pa me shumë prioritet nga stafi drejtues i KMSH-së, e për këtë, u mor vendim që Medreseja të rifillojë mësimin e rregullt pas disa riparimeve të bëra, për shkak të dëmtimeve nga luftimet. Me të njëjtin vendim u vendos Hafiz Ismet Dibra drejtor i këtij institucioni.¹⁰ Këshilli i Përhershëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë me vendim nr. 9, datë 23.05.1945 vendosi që Medreseja e

Përgjithshme të çelë dyert e saj më 01 qershor 1945.¹¹

Ishte merita e Medresesë së Përgjithshme, e trupit mësimdhënës, veçanërisht e drejtorit të saj, Hafiz Ismet Dibrës, si dhe e kolegëve të tij: Jonuz Buliqit, sheh Qazim Hoxhës, Haki Sharofit, H. Ibrahim Dalliut, H. Ali Korçës, etj., të cilët, me punën e tyre intensive e të palodhur, me shkrimet e veprat e botuara dhe me patriotizmin që i karakterizonte, përgatitën breza studentësh, të cilët u bënë përçues të denjë të Islamit, duke ia rritur njëkohësisht nderin edhe kombit.

Nga regjimi komunist, ashtu si feja e besimi në përgjithësi, edhe Medreseja e Tiranës pati goditje me ashpërsi në rritje, duke nisur me reformën arsimore të vitit 1946, e cila ia kufizoi ndjeshëm lëndët fetare, ndërsa lëndët e kulturës së përgjithshme ia detyroi si të një shkollë profesionale. Pushteti komunist i imponoi me vendim të veçantë një plan-program mësimor, që prekte thellë fizionominë dhe përmbajtjen e saj. Ministria e Arsimit gradualisht u përpoq që programi i shkollës të shkojë drejt laicizmit. “Mbledhja e Ministrisë së Arsimit më 16 tetor 1946, vendosi që shkolla fillore pranë Medresesë të mbyllej, kurse numri i klasave të mesme të reduktohej në 4.”¹²

9. Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë 2011, f. 93.

10. Shyqyri Hysi (Dr.), *Muslimanizmi në Shqipëri në periudhën 1945-1950*, Tiranë 2006, f. 147.

11. AQSH, fondi 482, viti 1945, dosja 3, fleta 9.

12. Shyqyri Hysi (Dr.), *Muslimanizmi në*

“Medreseja e Tiranës ishte një institucion, ku merrej paralelisht mësimi i kulturës së përgjithshme dhe të asaj fetare, pa lënë në një anë edukatën e shëndoshë qytetare-fetare. Mësimi në këtë shkollë i pajisi nxënësit me njohuri elementare shkencore, shprehi e aftësi për të argumentuar se çdo gjë në jetë nuk ka ardhur në mënyrë të rastësishme e me evolucion, por me krijim. Këtë e provuam pas viteve ’50, kur shteti gradualisht filloi ndërhyrjen jo vetëm me shkurtimin e fondeve, por edhe me sjelljen e kuadrove laikë të kulturës së përgjithshme, duke larguar ata që ishin emëruar nga Komuniteti Mysliman, me pretendimin se ‘kishin biografi të keqe’. Lënda që binte ndesh me pikëpamjet fetare ishte Darwinizmi.”¹³

Regjimi komunist, shumë drejtues e mësues të Medresesë së Tiranës i përndoqi, i burgosi dhe i dënoi me egërsi. Më 11 dhjetor 1946 arrestohet drejtori i Medresesë Hafiz Ismet Dibra me një arsytim si kundërshtar politik i regjimit komunist. Edhe nxënësit e Medresesë patën presione të ndryshme, duke i thirrur ata qëllimisht për ushtar apo duke i orientuar që arsimin ta vazhdojnë në shkolla të tjera shtetërore.

Nxënësit filluan të largohen nga Medreseja nga presionet e ndryshme dhe në qershor të vitit 1951 do të

merrnin diplomën e Medresesë së mesme vetëm 11 maturantë, sepse e larta nuk po funksiononte më. Në vitin 1955 Medreseja e Tiranës kishte 60 nxënës. Në vitin 1961 numri i frekuentuesve zbret dhe Medreseja e Tiranës kishte 47 nxënës.¹⁴ Në vitin 1964 kishte vetëm 5 maturantë dhe, po atë vit, Medreseja e Përgjithshme e Tiranës mbyllet plotësisht.

Sipas vendimit nr. 1 dt. 22.08.1964 të Këshillit të Përgjithshëm, Medreseja e Tiranës hëpërhë mbyllet për arsye të forta buxhetore dhe se tani për tani ka kuadro të bollshëm.¹⁵ Një goditje e fortë iu dha Komunitetit Mysliman, kur më 27 dhjetor 1965 konfiskohet nga shteti pa asnjë shpjegim godina e Medresesë së Tiranës, duke i kaluar në dispozicion Fakultetit të Mjekësisë, dega Stomatologji, gjendje e cila vazhdoi edhe pasi vendi kaloi në një regjim demokratik.¹⁶ Kjo frymë ateiste vazhdoi deri në vitin 1990.

Ringritja e Medresesë së Tiranës me fillimin e proceseve demokratike

Etja për të mësuar nga feja ishte shumë e madhe, dhe për këtë, u hapën fillimisht kurse pranë xhamive

14. Roald A. Hysa, *Persekutimi i klerit mysliman nën regjimin komunist (1945-1967)*, Tiranë 2022, f. 84.

15. AQSH, fondi 482, viti 1964, dosja 6, fleta 1.

16. Myzafer Kazazi (Prof. Dr.), *Tirana kryeqytet, ndryshimet urbane dhe objektet e kultit musliman*, revista “Drita Islame”, nr. 15, shtator 1999.

Shqipëri në periudhën 1945-1950, f. 156.

13. Xhemal Balla, *Hafiz Mustafa Doraci (1894-1974)*, Tiranë 2011, f. 31.

dhe qendra islame, ku mësoheshin kryesisht elementët bazë të fesë islame. Mbi të gjitha, u hapën 10 medrese, të cilat, pas ligjërimit të Komunitetit Mysliman nga organet shtetërore e juridike, edhe ato u njohën nga Ministria e Arsimit si shkolla të mesme, me të drejta konkurrimi për të vazhduar studimet e larta brenda apo jashtë vendit.

Në shkresën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë të datës 10.10.1991, me numër 1 të protokollit, drejtuar Myftinisë Tiranë, H. Sabri Koçi citon: “Me vendimin e marrum nga ky Komunitet, është vendosur që në qytetin e Tiranës do të ngrihet shkolla e mesme MEDREZE e emërtueme ‘Haxhi Mahmud Dashi’”. Personeli që do të japi mësim në kulturën e përgjithshme, do i sigurohet paga nga ana e këtij Komuniteti simbas orëve dhe normave në fuqi për arsimin e përgjithshëm.”

Në vitet e para, medresetë u përballën me vështirësi të mëdha e serioze që i kapërcyen gradualisht, duke filluar nga mungesa e ndërtesave, e mjeteve didaktike-mësimore, kuadri i kualifikuar mësimdhënës, programet e deri te tekstet mësimore aq të nevojshme. Kërkesa për bazë materiale për shkollat fetare, si banka, katedra, tabela të zeza, etj., dërguar Bashkësisë së qytetit të Tiranës nga H. Sabri Koçi, tregon fare qartë mungesën dhe nevojën e madhe në këtë drejtim.¹⁷

17. Kërkesë për bazë materiale për shkollat

Puna e përditshme në medrese paraqiste shumë probleme që duheshin zgjidhur, në mënyrë të veçantë gjetja e kuadrit për lëndët e kulturës së përgjithshme dhe sidomos për lëndët fetare e gjuhën arabe. Problemi i lëndëve të kulturës së përgjithshme u zgjidh më shpejt. Për lëndët fetare, medresetë u mbështetën te ish-nxënësit e Medresesë së Naltë të Tiranës, të cilët, megjithëse në moshë, ishin të gatshëm për të zhvilluar mësim. Medresistët, kishin kryer apo jo studime të larta, me përmbysjen e diktaturës, kontribuan pa rezerva e dhanë ndihmesën e tyre për medresetë e Shqipërisë, rihapjen e xhamive në vend ose u morën me punë të tjera në shërbim të Islamit. Por këtu ndihmuan dhe mjaft kuadro të ardhur nga Kosova dhe Maqedonia. Në një shkresë të Bashkësisë Islame të Kosovës, drejtuar Kryesisë së KMSH nga kryetari Dr. Rexhep Boja, bëhet e ditur caktimi i pesë personave që do të shërbejnë për nevojat mësimore në medresetë e Shqipërisë.¹⁸

Për ringritjen e Medresesë së Tiranës “Haxhi Mahmud Dashi”, ish-mësuesi i saj z. Ali Hoxha thotë: “*Në datën 16.10.1991 Medreseja e Tiranës hap dyert për nxënësit e vitit të parë të arsimit të mesëm. Nismëtarët e rihapjes fetare – Bashkësisë së qytetit të Tiranës, datë 31.03.1993, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.*”

18. Shkresë, Kryesisë së Bashkësisë Islame Shqiptare, shkëlqesisë së tij Sabri ef. Koçi – Tiranë, datë 11.05.1992, nr. 195/92, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

së Medresesë së Tiranës ishin njëkohësisht edhe mësuesit e saj, Ibrahim Balla, Mehmet Sinella, Xhavit Alimehmeti, Ali Hoxha, Selim Stafa, Xhemal Balla dhe Ismet Tancica. Si përgjegjës për punët e shkollës, zgjidhet fillimisht z. Ibrahim Balla, i cili emërohet drejtor i medresesë një vit më pas nga Komuniteti Mysliman.” Medreseja e Tiranës “Haxhi Mahmud Dashi” u hap fillimisht pranë xhamisë së Kokonozit me një klasë, ku paradite bënin mësim nxënësit nga rrethinat e Tiranës dhe pasdite nxënësit me banim brenda qytetit. Në shtator të vitit 1995, nxënësit fillojnë të bëjnë mësim në godinën e vet historike të Medresesë së Tiranës.

Problemet e arsimit fetar dhe sidomos ai i medreseve, kanë qenë gjithnjë në qendër të veprimtarisë së Komunitetit Mysliman. Për ato janë bërë analiza dhe janë dhënë raporte të vazhdueshme. Në raportin e vitit 1993 theksohet: “Janë hapur e funksionojnë këto dy vjet 10 medrese në Tiranë, Shkodër, Durrës, Kavajë, Berat, Dibër, Korçë, Elbasan, Gjirokastër dhe Kukës. Në këto medrese ka mbi 1000 nxënës dhe 132 mësues... Punë shumë e mirë është bërë nga myftinitë e rretheve për hapjen e funksionimin e kurseve në xhami, ku vazhdojnë mësimet me mijëra fëmijë të moshave të ndryshme, djem e vajza...”¹⁹

Në planet mësimore të medreseve

19. Raport mbi aktivitetin e punës së Komunitetit Mysliman, Tiranë 29.04.1993, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

u përfshinë lëndët e kulturës së përgjithshme të shkollave të mesme të përgjithshme dhe lëndët fetare: Kur’an, Besim, Fikh (Jurisprudenca Islame), Tefsir (Komentimi i Kur’anit) Hadith (Tradita profetike), Histori islame, si dhe gjuhët e huaja arabisht e anglisht. Për sa i përket strukturës administrative të medreseve, ato administrohen sipas protokolleve të parashikuara prej Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe fondacioneve përkatëse që i sponsorizojnë.

Sot, falë kujdesit të vazhdueshëm të KMSH-së dhe kontributeve financiare të shoqatave bamirëse e fondacioneve, tashmë Medresetë (të shtrira në qytetet Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Elbasan) kanë siguruar godina të reja e të bukura, mjedise të përshtatshme bashkëkohore për mësim dhe fjetje, laboratorë, biblioteka, palestra, kënde sportive, materiale didaktike e mjete informacioni të fjalës së fundit. Objektivi kryesor i medreseve ka qenë dhe mbetet brumosja e nxënësve me njohuritë e moralin islam, me ndjenja kombëtare e me vizion të qartë për të ardhmen, pajisja me dije të thella e të qëndrueshme që do t’u shërbejnë atyre për të përballuar sfidat e jetës në shoqërinë e sotme demokratike.²⁰

Nxënësit e medreseve aftësohen

20. Hiqmet Patozi, *Medreseja e Naltë e Tiranës, ëndrra e besimtarëve islamë*, revista “Zani i Naltë”, nr. 10 (163), janar-shkurt-mars 2015, f. 105.

të mësojnë mirë e të njohin thelbin e ajeteve, leximin dhe këndimin përmendësh të Kur'anit, komentet e dijetarëve për ligjet islame dhe hadithet, po kështu të kryejnë praktikatat e adhurimeve e detyrimeve fetare. Këto shkolla, në shërbim të ngulitjes e të thellimit të njohurive që marrin nxënësit në klasë, organizojnë javë shkencore, panairë shkencore, projekte në programet mësimore shumë të efektshme për cilësinë. Ata paraqiten mirë edhe në Olimpiadat e MASH për lëndët matematikë, fizikë, kimi, biologji e informatikë, madje shumë mirë në olimpiadat dhe projektet ndërkombëtare.²¹

Stafi mësimor i Medresesë së Tiranës punon shumë që nxënësit t'i shfrytëzojnë aftësitë e tyre jo vetëm për vete, por edhe për familjen, shoqërinë e mbarë kombin. Për këtë qëllim zhvillohen edhe veprimtari praktike orientuese, që nxënësit

e Medresesë së Tiranës të dinë të tërheqin në rrugën e drejtë të Islamit edhe persona të tjerë të afërm ose të njohur. Me gjithë vështirësitë e kohës, Medreseja e Tiranës e ruan profilin e saj, duke ofruar për nxënësit arsimin dhe edukimin e duhur të ndërthurur me frymën fetare e kombëtare, mision të cilin vazhdon ta kryejë me përkushtim edhe sot. Aktualisht, Medreseja e Tiranës e vazhdon aktivitetin e saj me 328 nxënës, 201 prej të cilëve janë vajza dhe 127 djem.

Më 17.03.2015, me numër dekreti 8997, ish Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Bujar Nishani, i ka akorduar Medresesë së Tiranës titullin "Për merita të veçanta civile" me motivacionin: "*Si një shkollë e arsimit fetar në Shqipëri, e cila, duke u bërë pjesë e arsimit tonë, përgatiti për disa dhjetëvjeçarë në një nivel të lartë një plejadë teologësh myslimanë, të cilët luajtën një rol parësor në ripërtëritjen e moralit tonë kombëtar.*"

21. Hiqmet Patozi, po aty.

Roli i mejtepeve në zhvillimin e arsimit shqip

Mr. Habib Ebibi

Abstrakt

Mektebet (mejtepet) gjatë periudhave historike, kishin një rol shumë të rëndësishëm, ishin në kategorinë ose në nivelin e shkollave të sotme fillore. Pas rënies së Perandorisë Osmane, dhe formimit të shteteve në republika, shkollat publike të ciklit të ulët, në shumë vende islame, i zhvendësuan mejtepet. Në mejtepe fëmijët e myslimanëve kanë mësuar leximin e Kur'anit, kanë mësuar parimet themelore të fesë Islame; kushtet e fesë Islame, kushtet e besimit, mënyrën e marrjes së abdesit, mënyrën si falet namazi, etj.

Këto ente edukative dhe arsimore zakonisht janë ndërtuar afër xhamive. Në to mësuesi fetar ka qenë i angazhuar që t'ua mësojë fëmijëve leximin e Kur'anit dhe gjërat më elementare të Fesë Islame.

Hyrje

Për sa u përket shqiptarëve, në periudha të ndryshme historike, feja ka pasur rolin e vet konstruktiv, sidomos për t'i ikur asimilimit, sepse ajo ruan ndjenjat më të larta kombëtare dhe fetare... për atdheun jepet jeta, si gjëja më e shenjtë.

Materia e trajtuar në këtë punim i përket karakterit studiues dhe ka për qëllim të zbardhë sadopak kontributin e mejtepeve në zhvillimin e arsimit shqip gjatë

periudhës së viteve 1930-1950 në rajonin e Kumanovës dhe më gjerë.

Për shkak specifikave që ka rajoni i Kumanovës jam koncentruar në këtë vend për të zbardhë sadopak rolin e mejtepeve në zhvillimin dhe avancimin e gjuhës shqipe.

Mësimi i gjuhës shqipe në mejtepe gjatë asaj periudhe kohore ishte më se i nevojshëm, për arsye se përballëshin me sisteme të cilët ua kishin pamundësuar shqiptarëve të mësonin në gjuhën e tyre amë, andaj, për realizimin e kësaj, rol dhe

kontribut të madh kanë dhënë edhe mualimët (mësuesit) e ndryshëm, pa të cilët nuk do të realizohej një gjë e tillë.

Arsimimi në rajonin e Kumanovës gjatë viteve 1930-1950

Jugosllavia e vjetër nuk ishte vetëm shtet i pabarazisë sociale, i shfrytëzimit klasor. Ajo ishte edhe një vend i pabarazisë dhe i shtypjes kombëtare. Pushtetin e kishte borgjezia serbe që ishte e detyruar kohë pas kohe ta ndajë këtë pushtet me borgjezinë kroate e sllovene. Kombet si maqedonasit, myslimanët, malazezët nuk pranoheshin. Pakicave kombëtare nuk u pranoheshin as të drejtat më elementare e kulturore ndër të cilat ishte shkollimi në gjuhën amtare. Në pozitën më të vështirë ishin shqiptarët, ndaj të cilëve zhvillohej një politikë e asimilimit dhe shpërnguljes.¹

Që në fillim duhet theksuar se për mësimin në gjuhën shqipe qëndrojnë konstatime se arsimi sipëror në Maqedoni ka kaluar nëpër disa faza të sistemeve të ndryshme shoqërore-politike. Deri në vitin 1966 në suaza të shtetit të atëhershëm jugosllav, ishte e pamundur që shqiptarët të kërkojnë arsimim sipëror në gjuhën e tyre amtare, por edhe shkollimi fillor dhe

1. Grup autorësh, *Bazat e marksizmit dhe vetëqeverisja socialiste*, Prishtinë, 1980, f. 157.

i mesëm ishte i dozuar nga qarqet politike që vendosnin në Beograd.²

Pas Luftës së Parë Botërore (1918) Kumanova ra përsëri nën sundimin e Serbisë, në fillim të Mbretërisë së SKS-së, e pastaj të Jugosllavisë. Serbia si më parë, për qëllime të veta, hapi shkolla në gjuhën serbe edhe në fshatra të banuar me shqiptarë, si në Kumanovë, Opajë, Vaksincë, Sllupçan, Hotël, Mateç, etj. Numri i nxënësve shqiptarë në këto shkolla ishte shumë i vogël, apo e ndiqnin ata fëmijë që vinin nga familjet e pasura.³

Në Maqedoni, gjatë viteve 1930-1950 dhe vitet që pasuan deri në vitet e para pas çlirimit, gjendja e trashëguar jo e këndshme kulturore dhe arsimore, mbi të gjitha kushtet e këqija materiale dhe të kuadrit, kishin një ndikim negativ në zhvillimin e rrjeteve të shkollave fillore në sistemin edukativo-arsimor dhe në përfshirjen e nxënësve. Për atë shkak edhe shkalla dhe ecuria e parimeve programore ligjore është më e ulët në Maqedoni nga shtetet e tjera në Jugosllavi, të cilët kishin trashëguar një sistem më të zhvilluar shkollor, dhe kishin një numër më të madh të kuadrit të kualifikuar.⁴

2. Tribunë shkencore: *Gjendja e arsimit në vend – sfidat dhe perspektivat*, (Abdurauf Pruthi), f. 60.

3. Shiko: *Tribunë shkencore, Studime albanologjike*, vëllimi 3, (Naim Halimi), f. 47-48.

4. Shiko: Minir Ademi, *Arsimi dhe kultura shqiptare në Maqedoni (1944-1960)*,

Pas viteve 1930 pushteti serb nisi të ndërtojë shkolla në vendet me popullatë shqiptare. Ky fenomen u bë pasi në radhët e pushtetit serb filluan të punësohen shqiptarët. Godinat e shkollave, në të shumtën e rasteve ishin pronë shtetërore, dhe ishin pa kushte higjienike-pedagogjike. Ministria e Arsimit në Beograd, edhe pse kishte fonde të posaçme për ndërtimin e shkollave fillore, ajo kundrejt shqiptarëve praktikoi të kundërtën, pra pushteti e detyronte popullatën shqiptare të punonte në angari, ata bartnin gurë e drurë si dhe e bënë vetë mjeshtërinë.⁵

Shkolla dhe arsimimi i popullatës shqiptare në Maqedoni gjatë viteve 1929/30 dhe deri në vitet 1940/41, e gjitha do të zhvillohej në gjuhën serbe. Ministria e Arsimit e asaj kohe, nga viti 1933, do të sjellë edhe plan-programin mësimor për shkollat fillore.

Plani dhe programi mësimor u soll dhe u aprovua vetëm për katër klasat e shkollës fillore (shkollat katërvjeçare), nuk ishte e angazhuar për plan-programin e shkollave tetëvjeçare edhe pse e kishte proklamuar si të detyrueshme.⁶

Në bazë të plan-programit të hartuar, fëmijët duhej t'i mësonin bazat elementare të shkrimit dhe leximit serb⁷, e që do t'i kushtonin rëndësi të madhe edhe religjionit apo fesë e cila do të ishte me dirigjime nga ana e pushtetit.

Për të qenë më i qartë diskriminimi ndaj shqiptarëve për mësim në gjuhën shqipe, tabela në vazhdim na e pasqyron më së mirë gjendjen faktike të lëndëve dhe orëve në plan-program.

Tabela 1. Paraqet lëndët mësimore dhe fondin e orëve të plan-programit të hartuar në vitin 1933.⁸

Lëndët mësimore	I	II	III	IV	
Mësim-besimi	1	1	2	2	6
Gjuhë popullore (serbe)	10	9	6	5	30
Gjeografi	-	-	2	3	5
Histori	-	-	1	3	4
Njohje e natyrës dhe reko. mbi shëndetin	-	-	3	3	6
Matematikë dhe gjeometri	5	5	4	4	18

6. Shiko: Po aty, f. 41.

7. Minir Ademi, *Hotla nëpër kobë*, Kumanovë, 2017, f. 49.

8. Avzi Mustafa, *Shënime arsimore-fetare shqiptare*, Shkup, 2003, f. 41.

Kumanovë, 2018, f. 52.

5. Shiko: Avzi Mustafa, *Shënime arsimore-fetare shqiptare*, Shkup, 2003, f. 42.

Studime

Vizatim	-	1	1	1	3
Bukurshkrim	-	1	1	1	3
Dituri praktike dhe bujqësia	-	-	3	3	6
Muzikë	2/2	2/2	1	1	4
Gjïmnastikë	4/2	4/2	2	1	7
Gjithsej	19	20	25	27	92

Tabela tregon gjendjen faktike të diskriminimit ndaj fëmijëve shqiptarë përmes plan-programit të hartuar për shkollat katërvjeçare.

Nga viti 1933 deri në vitin 1940 mësimi u zhvillua në përqindje të vogël nga radhët e fëmijëve mysliman. Pas këtyre viteve, përkatësisht gjatë viteve 1941 deri në periudhën e vitit 1945, kur Kumanova dhe territoret përreth saj ranë nën pushtetin okupues bullgar, kjo gjë ndodhi si rezultat i marrëveshjes së arritur në Vjenë më 20-29 prill 1941 mes gjermanëve, italianëve dhe bullgarëve, ku pjesa e Shkupit, Kumanovës dhe disa vise të tjera do t'i takojnë Bullgarisë⁹, andaj bullgarët, duke i konsideruar entet arsimore si instrumente të rëndësishme për denacionalizimin dhe asimilimin e të rinjve, në qytet dhe rrethinat e tij, organizoi rrjetin e gjendjes së shkollave. Nëpër shkolla mësimi zhvillohej sipas programit të posaçëm arsimor të përgatitur nga Ministria e Arsimit e Bullgarisë cariste në të cilat vend të posaçëm kishte mësimi i lëndëve

nëpërmjet të cilave duhej të mbillej ndjenja kombëtare bullgare te nxënësit.¹⁰

Si rezultat i këtyre ndikimeve ekzistonin arsye të ndryshme për mos ndjekjen e mësimin fillor. Edhe pse më vonë gjërat do të ndryshonin në aspektin politik, teoria dhe entuziazmi ishin të ndryshme në relacion me praktikën, pasi pasojat e sllavizmit të fëmijët mysliman do të jenë prezent pothuajse gjatë gjithë kohës së ish-Jugosllavisë.

Ndër arsyet prej të cilave mund të veçojmë janë: Arsyet që burojnë nga ana e vetë myslimanëve dhe nga jashtë (jo-muslimanët).

Arsimimi nën sundimin e Mbretërisë Serbe Kroate Sllovene (SKS)

Largimi i osmanlinjve dhe depërtimi i forcave dhe pushtetit të mbretërisë serbe në Shkup dhe në territoret e banuara nga myslimanët shënon fillimin e përkeqësimit dhe shkatërrimit të kulturës islame dhe të myslimanëve nga të gjitha aspektet. Me kalimin

9. Shiko: Feri Arifi, *Tanusha në rrjedhat e historisë*, Tetovë, 2015, f. 114.

10. Shiko: Grup autorësh, *Kumanova, përktlyer në gjubën shqipe*: Liri Lena, Kumanovë, 2004, f. 261.

e këtyre trevave prej sundimit të Perandorisë Osmane nën sundimin e Mbretërisë Serbe Kroate Sllovene (SKS) dhe me marrëveshjen paqësore mes Perandorisë Osmane dhe Mbretërisë Serbe (SKS), e arritur në Stamboll më 14-1 mars 1914, Mbretëria Serbe do të ketë sundim absolut mbi popullatën myslimane në përgjithësi dhe mbi popullatën shqiptare në veçanti.¹¹

Arsimi, para luftës (Luftës së Dytë Botërore), ishte karakteristikë e përgjithshme e bazës materiale, kishte zhvillim të pamjaftueshëm dhe kishte prapambetje. Vetëm një pjesë e vogël e popullsisë arriti të merrte arsimin e përgjithshëm dhe profesional. Analfabetizmi i popullatës në moshën mbi 10 vjeçare ka qenë shumë i madh, kurse arsimi i përgjithshëm i popullsisë ishte shumë i ulët. Para luftës ka pasur rreth 40% banorë analfabetë, shumicën e përbënin gratë. Kishte vise në të cilat, për shkak të rrjetit jo mjaft të zhvilluar, nuk zhvillohej as arsimi fillestar i përgjithshëm. Pos kësaj, disa kombe përfshirë edhe shqiptarët, s'kanë pasur mundësi të mësojnë nëpër shkolla në gjuhën e vet amtare.¹²

11. Tryezë shkencore, *80 vjet të kushtetutshmërisë së BFI-së*, (Taxhedin Bislimi), f. 29.

12. Shiko: Grup autorësh, *Historia për klasën e II të fazës së parë të edukimit dhe arsimimit të mesëm të orientuar*, Botimi i dytë, Prishtinë, 1978, f. 185.

Meqë ranë dakord për marrëveshjen paqësore Perandoria Osmane dhe Mbretëria Serbe (SKS), marrëveshje e cila për shqiptarët ishte diskriminuese në gjitha sferat e jetës, duke përfshirë edhe sferën e arsimit, treva e Kumanovës, si pjesë më e madhe e tokave shqiptare, bie nën sundimin e Serbisë. Serbia për interesa të veta hapi shkolla serbe në Kumanovë dhe në disa vendbanime shqiptare, në Rramanli, Llopat, Opajë, Mateç, etj. Ndonëse në shkolla kishin për qëllim t'i asimilonin shqiptarët, një gjë të tillë nuk e arritën. Ata shqiptarë të pakët që mësuan, përsëri nuk u asimiluan. Në të njëjtën mënyrë vepruan edhe bullgarët.¹³

Ajo që vërteton se vetëm një pjesë e vogël e popullsisë ka mundur të mbarojë arsimin e përgjithshëm është përfshirja e pakët e nxënësve shqiptarë, ku kemi të dhëna për në vitin shkollor 1923/24, 1924/25 dhe në vitin 1928/29 kur mësimi në shkollat fillore ishte në gjuhën serbo-kroate.

Tabela 1. Tregon përqindjen e përfshirë të shqiptarëve në shkollat fillore.¹⁴

13. Shiko: *Tribunë shkencore, Studime albanologjike*, vëllimi 3, (Naim Halimi), f. 47.

14. Shiko: Avzi Mustafa, *Edukata dhe arsimi nëpër shekuj*, Shkup, 1997.

Viti shkollor	Përqindja e përgjithshme e nxënësve	Përqindja e nxënësve shqiptarë
1923/24	83,13 %	1,76 %
1924/25	84,12 %	3,98 %
1928/29	84,72 %	5,28 %

Arsimimi gjatë Luftës së Dytë Botërore

Gjatë Luftës së Dytë Botërore mësimi në përgjithësi nuk u zhvillua për arsye se shumë shkolla ishin shkatërruar, disa u shndërruan në kazerma, burgje, etj. Menjëherë pas çlirimit (përfundimit të luftës) shkollimi filloi të zhvillohet me vrull për arsimim më të gjerë për të gjithë popujt.¹⁵

Këtij çrregullimi nuk mundi t'i ikin as territoret e Maqedonisë të cilat në të ardhmen do të ballafaqohen me mungesën e shkollave si rezultat i dëmtimit të tyre. Mirëpo, pas kalimit të “krizës” nga lufta gjërat do të fillojnë të marrin drejtim tjetër në bazë të asaj që kishte filluar për arsimin e të gjithëve, pasi paraqiste një nga problemet më serioze.

Në nivel të Maqedonisë në vitin shkollor 1944/45 punojnë vetëm 50 shkolla fillore në gjuhën shqipe, edhe ato në ato vende ku shkolla kishte ekzistuar edhe më herët dhe nuk ishte dëmtuar, sepse

15. Shiko: Grup autorësh, *Historia për klasën e II të fazës së parë të edukimit dhe arsimimit të mesëm të orientuar*, Botimi i dytë, Prishtinë, 1978, f. 185.

popullata shqiptare jetonte nëpër fshatra dhe nuk ka pasur mundësi që në të gjitha fshatrat të ndërtohen apo adaptohen objekte shkollore. Mirëpo, kishte raste kur në një vend ekzistonte shkolla por ishte larg e fëmijët udhëtonin 10 kilometra larg. Atëherë, meqë kjo ishte e vështirë të realizohet, Ministria lejoi që të themelohen shkolla në fshatrat ku kishte më shumë nxënës, kurse si shkolla të përdoren mejtepet e xhamive, ndërsa atje ku nuk kishte mejtep u lejua që mësimi të zhvillohet në shtëpitë private.¹⁶

Në Kumanovë prej periudhës së viteve 1912 deri në periudhën e viteve 1945, nuk punoi ndonjë shkollë shqipe. Gjatë kësaj periudhe funksiononin vetëm shkollat fetare, mejtepet dhe medresetë.¹⁷

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, në Kumanovë dhe rrethinë, filloi procesi i hapjes masive të shkollave në gjuhën

16. Shiko: Avzi Mustafa, *Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë 1945-1975*, Shkup, 1998, f. 68.

17. Shiko: Grup autorësh, *Me veteranët e arsimit shqip në Kumanovë dhe rrethinë (1945-1950)*, Shkup, 1997, f. 10.

shqipe. Në dhjetor të vitit 1944, ish-Jugosllavia akoma nuk ishte në tërësi e çliruar, në Kumanovë u formua një komision për evidentimin e nxënësve shqiptarë. Këtë Komisioni e përbënin: Shaban Osman Jashari, Shinasi Hallaçi, Refik Shaqiri dhe Azem (Hoxha) Latifi.¹⁸

Për këtë qëllim, me një autorizim të lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Brigadës së IV Shqiptare që mbante datën e 10 janarit të vitit 1945, të nënshkruar nga Nexhat Agolli, si dhe autorizimin tjetër që mbante datën 21 janar të vitit 1945, të lëshuar në Preshevë nga Këshilli i Frontit Nacional - Çlirimtar i po së njëjtës brigadë, të nënshkruar nga sekretari Abdullah Aliu - Krashnica (në gjuhën shqipe dhe serbe), oficeri i mobilizimit i kësaj brigade, Skender Demir Hoxha ngarkohet me detyrën për organizimin e Shkollave Shqiptare si dhe mësimëve në Kumanovë dhe rrethinë.¹⁹

Në dhjetor të vitit 1944, në Kumanovë, shkolla “Bajram Shabani”, e njohur në fillim edhe me emrin “Bajram Cimi”, kishte filluar së funksionuari në mënyrë normale si shkollë shqipe, duke u bërë institucioni i parë pasluftës ku mësohej gjuha shqipe. Dy vite më pas më 1945/46 karakterizohet me faktin se në këtë vit shkollor për herë

të parë hapet shkolla e plotë fillore ose pro-gjumnazi me kohëzgjatje prej shtatë vjetëve (shtatëvjeçare). Si rezultat i kësaj merr edhe zyrtarisht emrin “Bajram Shabani”, në fillim nuk mbante kurrfarë emri, por quhej “shkolla fillore shqipe”. Refik Shaqiri, për vetë faktin se ishte mësues në këtë shkollë, ushtroi edhe funksionin e inspektorit të shkollave shqipe në rrethinën e Kumanovës, ndërsa nxënësit shqiptarë mësonin me abetaren e hartuar nga mësuesi i Gostivarit, Abdylhaqim Dogani, si dhe me abetaret e ardhura nga Shqipëria.²⁰

Mirëpo një fat të tillë nuk e pati rrethina e Kumanovës, respektivisht Komuna e Likovës, e cila ndjente mungesën e objekteve për zhvillimin e mësimin në gjuhën shqipe. Një vit pas (1945) në rrethinën e Kumanovës dhe në komunën e Likovës do të fillonte të zhvillohej mësimi në gjuhën shqipe, por kësaj here në objektet e mejtepeve.²¹

Arsimimi pas Luftës së Dytë Botërore

Pas Luftës së Dytë Botërore me hapjen e shkollave në gjuhën shqipe në trevat shqiptare, ku kishte mungesë të jashtëzakonshme të ambienteve, lokaleve dhe ndërtesave

18. Shiko: Agim Rushiti, *Me pishtarët e arsimit shqip në Komunën e Kumanovës e të Lipkovës (1945-1960)*, Kumanovë, 2000, f. 14.

19. Po aty, f. 15.

20. Shiko: Grup autorësh, *Me veteranët e arsimit shqip në Kumanovë dhe rrethinë (1945-1950)*, Shkup, 1997, f. 13.

21. Shiko: Tefik Jahiu, *Arsimi shqip në Kumanovë*, Kumanovë, 1996, f. 53.

shkollore, mejtepet pranë xhamive ishin foletë e para të arsimit shqip në këto treva. Edhe pse ndoshta mejtepet nuk i plotësonin kushtet dhe standardet për organizimin e mësimi, sepse ato ishin ndërtesa të vogla dhe nuk kishte mundësi që për secilën klasë të ketë ambient më vete, ato për momentin ishin ambientet e vetme në të cilat mund të zhvillohej mësimi. Këto shkolla kryesisht ishin vendosur nëpër lokalet e mejtepeve të xhamive, ku mësimi zhvillohej në kushte tejet të vështira, pa banka dhe karrige të mjaftueshme, pa mjete të tjera mësimore dhe pa kushte të tjera higjienike-sanitare.²²

Mungesa e objekteve shkollore ishte si shkak për mos inkuadrimin e nxënësve myslimanë në to, sepse në hapësirat ku jetonin popullata myslimane, numri i shkollave është minimal. Kjo është rezultat i udhëheqjes së keqe të politikës diskriminuese arsimore nga ana e faktorëve kompetentë.²³ Nga momenti që Ministria e Arsimit e asaj kohe do të vërente mungesën e objekteve shkollore, do të lejonte adaptimin e shkollave në drejtim të shkollës fillore, e që në rastin konkret, në rajonin e Kumanovës, do të ishin objektet e mejtepeve; atëherë kemi rritje të

interesimit nga ana e popullit shqiptar për mësimin e fëmijëve të tyre.

Në prill dhe maj të vitit 1945, në fshatin Mateç fillojnë të punojnë dy klasë dhe mësimi zhvillohej në ndërtesën e mejtepit të xhamisë. Po ashtu, në mejtepin e xhamisë fillon të punojë edhe klasa e parë shqipe në fshatin Rramanli.²⁴ Fatim e tillë e patën edhe mejtepet e rrethinave të Shkupit, të cilat në periudhën komuniste kishin shërbyer si shkolla fillore shqipe për nxënësit e fshatit.²⁵

Viti 1945 në objektet e mejtepeve të rajonit të Kumanovës do të shënonte hapjen e shkollave në 13 fshatra. Në procesin edukativo-arsimor inkuadrohen 26 mësues, ndërsa numri i nxënësve arrin në 800.²⁶ Ndërsa sipas një të dhëne tjetër thuhet se numri i nxënësve arrinte në 730 nxënës me të cilët punonin 19 mësues.²⁷ Si do që të jetë, e rëndësishme ishte se filloi të zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe. Andaj organet arsimore i angazhuan mësuesit nëpër fshatrat e rrethinës së Kumanovës.

Tabela 2. Paraqet emrat e fshatrave të rajonit të Kumanovës dhe emrat e arsimtarëve të parë (1945) pas hapjes së shkollave të para shqipe.

24. Shiko: Po aty.

25. Shiko: Taxhedin Bislimi, *Grushina në të kaluarën dhe sot*, Shkup, 2013, f. 90.

26. Shiko: Tefik Jahiu, *Arsimi shqip në Kumanovë*, Kumanovë, 1996, f. 54-55.

27. Agim R. Rushiti, *Me pishtarët e arsimit shqip në Komunën e Kumanovës e të Lipkovës (1945-1960)*, Kumanovë, 2000, f. 17.

22. Taxhedin Bislimi, *“Medreseja Medab” e Atanllah efendiut dhe nxënësit e saj*, Shkup, 2011, f. 56.

23. Shiko: *Konferencë shkencore, Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy Luftërave Botërore*, (Taxhedin Bislimi), f. 405.

Emri i fshatit	Emri i mësuesit (arsimtarit)
Llojan	Ahmet Hasani dhe Qemal Jahija
Runicë	Zeqir Rushiti
Sllupçan	Elizabeta Maho
Orizare	Elham Destani
Likovë	Ibrahim Stëblava dhe Ahmed Kardijsa
Hotël	Mehmet Haliti dhe Nazim Destani
Mateç	Sami Namani dhe Selami Tanaku
Vishticë	Baudin Vilica
Nikushtak	Ekrem Alajdini dhe Adem Hajrullahu

Shkollat edhe pse ekzistonin me emër në vendet e caktuara ato kryesisht ishin vendosur nëpër lokalet e mejtepeve të xhamive, për shkak se objektet e shkollave nuk ishin në gjendje për të organizuar procesin mësimor apo kishte mungesë të objekteve shkollore.

Tabela 3. Paraqet emrat e disa fshatrave të rajonit të Kumanovës dhe emrat e shkollave fillore.²⁸

Emri i fshatit	Emri i shkollës
Mateç	“Haxhi Lleshi”
Llojan	“Sali Iljazi”
Sllupçan	“Bajram Shabani”
Vishticë	“Sami Frashëri”
Orizare	“Emin Duraku”
Likovë	“Vëllaznimi”
Runicë	“Drita”
Vaksincë	“Selami Hallaçi”
Hotël	“Bashkimi”
Allashec	“Përparimi”

28. Shiko: Grup autorësh, *Me veteranët e arsimit shqip në Kumanovë dhe rrethinë (1945-1950)*, Shkup, 1997, f. 12.

Mungesa e objekteve shkollore u bë fenomen i njohur si për shqiptarët në përgjithësi po ashtu edhe për shqiptarët e rajonit të Kumanovës. Arsytet ishin nga më të ndryshmet, por ajo që ndikonte ishte kur fondi shtetëror i mjeteve kaloi në kompetencat e komunave, andaj fakti tjetër që i rëndoi shqiptarët ishte kur komunat i caktonte në vendbanimet që ishin me popullatë sllave.²⁹

Pasi fondi shtetërorë i mjeteve kaloi në kompetencë të komunave, sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 1973, në 375 vendbanime nuk kanë ekzistuar as shkolla fillore katërvjeçare. Mes tyre në rajonin e Kumanovës ishin fshati Vaksincë me 1.950 banorë, Opajë me 1.086 dhe fshati Orizare me 1.284 banorë.³⁰

Mësimi zhvillohej në kushte të vështira ngaqë nxënësit shtoheshin

29. Shiko: Avzi Mustafa, *Shënime arsimore-fetare shqiptare*, Shkup, 2016, f. 42.

30. Shiko: Avzi Mustafa, *Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë 1945-1975*, Shkup, 1998, f. 71-72.

dhe nuk kishin as banka as karrige të mjaftueshme për të gjithë, pa mjete të tjera mësimore dhe pa kushte të tjera higjienike-sanitare, ata ishin të detyruar të rrinin nga katër apo pesë veta në një bankë. Megjithatë, te mësuesit ekzistonte një ambicie dhe vullnet i pathyeshëm për mposhtjen e këtyre pengesave. E mira e kësaj ishte edhe ajo se filluan edhe vajzat e fshatrave të shkollohen edhe pse me shumë vështirësi ato ndiqnin mësimin për shkak të rrethanave dhe kushteve të asaj kohe.³¹

Në lidhje me vështirësinë e shkollimit të vajzave pohon edhe mësuesja Elizabeta Maho, që ishte mësuese në fshatin Sllupçan, kur thotë: *“Patjetër dua të theksoj se vështirësia më e mëdha gjatë hapjes së shkollave ishte kuadri, veçanërisht regjistrimi i vajzave. Kishin probleme edhe te gratë shqiptare për heqjen e ferexhesë.”*³²

Më lart theksuam se në vitet e para pas çlirimit, aksioni i madh nga ana e Ministrisë së Arsimit ishte i orientuar në hapjen e sa më shumë shkollave fillore, sidomos atyre katërvjeçare e më vonë edhe shtatëvjeçare, që përfshinte edhe shkollat shqipe të cilat mësimin do ta ndiqnin në ato vende ku kishte shkolla dhe që kishte kushte për të zhvilluar procesin arsimor, dhe në rast mungese, mësimi do të zhvillohej në objektet e adaptuara si shkolla fillore.

Në vazhdim paraqesim dy tabela përmes të cilave do të kemi një pasqyrë më konkrete të shkollave shqipe gjatë viteve shkollore prej 1944/45 deri në vitin 1949/50, edhe atë në nivel shtetëror dhe në nivel të Kumanovës me gjithë rrethinën e saj.

Tabela 4. Shkollat shqipe në nivel shtetëror.³³

Viti shkollor	Shkollat katërvjeçare	Shkollat shtatëvjeçare	Gjithsej
1944/45	50	/	50
1945/46	136	6	142
1946/47	143	5	148
1947/48	161	5	166
1948/49	172	7	179
1949/50	198	11	209

31. Shiko: Grup autorësh, *Me veteranët e arsimit shqip në Kumanovë dhe rrethinë (1945-1950)*, Shkup, 1997, f. 12-13.

32. Minir Ademi, *Arsimi dhe kultura shqiptare në Maqedoni (1944-1960)*, Kumanovë, 2018, f. 49.

33. Shiko: Avzi Mustafa, *Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë 1945-1975*, Shkup, 1998, f. 84.

Tabela 5. Shkollat shqipe në nivel të Kumanovës dhe rrethinës së saj.³⁴

dokumenti me shifër AE/318-215, e gjetur në Arkivin e Kumanovës.³⁵

Viti shkollor	Shkollat katërvjeçare	Shkollat shtatëvjeçare	Gjithsej
1944/45	1	/	1
1945/46	15	1	16
1946/47	20	1	21
1947/48	21	2	23
1948/49	23	2	25
1949/50	24	2	26

Ministria e atëhershme kishte dhënë leje për shumë objekte të cilat do të mund të adaptoheshin në shkolla fillore me të vetmin qëllim vazhdimin e procesit arsimor, e në rast mungese të objekteve të tilla apo atje ku nuk kishte qoftë edhe mejtep, u lejua që mësimi të zhvillohet në shtëpitë private. Andaj në vitin 1949/50, mund të thuhet se ishte viti i suksesit për faktin se me iniciativën e vetë fshatarëve u organizua mësimi edhe në fshatin Llukarë në shtëpinë e Hamdi Sulisit, sepse deri në atë periudhë në fshat nuk pati objekt ku mund të organizohej mësimi. Gjithashtu është me rëndësi fakti se do të dalë gjenerata e parë e gjysmëmaturantëve shqiptarë në shkollën fillore të Kumanovës “Bajram Shabani”. Të dhënat janë sipas një

Arsimimi gjatë viteve 1944 - 1950

Sipas përshkrimit të viteve shkollore nga viti 1944 e deri në vitin 1950, numri i shkollave është paraqitur me të vetmin qëllim për të dëshmuar rolin e mejtepeve në rajonin e Kumanovës të cilët u gjendën në shërbim të popullit shqiptar për mësimin në gjuhën amtare shqipe. Rritja e numrit të nxënësve, të cilët ndiqnin shkollimin, edhe pse të cunguar dhe në kushte jo të volitshme për mësim; ata përsëri gjetën vullnetin për ndjekjen e mësimin në gjuhën shqipe.

Në pamundësi për të marrë ndonjë lloj interviste nga ish-nxënësit të cilët kishin mësuar në ato kohë në mejtep e që në fakt ishin shndërruar në cilësinë e shkollës fillore, atëherë si burim do i referohemi librit Monografi e fshatit Nikushtak. Në pjesën e këtij libri ku flitet për kronologjinë

34. Shiko: Minir Ademi, *Arsimi dhe kultura shqiptare në Maqedoni (1944-1960)*, Kumanovë, 2018, f. 14, 15 dhe 16. Po ashtu shiko: Agim Rushiti, *Me pishtarët e arsimit shqip në Komunën e Kumanovës e të Lipkovës (1945-1960)*, Kumanovë, 2000, f. 20.

35. Shiko: Agim Rushiti, *Me pishtarët e arsimit shqip në Komunën e Kumanovës e të Lipkovës (1945-1960)*, Kumanovë, 2000, f. 20.

e zhvillimit të shkollës fillore është dëshmuar se në atë kohë, me hapjen e shkollave shqipe gjatë vitit 1945-1946, mejtepi i fshatit Nikushtak si shumë mejtepe të fshatrave të tjerë do të shfrytëzohej si shkollë fillore. Gjatë periudhës kohore 1946-1947 drejtor i shkollës fillore ka qenë Hafëz Ekrem Ahmedi.³⁶

Me hapjen e shkollës fillore, klasa e parë ka numëruar 25 nxënës prej moshës 6 deri 10 vjeç, ndërkohë nxënësit e moshës mbi 10 vjeç, mësimin do ta ndjekin në të ashtuquajturën “shkolla e natës”.³⁷ Nga ana tjetër, duke u bazuar në burimet e shkruara, të cilat janë të botuara nëpër libra, mund të arrijmë në përfundimin se në masë të madhe nëpër fshatrat e Komunës së Likovës nga viti 1945 deri në vitin 1950 mësimi u zhvillua nëpër objektet e mejtepeve.

Për të vërtetuar këtë që thamë deri më tani, në vazhdim do të paraqesim disa të dhëna të cilat i bazojmë në librin “Me pishtarët e arsimit shqip në Komunën e Kumanovës e të Likovës (1945-1950)”, e që vërtetohet se shkollat filluan të ndërtohen pas viteve 1950.

Në shtator të vitit 1948 hapet shkolla e parë në gjuhën shqipe në fshatin Goshincë. Në dy vitet e para mësimi u zhvillua në mejtepin e xhamisë që më pas të kalohet në

objekt (shkollë) me mësonjëtoje dhe zyrë të ndërtuar me kontributin e fshatarëve. Do të thotë se gjatë periudhës së ndërtimit të objekti të shkollës, mësimi u zhvillua në mejtepin e xhamisë së fshatit.³⁸

Në vitin shkollor 1951/52 në fshatin Llukarë u hap shkolla fillore në gjuhën shqipe. Po ashtu, në të njëjtin vit, u ndërmor aksion për ndërtimin e shkollës fillore. Ndërsa si rezultat i mungesës së shkollës shqipe në fshatin Llopat dhe Rezhanoc prej vitit 1950 deri në vitin 1966 nxënësit e këtyre fshatrave mësimin do ta ndiqnin në fshatin Opajë të Komunës së Likovës.³⁹

Në vitin 1958, mes fshatrave Orizare dhe Sllupçan, me vetë kontributin e dy fshatrave u ndërtua godina e re e përbashkët shkollore ku fillon të funksionojë edhe klasa e pestë. Kjo shkollë solemnisht do të hapet për nxënës më 27 mars 1959. Ndërsa një vit më vonë, në vitin 1960, mes fshatit Vaksincë dhe Llojan, vendoset gurthemeli i godinës shkollore, e cila u adaptua dhe u lëshua në vitin shkollor 1962/63.⁴⁰

Roli i mejtepeve gjatë viteve 1945-1950 ishte vendimtar në zhvillimin e arsimit shqip

38. Shiko: Agim Rushiti, *Me pishtarët e arsimit shqip në Komunën e Kumanovës e të Likovës (1945-1960)*, Kumanovë, 2000, f. 20.

39. Shiko: Po aty, f. 22.

40. Shiko: Po aty, f. 23.

36. Shiko: Faredin Ebibi, *Monografi e fshatit Nikushtak*, Shkup, 2016, f. 53-54.

37. Shiko: Po aty.

Nga ajo që u paraqit më parë pamë se gjatë periudhës së sundimit të SKS-së, shqiptarët e kishin të ndaluar mësimin në gjuhën shqipe, sepse përballeshin me një sistem i cili mësimin e gjuhës shqipe e konsideronte të rrezikshëm dhe krim ndaj sistemit serb. Politika e viteve 1945 do të ndryshonte e nga ky ndryshim do të përparonte edhe gjendja e arsimit.

Gjatë kësaj periudhe do të mundësohej edhe mësimi në gjuhën shqipe për zonat të cilat ishin me popullatë shqiptare. Mirëpo, në zonat shqiptare procesi do të ngeçë për shkak të mungesës së objekteve shkollore, mungesë së cilës i kishin paraprirë pasojat nga Lufta e Dytë Botërore.

Tabela 6. Pasqyra e gjendjes numerike në shkollat fillore në nivel shtetëror në fillim të vitit 1945.⁴¹

Gjithsej	Jo të dëmtuara	Pjesërisht të dëmtuara	Të dëmtuara (të djegura)
836	272	373	191

Për shkak se shkollat nuk plotësonin kushtet për procesin e zhvillimit arsimor, e që për banorët e rajonit të Kumanovës zhvillimi i mësimin do të haste vështirësi, atëherë në ndihmë atyre iu dolën objektet e mejtepeve, objekte të cilat u adaptuan për të zhvilluar

41. Shiko: Avzi Mustafa, *Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë 1945-1975*, Shkup, 1998, f. 67.

mësimin në gjuhën shqipe.

Nga ajo që kemi paraqitur më herët pamë se në 9 mejtepet e xhamive në fshatrat e rajonit të Kumanovës u mundësua mësimi në gjuhën shqipe, që për ta ishin vërtet vite historike dhe vendimtare, për arsye se vinin nga një periudhë kur e kishin të ndaluar mësimin në gjuhën e tyre amë.

Nëse futemi në analizën e kësaj dhe shohim se në rast mungese të objekteve të mejtepeve, atëherë kush do të i dilte në ndihmë popullit shqiptar?! Sepse nga e kaluara e brishtë e sistemeve kemi parë se çdoherë ishin diskriminues për popullin shqiptar, sidomos nga ana praktike. Kur jemi në këtë pjesë të sistemet e brishta, duhet pohuar edhe një e vërtetë e brishtë e cila vinte fatkeqësisht nga disa individë shqiptarë, të cilët kishin depërtuar në organet shtetërore,

duke propaganduar se: “*Kush shkon në shkollë është i pa fe, pa din, pa iman, bëhet shkeja etj.*”⁴² Kjo propagandë kishte ardhur si rezultat i rrethanave kur populli, pa u menduar fare, mori pjesë në dërgimin e fëmijëve në shkolla.

Në fund të kësaj rezulton se institucioni mejtepi ishte dhe është

42. Shiko: *Tribunë shkencore, Studime albanologjike*, vëllimi 3, (Naim Halimi), f. 49.

në shërbim të popullit dhe për popullin, ndërsa me theks të veçantë gjatë viteve 1945-1950 kur pati rolin e shkollës fillore në rajonin e Kumanovës.

Mejtepjet kishin mungesa primare për zhvillimin e procesit mësimor.

Mejtepjet filluan si shkolla fillore në vitin 1945, mirëpo ato nuk kishin hapësira të mjaftueshme për të gjithë nxënësit, sepse ato ishin ndërtesa të vogla dhe nuk kishte mundësi që për secilën klasë të kishte ambient më vete, por ato, për momentin, ishin ambientet e vetme në të cilat mund të zhvillohej mësimi. Mësimi zhvillohej në kushte tejet të vështira, pa banka dhe karrige të mjaftueshme, pa mjete të tjera mësimore dhe pa kushte të tjera higjienike-sanitare. Nga që kishte mungesa primare si fletore, libra, lapsa, etj., ato u plotësuan nga vetë populli, sipas mundësisë, sepse pushteti në shkollat shqipe i plotësonte aq sa donte dhe jo sa kishte nevojë.

Nga kjo që paraqesim dhe analiza që mund të bëhet shohim se sa interes kishte sistemi Jugosllav për arsimimin e shqiptarëve, sepse edhe pse morën hov të madh për t'iu siguruar mësim çdo njërit në gjuhën e vet, donin t'i tregonin botës se janë për barazi të popujve dhe se nuk e ndalonin shkollimin në gjuhën amtare, por nga ana tjetër nuk ua plotësuan kushtet dhe nevojat më elementare për mësim, sepse objektet më të mira i merrnin për vete ndërsa për shqiptarët caktonin objekte të vjetra.

Kështu arrijmë në përfundimin se sistemi kishte politikën për arsimimin e shqiptarëve vetëm sa për sy e faqe dhe për t'i treguar botës se janë për të gjitha kombet. Ndërsa realiteti në terren, pasqyra e tij, tregonte të kundërtën e deklaramit të tyre për faktin se vetë mungesa e skajshme e kushteve tregon se shteti nuk kishte ndërmarrë iniciativë për t'i përkrahur shkollat shqipe.

Bibliografia

- Ademi, Minir, Arsimi dhe kultura shqiptare në Maqedoni (1944-1960), Kumanovë, 2018.
- Ademi, Minir, Hotla nëpër kohë, Kumanovë, 2017.
- Arifi, Feri, Tanusha në rrjedhat e historisë, Tetovë, 2015.
- Bislimi, Taxhedin, Medreseja Medah e Ataullah efendiut dhe nxënësit e saj, Shkup, 2011.
- Ebibi, Faredin, Monografi e fshatit Nikushtak, Shkup, 2016.
- Grup autorësh, Bazat e marksizmit dhe vetëqeverisja socialiste për vitin III dhe IV të fazës së dytë të amos, Prishtinë, 1980.
- Grup autorësh, Historia për klasën II të fazës së parë të edukimit dhe arsimit të mesëm të orientuar, Botimi i dytë, Prishtinë, 1978.
- Grup autorësh, Kumanova: Histori, art, traditë, kulturë, Botimi i dytë i plotësuar, përkthyer në gjuhën shqipe nga Liri Lena, Kumanovë, 2004.
- Grup autorësh, Me veteranët e arsimit shqip në Kumanovë dhe rrethinë (1945-1950), Shkup, 1998.
- Jahiu, Tefik, Arsimi shqip në Kumanovë, Kumanovë, 1996.
- Konferencë shkencore, Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy Luftërave Botërore, vëllimi 30, 14-15 tetor 2015, Shkup, 2015.
- Mustafa, Avzi, Edukata dhe arsimi nëpër shekuj, Shkup, 1997.
- Mustafa, Avzi, Shënime arsimore-fetare shqiptare, Shkup, 2003.
- Mustafa, Avzi, Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë 1945-1975, Shkup, 1998.
- Rushiti, Agim, Me pishtarët e arsimit shqip në komunën e Kumanovës e të Lipkovës (1945-1960), Kumanovë, 2000.
- Tribunë shkencore, Studime albanologjike, vëllimi 3, Shkup, 2011.
- Tryezë shkencore, 80 vjet të kushtetutshmërisë së BFI-së, Shkup, 2017.

Trajtimi i çështjeve të familjes në gazetën “Drita Islame” (1992-2011) në aspektin edukativ

Msc. Migena Jani

Abstrakt

Viteve të fundit vibet re një shtim i numrit të divorceve, i fëmijëve të braktisur, i shtimit të dhunës në familje, rritje të shkallës së konflikteve ndërmjet anëtarëve të familjes, dobësim të rolit shoqëror të familjes, mungesë të edukimit të vlerave dhe virtyteve të fëmijët. Shtet një lëkundje e themeleve të ‘shtetit të vogël’, i cili vazhdon të humbasë qëllimin dhe funksionet e tij kryesore.

Ky shkatërrim dhe dëmtim i familjes, ndikohet nga dy faktorë kryesorë: mungesa e edukimit të fëmijëve në familje me vlerat moral-fetare në institucionin e familjes dhe nga ndikimi i madh i mjedisit shoqëror mbi familjen.

Qëllimi i kërkimit është të provojë se do të merremi me influencën, që ka një thesar i çmuar siç është gazeta dhe revista “Drita Islame”, e cila ka luajtur dhe po luan rol misionar ndriçues në trajtimin e çështjeve të familjes. Pyetjet e ngritura sesi edukimi fetar e forcon familjen dhe se sa i madh mbetet roli që ka familja në edukimin e fëmijëve morën përgjigjet e dubura. Hipoteza se periodiku “Drita Islame” ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në trajtimin e çështjeve të familjes edhe në aspektin edukativ, psikologjik, social etj., u provua me shumë saktësi.

Punimi shkencor-kërkimor ka përdorur metodologji cilësore, duke u bazuar në trajtimin e çështjeve të familjes nën dritën e ajetete kur’anore, traditën profetike të trajtuara të “Drita Islame” (1992-2017), rubrika të cilat janë udhërrëfyes për një familje të fortë, e cila bazohet në vlera e virtyte morale dhe fetare tradicionale, që përforcohen edhe tani.

Fjalët kyçe: *familja shqiptare, prindërimi, moral-fetar, ajetet kur’anore, tradita profetike, “shteti i vogël”*

Futja në shpirt e besimit islam fillon nga familja. Populli shqiptar, në përgjithësi, është besimtar. Pavarësisht regjimit komunist, në shpirtin e tyre jetoi e mbeti e gjallë dashuria e respekti për Zotin e Madh (xh.sh.). Rrënjët e mbijetesës së këtij besimi, në shpirtin e popullit ndodhen te familja, e cila është fillesa e qendra e besimit te fëmijët. Mirëpo, edhe ndikimi që kanë pasur shkollat ka qenë mjaft i madh saqë, ky edukim fetar, ka ndikuar shumë edhe te prindërit e familjarët e tjerë. Gjithashtu është shtuar edhe numri i literaturës fetare nëpër biblioteka, të cilat shfletohen nga mjaft të rinj. Rol të rëndësishëm në informimin e familjes, në aspektin fetar, kanë luajtur edhe ndjekja e radiove, organizuar nga bashkësia e Rinisë Islame. Ky emision ndiqet nga shumica e familjeve; gjithashtu është shtuar numri i lexuesve të gazetës “Drita Islame”, të cilën, në shumicën e rasteve, e dërgojnë në shtëpi nxënësit e medresesë. Kështu arrijmë në përfundimin se lidhja e shkollës me familjen, në këtë drejtim, po ndikon në rritjen e rolit të kësaj të dytës në shtimin e njerëzve që ndjekin e besojnë në fenë islame.¹

Po të shikojmë temën “*Futja në shpirt e besimit fetar fillon nga familja*”, autori, Idriz Kali, e ka trajtuar në

1. Idriz Kali, *Futja në shpirt e besimit Islam fillon nga Familja*, gazeta “Drita Islame”, mars 1993, nr. 4, f. 2.

aspektin edukues dhe fetar. Autori i jep një rëndësi të madhe edukimit fetar dhe bashkëpunimit shkollë-familje. Siç duket edhe te trajtimi i çështjes së mësipërme, shkollat, siç janë edhe medresetë, kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve, si në aspektin fetar ashtu edhe në atë arsimor, si dhe lidhja ngushtë e institucionit të shkollës me familjen, apo e nxënësve me prindërit, ka sjellë një ndikim mjaft të madh te prindërit, duke u bërë një udhërrëfyes në rrugën e besimit. Autori thekson se një rol tjetër të rëndësishëm për edukimin fetar kanë luajtur edhe disa elementë të tjerë si radiot, gazeta “Drita Islame”, etj...

Përgjegjësia e prindërve për edukimin e fëmijëve me normat e moralit islam

Në dispozitat e Kur’anit i kushtohet një rëndësi e veçantë punës edukative me fëmijët e brezin e ri, si problem themelor që lidhet drejtpërsëdrejti me njohjen e një Zoti të vetëm. Allahu xh.sh. urdhëron e thotë: **“O ju që keni besuar mbronni vetveten dhe familjen tuaj nga zjarri...”**² Nga ky ajet del një dispozitë me rëndësi edukative me normat morale të fesë islame për fëmijët në moshë të njomë. Prindi, nëpërmjet edukatës familjare duhet të arrijë të nxjerrë vlerat e ndjenjave morale e

2. Kur’an, Tahrir, 66:6.

fetare, si faktorë të rëndësishëm të personalitetit në formim të fëmijëve, duke u bazuar në zhvillimin dhe edukimin e proceseve njohëse, të lidhura ngushtë me qëndrimin emocional pozitiv të fëmijëve ndaj realitetit. Por nuk ndodh gjithmonë kështu, sepse te prindërit shihen dy tendenca kryesore; ajo e shfaqjes së indiferentizmit dhe e sentimentalizmit, të cilat, në këtë periudhë, nuk duhet të manifestohen, por të punohet me kujdes dhe në mënyrë korrekte për mënjanimin e tyre. Edukimi duhet të vazhdojë te fëmijët në moshë sa më të vogël, sepse ndikimi edukativ në këtë moshë është i rëndësishëm, jo vetëm për zhvillimin mendor dhe emocional, por edhe për formimin e shprehive dhe zakoneve të caktuara morale e fetare dhe për kthimin e tyre më vonë në veti të karakterit. Në këtë mënyrë shprehet edhe rëndësia e madhe që ka për edukimin e ndjenjave dhe të gjitha anëve të personalitetit të fëmijëve, zhvillimi i aftësive për veprimtarinë dhe aktivitetin e deri në imitimin e prindërve në vënie në praktikë të riteve fetare. Prindërit janë pasqyra e familjes prandaj duhet të jenë shembull si me fjalë ashtu edhe me vepra, që të jenë sa më shumë ndikues te fëmijët e tyre. Përgjegjësia e familjes në edukatën fetare të fëmijëve i jep një kuptim të thellë jetës, sepse paralajmëron se Zoti është Një dhe se është fillimi dhe qëllimi i çdo ekzistence. Kjo fe

tregon vlerën e pafund të shpirtit të njeriut, i cili është në themel të natyrës Hyjnore, për të përvetësuar këto cilësi Hyjnore.

Prindër, edukojini fëmijët me normat morale të Islamit si: sinqeriteti, dashuria, barazia, ndershmëria, drejtësia, mëshira e të gjitha cilësitë e mira morale.

Përgjegjësia e prindërve për edukimin e fëmijëve normat e moralit islam. Kjo temë është trajtuar nga autori në aspektin edukativ-fetar ku autori në fillim flet për rëndësinë që ka edukimi, pasi ai është procesi themelor që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me njohjen e Allahut (xh.sh.). Autori thekson se edukimi duhet të vazhdojë te fëmijët në moshën sa më të vogël, sepse ndikimi edukativ në këtë moshë është i rëndësishëm, jo vetëm për zhvillimin mendor dhe emocional, por edhe për formimin e shprehive dhe zakoneve të caktuara morale e fetare dhe për kthimin e tyre më vonë në veti të karakterit. Prindërit janë përgjegjës për edukimin e fëmijëve, sepse prindërit janë pasqyrë e fëmijëve, edukimi i tyre s'duhet të mbetet vetëm me fjalë por edhe me vepra pasi veprat janë më ndikues te fëmijët. Prindërit përveç edukimit të vlerave dhe moralit, në përgjithësi, një rëndësi të madhe duhet t'i japin, në veçanti, edhe edukimit fetar, pasi ky edukim paralajmëron për kuptimin e thellë të jetës dhe ekzistencën e një Krijuesi të vetëm.

Tronditjet e thella në familjen shqiptare

Është me të vërtetë tronditës fakti, që gati çdo ditë në kronikën televizive si dhe në faqet e shtypit të përditshëm dëgjon dhe lexon lajme si këto: “bashkëshortët vrasin njëri-tjetrin, vëllai vret vëllain për një copë tokë, etj.”. Mirëpo këto lajme dëgjohej e lexohen gati çdo ditë! Dhe pikërisht këtu qëndron e keqja me e madhe; në familjen shqiptare po ndodhin të tilla ngjarje që tregojnë se themeli i saj po tronditet nga dita në ditë. Dhe s’ka dyshim se kjo ndodh sepse një pjesë e mirë e njerëzve kanë harruar që ka një Zot dhe po nuk ndoqe mësimet e Tij patjetër do të ndodhin ato që po e tronditin mbarë familjen shqiptare. Mungesa e besimit në Zot është një fakt mjaft i hidhur që po e paguajmë shumë shtrenjtë dhe në radhë të parë me humbjen e harmonisë familjare. Në ditët e sotme kemi shumë divorce, braktisje të fëmijëve, dërgimi i prindërve në azil, apo bashkëjetesa, etj. Një rol shumë negativ në shkatërrimin e familjes shqiptare, po luajnë edhe radiot, stacionet televizive, gazetat e revistat, të cilat propagandojnë shfaqjet më negative të shoqërisë njerëzore. Një rol tjetër negativ, në familjen shqiptare, luan edhe shkolla, ku shumë pak flitet për edukatën, kulturën, zakonet e traditat e bukura shqiptare, por është fakt i pranuar që në shkollën 8-vjeçare kanë vënë lëndën e edukimit

seksual që ndikon negativisht te fëmijët. Populli ynë vazhdimisht e ka konsideruar familjen si qelizën bazë të shoqërisë. Ai vazhdimisht është shquar për të ruajtur nderin e familjes, dashurinë dhe harmoninë mes njëri-tjetrit. Shqiptari e ka pasur për turp braktisjen e fëmijëve, të prindërve, të farefisit. Prandaj u bëjmë thirrje besimtarëve myslimanë, që të punojnë pa u lodhur për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes, ashtu siç e kërkojnë mësimet e të Plotfuqishmit. Edhe familja myslimane shqiptare ka pasur lëkundje, prandaj çdo besimtar mysliman duhet ta kuptojë më mirë se çdo njeri tjetër mësimin e madh të Islamit që na thotë: “Foleja familjare është elementi themeltar i shoqërisë. Aq sa pjesëtarët e saj respektojnë të drejtat dhe detyrat e njëri-tjetrit, po aq e fortë do të jetë dhe shoqëria”.

Tronditja e thellë në familjen shqiptare. Në këtë temë autori tregon për rëndësinë që ka familja, që për momentin ka pësuar një lëkundje të thellë në themelet e saj dhe kjo lëkundje ka ndodhur pikërisht për shkak të harresës dhe neglizhencës së edukatës fetare dhe harresës se ekziston një Zot. Një tjetër rol negativ që ka ndikuar në shkatërrimin e themeleve të familjes janë edhe shfaqjet televizive me propagandë negative, si dhe mungesa e edukatës morale nëpër institucionet shkollore. Autori prek edhe aspektin patriotik ku e cilëson familjen shqiptare si

një familje e cila është e ngritur në cilësi morale, prandaj ai i bën thirrje edhe një herë popullit shqiptar, sidomos atij besimtar, që të rizgjohet e të mbrojë tradita dhe zakonet e familjes së bukur shqiptare, pasi qëndrueshmëria e saj ka qenë ashtu siç e kërkojnë mësimet e Allahut (xh. sh). Nuk duhet harruar edhe roli i madh që familja ka në aspektin sociologjik, pasi një familje e fortë dhe e qëndrueshme është një sinjal dhe siguri për një shoqëri të fortë dhe të sigurt.

Edukimi i virtyteve një udhëtim që nis në fëmijëri

Kudo në këtë shoqëri, seksi dhe seksualiteti përfliten dhe shpërfaqen hapur. Në këtë klimë seksi të lirë dhe normash morale që po humbin, bëhet e domosdoshme për prindërit myslimanë që të jenë një hap më përpara me edukimin seksual të fëmijëve të tyre. Sot, megjithëse për shumë prej nesh, mendimi që t'u shpjegojmë fëmijëve tanë pse-të, si-të dhe ku-të e sjelljes sonë seksuale mes një burri dhe një gruaje na bën të skuqemi deri te veshët, nëse mendojmë një alternativë, do ta shohim se nuk kemi rrugëdalje. Edukimi seksual është një frazë tabu' për shumë myslimanë. Pjesërisht arsyeja për këtë keqkuptim buron nga fakti se njerëzit që nxisin lapërdhinë dhe shtrembërimet seksuale shpesh i mësojnë shoqërisë edhe edukatën seksuale. Si mund të

mos shqetësohet një prind mysliman kur sheh se shkolla dhe masmedia e portretizon lapërdhinë si liri seksuale, dhe homoseksualitetin si një "prirje seksuale"? Por a ka kuptim që prindërit dhe mësuesit myslimanë të pranojnë që fëmijët e tyre të mos marrin asnjë edukatë seksuale? Përgjigja është Jo! Fëmijët gjithsesi do ta marrin një edukatë seksuale edhe nëse izoloohen, pasi mund ta përthithin nga fëmijët e tjerë. Qëndrimi i drejtë është t'u japim fëmijëve tanë një edukim seksual të saktë, i cili buron nga Kur'ani dhe Suneti. Gjithsesi është detyrim i çdo prindi që të jetë i përgatitur ta përmbushë këtë detyrë, madje ta bëjë këtë në mënyrën më të mirë.

Fazat e ndryshme të edukimit seksual. Ndërsa një fëmijë kalon nëpër faza të ndryshme zhvillimi, edukimi i tij seksual duhet gjithashtu të planifikohet në faza dhe çdo mësim duhet të jetë në përputhje me moshën e fëmijës. Megjithëse pjekuria e fëmijëve ndryshon thellë me çdo moshë, ka katër periudha kryesore në të cilat kalojnë fëmijët:

7-10 vjeç- Moshë e Gjikimit
Në këtë moshë, fëmija duhet të dijë rregullat e hyrjes në dhomën e prindërve dhe rregullat sesi duhen shikuar të tjerët.

10-14 vjeç- Adoleshenca
Në këtë moshë, fëmija duhet të mësojë si të shmangë nxitjen seksuale dhe duhet mbrojtur prej saj.

14-16 vjeç- Pjekuria kur fëmija duhet të dijë çfarë është marrëdhënia seksuale, nëse ai apo ajo janë gati të martohen në një të ardhme të afërt.

16 vjeç e lart- Rinia, djali apo vajza e pamartuar duhet të mësojnë si të përballojnë mungesën seksuale si dhe rreziqet e tradhtisë seksuale dhe imoralitetit.³

Edukimi i virtyeve një udhëtim që nis në fëmijëri. Kjo temë është trajtuar në aspektin edukativ sesi një prind duhet ta edukojë fëmijën e tij brenda normave të moralit rreth edukatës seksuale, autori thekson se fëmijët, dashur pa dashur, do mësojnë rreth këtij fenomeni, por më e drejta është që t'u japim fëmijëve një edukim seksual të saktë, i cili buron nga Kurani dhe Suneti. Autori në këtë trajtim çështjeje prek edhe katër periudhat kryesore në të cilat kalojnë fëmijët dhe përcakton se çfarë duhet t'u prindërit mësojnë atyre pikërisht në këto periudha kaq delikate.

Duke lexuar librin “Nga fara te lisi”

Për edukatën e fëmijëve dhe për një familje sa më të konsoliduar një kontribut mjaft të madh ka dhënë edhe libri “Nga fara te lisi” i autorit turk Fethullah Gylen. Në këtë libër shpjegohet shumë bukur kronologjia e vërtetë e Islamit, lidhur kjo ngushtësisht e pazgjidhshmërisht me

fëmijën. Zanafilla e humbjes e më pas përhumbjes së shumë popujve qëndron te një fëmijë i rritur keq, pa edukatë, pa moral dhe pa arsimim të dobishëm. Shumë bukur autori na bën me dije se prindërit duke toleruar (e thënë shqip, duke lëshuar pe) nga feja e tyre, kanë lënë pas dore këshillat hyjnore të kapjes fort pas litarit të Krijuesit, e më pas, duke imituar kombet e tjerë, kanë arritur të injektojnë te fëmijët e tyre pavarësinë, largimin dhe injorimin e familjes, duke formuar individë që nuk bashkëjetojnë familjarisht, por që ndjekin vetëm epsheet, pasionet dhe dëshirat e kësaj bote. E megjithatë, as fëmija vetë nuk është realisht prona jonë ekskluzive, me të cilën mund të bëjmë si të duam e çfarë të duam, por na është dhënë “me qira”, dhe për të kemi përgjegjësi të lartë dhe llogaridhënie deri më një tek Allahu, Krijuesi i të gjitha krijesave.

Autori i kushton një vend të rëndësishëm familjes në tërësi dhe ambientit familjar në veçanti, ngaqë, kur në bahçen familjare ka paqe, mirëkuptim e harmoni mes brezave, atëherë edhe fëmija ndihet i fuqishëm e krenar, i gatshëm për t'u bërë lis që nuk pritet me një të rënë sëpate. Profeti Muhamed (a.s.) na këshillon: “*Martobuni dhe shtobuni, se unë do të krenohem Ditën e Kiametit me shtimin tuaj*”.

Autori vlerëson se prindërit duhet të falin namazin edhe në shtëpi. Në prani të fëmijëve tanë të bëjmë

3. B. Resuli, *Edukimi i virtyeve një udhëtim që nis në fëmijëri*, gazeta “Drita Islame”, shkurt 2001, nr. 1, f. 5-6.

biseda me vlerë. Një tjetër aspekt i trajtesës së këtij libri është edhe edukimi shkollor. Ndarja gjinore në shkolla është një hap tjetër ku autori vë theksin dhe çmon se sa vlera ka kjo mënyrë shkollimi për moralin e brezave, ku si bazë për edukimin e fëmijës nuk janë fjalët pa karar apo leksione të zgjatura për lejimin e së mirës dhe ndalimin nga e keqja. “Në vend të mbushjes së kokës së fëmijës me gjëra sasiore, duhen edukuar ndjenjat e tij me anë të kuptimeve të larta. Ata duhet ta duan aq shumë Kur’anin, sa që mësimin e tij ta bëjnë ideal!”, - sqaron Gylen. Sakaq, autori nuk lë pa trajtuar edhe përballjen që do të kenë edukuesit jashtë-kur’anorë me edukuesit kur’anorë. E për të shkuar nga fara te lisi, nga fëmija te shoqëria e më pas te kombi i shpëtuar, shkrimtari turk vlerëson se familja është një komb i vogël, kurse kombi është një familje e madhe. Prandaj, për ne mbetet parësore që familjarisht të kujdesemi për farën e lisit e shoqërisht të kujdesemi për lisanjën.

Autori temën “*Nga fara tek lisi?*” e ka trajtuar në aspektin edukativ, por duke përfshirë edhe aspektin fetar dhe atë sociologjik. Duke u bazuar dhe duke treguar rëndësinë e librit, autori thekson se familja luan rolin kryesor në edukimin e fëmijëve. Është pikërisht familja vendi i parë ku fëmija mëson edukatën dhe moralin dhe duhet të jetë pikërisht familja ajo që nuk duhet të lejojë dhe

tolerojë amoralitetin dhe edukatën e keqe të fëmijët e saj. Për të pasur një familje të lumtur dhe me një edukatë sa më të lartë autori thekson se është e rëndësishme që të ndjekim Kur’anin Famëllartë dhe traditën profetike, pasi është pikërisht Islami ai që na mëson mënyrën më të mirë të edukimit familjar. Autori në këtë temë prek edhe aspektin sociologjik pasi vlerëson shumë familjen ku thotë se kombi nis nga familja; një familje me mirëqenie dhe edukatë është pikërisht ajo që na ofron një komb të tillë, sepse familja është bërthama e shoqërisë. Një familje e shëndoshë dhe e edukuar sjell një shoqëri të shëndoshë dhe të edukuar.⁴

Ndjenja e përgjegjësisë në edukim

“O Zot! im, më ndihmo në edukimin e fëmijëve dhe për t’i mësuar ata që të bëjnë mirë!” Kjo çështje është më e rëndësishme dhe serioze, sepse duke i lartësuar pjesëtarët e familjes në vlerat e përsosmërisë njerëzore, u mundëson atyre që të ndiejnë ëndjet e të qenët i përjetshëm! Ndonjëherë, u marrim dhurata fëmijëve dhe përpiqemi t’i gëzojmë. Madje, shkojmë në haxh dhe, edhe në kohët kur ndodhemi para Qabes ose të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ndiejmë vazhdimisht

4. Enkelejda Avxhiu, *Duke lexuar librin nga fara tek lisi*, gazeta “Drita Islame”, qershor 2005, nr. 6, f. 8.

në zemër. Edhe shërbimet më të shenjta e të rëndësishme nuk na bëjnë dot t'i harrojmë ata. Në të vërtetë, mënyra më e mirë e kujtimit të fëmijëve është t'u japim atyre edukatën islame. Unë them se nuk duhet të ketë dhuratë që të mund të matet me këtë. Përsëri në një hadith Profeti (a.s.) porositi: "*Bëjuni dhurata fëmijëve dhe edukojini në një mënyrë të mirë?*" Po, një edukatë me orientim për ta ringjallur rrugën e Profetit (a.s.) është dhurata më e madhe që mund t'i jepet fëmijës!

Shembulli i mirë. Çdo nënë e baba mysliman, në mënyrë mjaft të natyrshme, mendojnë t'i edukojnë fëmijët në formën e një pjese të shëndoshë e të përkryer të asaj shoqërie ideale të cilën përpiqen ta përfytyrojnë dhe përvijojnë sipas Kur'anit. Prindërit që dëshirojnë që fjalët e tyre t'u shkojnë te fëmijët, më së pari duhet t'i jetojnë vetë thellësisht.

Krahas fjalës së drejtë, ka shumë rëndësi veprimi i drejtë. Në sy të fëmijës, kundërshtia mes fjalëve dhe veprimeve tuaja e trondit besimin e tij tek ju. Në jetë, sikur edhe një herë të vetme t'ju kapë fëmija në gënjeshtër ose në kundërshti mes fjalëve e veprimeve apo sjelljeve tuaja, për sa kohë do ta bartë këtë në mendje, në sytë e tij ju do të vazhdoni të mbeteni një njeri që s'i besohet. Po qe se pastaj, më vonë, nga sjelljet tuaja rrjedh ndonjë pakënaqësi e vogël, ajo del në mbi vetëdijen dhe,

në vështrimin e fëmijës, ju shiheni si dikush për të cilin ndjehet "neveri". Për pasojë, fjalët tuaja s'gjejnë aspak pasqyrim tek ai. Atëherë, sjelljet duhet t'i rregullojmë të tilla që, brenda shtëpisë, ata të na konsiderojnë neve jo nënë e baba, por "engjëj". Ata duhet të shohin tek ne seriozitet, rëndësi, ndjeshmëri dhe duhet të na besojnë gjer në fund. Ja, pra, prindërit që arrijnë me sukses t'i përcjellin mendimet dhe ndjenjat me një rrugë të tillë, quhen mësuesit më të suksesshëm.⁵

Ndjenja e përgjegjësisë në edukim. Këtë temë autori e ka trajtuar në aspektin edukativ-fetar, autori thekson rëndësinë që ka edukimi për fëmijët. Fëmijët janë pasuria më e rëndësishme për prindërit, janë dashuria më e madhe për ta, dhurata më e mirë që një prind mund t'i bëjë fëmijës është edukata dhe morali islam që mund t'i japë. Ashtu siç e thekson dhe autori, në shumë thënie Profeti Muhamed (a.s.) i jep shumë rëndësi edukimit ku thotë mënyra më e mirë e kujtimit të fëmijëve është t'u japim atyre edukatën islame. Por që prindërit të jenë sa më ndikues te fëmijët e tyre duhet që gjërat që ua këshillojnë fëmijëve me fjalë duhet që në fillim t'i veprojnë vetë në praktikë, sepse kështu ato arrijnë të jenë mësuesit më të suksesshëm në edukimin e fëmijëve të tyre.

5. Mercedes Gega, *Ndjenja e përgjegjësisë në edukim*, gazeta "Drita Islame", janar 2006, nr. 1, f. 14.

Familja dhe Arsimi

Edukimi i fëmijës fillon qysh me lindjen e tij. Ai nuk edukohet duke dëgjuar, por duke parë. Me një fjalë, fëmija bën atë që sheh e jo atë që dëgjon. Prandaj, jeta sociale pozitive është më e dobishme për fëmijën, sepse, nëse shkatërrohet jeta shoqërore, do të shkatërrohet edhe ajo individuale. Sot, rreziku më i madh për njeriun është amoraliteti. Dukuritë negative si alkooli, bixhozi, etj., e demoralizojnë shoqërinë. Vendet (ish)komuniste ishin të detyruara ta braktisnin atë, sepse ai zhveshi shoqëri të tëra nga jeta shpirtërore. Ashtu siç ka nevojë njeriu për ushqim trupor, apo mendja për dituri, ashtu edhe shpirti ka nevojë për ushqimin e tij, e ky është besimi dhe adhurimi. Nuk mund të ketë dobi njeriu i cili shpirtin e ka lënë të varfër, ndërsa tërë vëmendjen e ka përqendruar te nevojat trupore. Me këtë rast, fëmijët bëhen të vrazhdë dhe mendjemëdhenj, gjë që rezulton në mosdëgjim të këshillave. Myslimanët e vrazhdë, të cilët duke harruar krenarinë e fesë dhe duke u dhënë pas krenarisë së vetvetes, janë të vrazhdë në biseda. Kështu ata nuk kanë arritur t'u japin edukatën e duhur fëmijëve të tyre. Ka edhe prindër të atillë, të cilët kanë kërkuar që vetë ata të edukohen nga fëmijët e tyre. Me këtë rast, fëmijët, duke edukuar prindërit e tyre, ishin edukuar edhe vetë.

Nuk ka dyshim se thesari më i madh për njeriun janë fëmijët. Nëse familjes këtë thesar ia grabit amorali, atëherë ajo shkatërrohet. Nëse prindërit janë treguar të mëshirshëm dhe të ndershëm me fëmijët e tyre, edhe ata tregohen të kujdesshëm me ta. Parimet hyjnore, si mëshira dhe respekti, e bëjnë jetën të qëndrueshme. Allahu ka dërguar Islamin që këtë botë nga ferri ta shndërrojë në parajsë. Meqë është ashtu, atëherë Islami është zgjidhje e çdo problemi në këtë botë. Sot, në sistemin arsimor ekziston vetëm mësim e jo edhe arsimim. Njeriun nuk e shpëton dot vetëm dituria. Nëpër shkollat tona është mësuar formula “mjafton mendja, për fenë nuk kemi nevojë”. Njeriu i çmendur nuk luan bixhoz. Vetëm njerëzit e mençur bëjnë mashtrime e falsifikime. Mendja është si uji, cilën ngjyrë t'i japësh, atë merr. Te njerëzit e këqij, mendja bëhet shkak për shkatërrim, ndërsa te njerëzit e mirë, ajo përhap paqen në çdo vend. Njerëzit të cilët i dhanë rëndësi mendjes, por lanë prapa arsimin, vuajtën për vite të tëra. Jetojmë në një botë, ku fëmijët, të cilët janë të ngjashëm me engjëj, i kthejmë në djaj. Nga ky shembull dhe shumë të tjerë, kuptojmë se individi dhe shoqëria kanë mbetur larg ndikimit të shkencës dhe fesë. Nëse këto plagë nuk shërohen, atëherë fundi i popullit tonë do të jetë shumë i tmerrshëm.⁶

6. Feim Gashi, *Familja dhe arsimi*, gazeta “Drita Islame”, janar 2006, nr. 1, f. 14.

Familja dhe arsimi. Këtë temë autori e ka trajtuar në aspekti edukativ-fetar ku thekson se është shumë i rëndësishëm edukimi i fëmijëve me moral dhe virtyte. Autori thekson se ushqimi fizik duhet të ecë në mënyrë paralele me ushqimin shpirtëror, që është besimi. Është pikërisht besimi ai që i jep kuptim dhe vlerën e duhur, për konsolidimin dhe mirëqenien e familjes, pasi tek ato fëmijë dhe familje që nuk mbizotëron ndjenja e edukimit fetar apo ndjenja e besimit shohim që imoraliteti dhe shkatërrimi janë më prezent. Edukata islame ka një rëndësi shumë të madhe, pasi njeriun nuk e shpëton vetëm dituria, sepse te njerëzit e mençur mendja mund të bëhet shkak për shumë shkatërrime por vetëm te njerëzit që ndërthuret dituria, besimi dhe morali gjasa që të ndodhin gjëra të padëshirueshme dhe të këqija pothuajse nuk ekziston fare. Autori prek edhe aspektin sociologjik ku përmend se shoqëria sot ka ngelur larg ndikimit të fesë, por kjo largësi nuk ndikon vetëm në përkeqësimin e individit por edhe në përkeqësimin e gjithë shoqërisë.

Roli i familjes në edukimin e fëmijëve

Familja është një bashkësi njerëzore sociale, anëtarët e së cilës janë të lidhur me anë të lidhjeve të gjakut, apo me anë të marrëdhënieve martesore. Lidhja familjare kërkon edhe pranimin e ndërsjellë të të

drejtave e detyrave, që t'i respektojnë të gjithë anëtarët. Islami porosit që familja të ndërtohet mbi baza të shëndosha, anëtarët e së cilës të ushqejnë sinqeritet reciprok dhe një intimitet të vërtetë, në këtë mënyrë familja merr kuptimin e një institucioni hyjnor, origjina e së cilës të çon deri në krijimin e njeriut. Feja vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në të gjithë sistemin e raporteve familjare. Një nga të drejtat më të pacenueshme të fëmijëve, në Fenë Islame, është e drejta për të jetuar dhe për të pasur mundësi të barabarta në jetë. Në Kur'an thuhet se është detyrë e familjes që të tregojë kujdes për mirëqenien e saj shpirtërore, për nevojat e edukimit dhe për mirëqenien e përgjithshme. Problemet e edukimit në familje janë mjaft të gjera dhe të komplikuar, që duhen kuptuar mirë nga familja, e cila mban peshën kryesore në edukimin e fëmijëve. Sot në kushtet e demokracisë, kanë lindur përfytyrime të reja mbi familjen e rolin e saj në edukimin e fëmijëve, por në këtë drejtim Islami krijon premisa për formimin gjithnjë e më të shëndoshë për edukimin e mirërritjen e tyre. Familja është një institucionin që lidhet ngushtë me jetën shoqërore dhe që pëson ndryshime me zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Marrëdhëniet në gjirin e familjes e raportet e drejtpërdrejta të brezit të vjetër me brezin e ri, eksperiencia e gjatë historike e brezit të vjetër luan

rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve. Ajo, duke qenë e varur nga jeta shoqërore dhe ligjet objektive të saj, sot është më e shëndetshme, sepse qëndrojnë në plan të parë liritë dhe të drejtat e njeriut, për të cilat Islami i ka theksuar mbi 14 shekuj më parë. Liritë ideore, ekonomike, psikologjike e shpirtërore e pasurojnë më shumë bazën e familjes, i lejojnë asaj t'i transmetojë fëmijëve normat e shëndosha të edukatës, që konkretizohen në jetën e përditshme të fëmijëve, larg veseve negative si mashtrimi, vjedhja, gënjeshtria, alkooli, droga, prostitucioni, krimi i rënduar e deri brenda familjes.

Edukata është proces që nuk mbaron në familje, por vazhdon në shkollë e jashtë saj. Roli i familjes është parësor, sepse fëmija këtu e bën kontaktin e parë dhe këtu njihet me mjedisin përreth tij, si dhe njohjen me të kaluarën. Në edukimin e fëmijëve duhet të kemi parasysh: **Besimin te Zoti**. Familja, në punën edukative, duhet të nisët nga qëllimi kryesor që ta drejtojë atë në besimin te Zoti, që do ta udhëheqë në realizimin e të gjitha detyrave, që i dalin përpara nga mosha më e vogël, në rini e deri në pleqëri. **Edukimi i ndjenjave morale**. Edukimi i drejtë i familjes duhet të fillojë menjëherë pas lindjes së tij, e jo kur ai fillon të kuptojë. Në moshën e njomë të fëmijës në familje, fillon dhe hedh bazë sjellja e tij, që për të përbën thelbin e edukatës. Fëmijët në familje duhet

të edukohen që të ndihmojnë njëri-tjetrin ose prindërit të ndajnë me njëri-tjetrin atë që kanë të përbashkët, të mësohen të sakrifikojnë për njëri-tjetrin, etj. Në këto momente ndikimi edukativ ndikon në zhvillimin mendor e emocional të fëmijëve si dhe në formimin e shprehive dhe të zakoneve të caktuara morale që më vonë ato të kthehen në veti të karakterit.

Gabimet e edukimit të fëmijëve në familje i pasojnë fëmijët në jetë dhe në ambientin shoqëror. Nga mungesa e kulturës apo e pakujdesisë së prindërve në edukim, ata sjellin ndryshime në normat morale e zakonet e krijuara, gjë që shkakton një gjendje të vështirë për fëmijën dhe paraqet gjithmonë vështirësi në edukim, sepse tek ai janë krijuar zakone të këqija. Roli i familjes duhet të konsiderohet një veprimtari e organizuar, e paramenduar, që i drejton shijet e fëmijëve të tyre në një drejtim të caktuar. Prindërit nuk mund të arrijnë qëllimin e tyre në qoftë se shijet ua imponojnë fëmijëve me forcë. Prind i mirë është ai që me përfytyrimet e tij për të bukurën apo të shëmtuarën, t'ua rekomandojë fëmijëve në mënyrë të tillë, që ata të kthehen në motive të brendshme për vetë fëmijën. Kuptohet që përmbajtja dhe qëllimi i edukatës përcaktohet edhe nga marrëdhëniet ekonomike, mbi të cilat mbështetet familja. Këtu qëllimet e edukatës së punës përcaktohen nga rritja dhe

ruajtja e pronës familjare, shtimi i pasurisë në favor të familjes. Kontrolli i familjes duhet të jetë i vazhdueshëm. Prindërit nuk duhet të edukojnë vetëm me fjalë, por edhe me shembullin e tyre, në organizimin e kohës së lirë bashkë me fëmijët në mjedise argëtuese e edukuese.⁷

Roli i familjes në edukimin e fëmijëve. Këtë temë autori e ka trajtuar më shumë në aspektin edukativ por ka bërë edhe një gërshetim me aspektin social. Në fillim autori bën një përshkrim dhe përkufizim ku tregon se çfarë është familja, duke i dhënë asaj rëndësinë dhe vlerën që meriton ku thekson se familja është institucioni kryesor dhe më hyjnor i shoqërisë. Që një familje të jetë e shëndetshme duhet të ndërtohet në bazë të disa elementeve dhe cilësive siç është sinqeriteti, dashuria, drejtësia dhe respekti reciprok ndërmjet anëtarëve të familjes. Autori thekson shumë edhe rëndësinë e madhe që ka familja në edukimin e fëmijëve me edukatën islame, sepse feja luan rolin kryesor në raportet familjare. Rolin kryesor në edukimin dhe rritjen e fëmijëve e ka pikërisht familja, sepse familja është kontakti i parë që fëmijët kanë dhe institucioni në të cilën fëmija merr mësimet e para. Prindërit janë përgjegjës për edukimin e fëmijëve, sepse ato janë shembull për to. Edukimi i mirë i fëmijëve në moshë

sa më të vogël është sinjal që tregon se te fëmijët do mbizotërojnë vlerat dhe virtytet. Ndërsa gabimet e edukimit te fëmijët në familje do të lënë pasoja fatale që do i shoqërojnë ato gjithë jetën. Edukimi i fëmijëve dhe roli kryesor që ka familja në këtë edukim është shumë i rëndësishëm, jo vetëm për fëmijën por për të gjithë shoqërinë, pasi familja është një institucionin që lidhet ngushtë me jetën shoqërore dhe që pëson ndryshime me zhvillimin e shoqërisë njerëzore.

Edukimi i fëmijëve me ndjenjën e familjes

Fëmija i edukuar me një moral të lartë shquhet për qëndrimin, sjelljen e veprimet e vullnetshme pozitive, që rrisin personalitetin e tij.

Roli i familjes është themelor në formimin e njeriut. Raporti mes pjesëtarëve të familjes, dhe në mënyrë të veçantë midis burrit dhe gruas, nuk është thjesht një raport intim, por ka karakter shpirtëror dhe prej tij burojnë dashuria, sinqeriteti, mirëkuptimi, mbështetja, besimi reciprok, shpirti i sakrificës, përkrahja dhe ndihma. Pikërisht brenda familjes ngulitet në personalitetin e fëmijës ndjenja e solidaritetit, dashurisë, mirëkuptimit, tolerancës dhe e mirësjelljes. Duke u mbështetur në parimet bazë të Islamit, çdo familje gjen të gjitha fushat e aktivitetit njerëzor, qofshin ato shpirtërore apo materiale. Feja

7. Xhemal Balla, *Roli i familjes në edukimin e fëmijëve*, gazeta "Drita Islame", qershor 2007, nr. 6, f. 12.

dhe besimi janë bazat morale mbi të cilat duhet të zhvillohet edukimi i fëmijëve dhe i shoqërisë. Fëmija i edukuar me një moral të lartë karakterizohet për qëndrim, sjellje e veprime të vullnetshme pozitive, që rrisin personalitetin e tij. Momenti më i rëndësishëm i veprimit të vullnetshëm për problemet kryesore në jetë është lufta e motiveve dhe pastaj marrja e vendimit. Pavarësisht se mund të ndeshet me vështirësi në jetë, djali/vajza me vullnet do të kapërcejë çdo gjë dhe do të arrijë atë që dëshiron me këmbëngulje e durim. Vetëm në ambiente shoqërore, te djali dhe vajza mund të lindin ndjenja e mendime të përbashkëta, shtohet ndjenja e simpatisë për njëri-tjetrin dhe arrihet në konkluzionin e martesës me pëlqimin e tyre dhe të familjes, për të nderuar një familje të re me baza të shëndosha. Këtu nuk duhet lejuar eksperimenti, bashkëjetesa e të tjera të këtij lloji, sepse në këto kushte si djali dhe vajza nuk mendojnë për një familje të shëndoshë, por vetëm për të kaluar çaste emocionale të përkohshme, që nuk janë të qëndrueshme. Familja ka për detyrë të edukojë fëmijët, si djalin ashtu edhe vajzën, se nuk është vetëm dashuria ajo që i lidh, por është tërë jeta. Familja duhet të parandalojë te fëmijët e saj marrëdhëniet seksuale paramartesore, ose mendimin që djali dhe vajza të kenë të dashur. Kjo çon në shturje morale dhe humb

ndjenjën e sinqertë e reciproke, siç kultivohet kur janë fëmijë të vegjël. Islami mbështet lidhjen martesore si celula bazë e shoqërisë. Me krijimin e një ambienti të shëndoshë, e një fronti unik edukativ të përbashkët me shkollën, organizata joqeveritare, etj., familja do të arrijë të formojë bindje të shëndosha aktive morale dhe estetike të fëmijët e saj.

Por, ditët e sotme, vërejmë se po bëhet e kundërta pasi kemi një shturje të moralit dhe mungesë vlerash dhe virtytesh. Këto veprime kryhen ngase mungon besimin në Zotin Një, në kërkesën e llogarisë në emër të drejtësisë së ligjeve të Tij. Në këtë botë drejtësia është relative, ndërsa nesër, në ditën e fundme, njeriu do të përballët me drejtësinë absolute. Kjo botë është kalimtare. Secili do të provojë vdekjen dhe do të llogaritet për atë që ka punuar. Kush i mendon këto, nuk bie në llumin e degjenerimit moral, e për rrjedhojë do të kemi familje, fëmijë dhe shoqëri të shëndoshë moralisht.⁸

Edukimi i fëmijëve me ndjenjën e familjes. Këtë temë autori e ka trajtuar në aspektin sociologjik ku fokusohet më shumë te rëndësia që familja ka si një institucion bazë dhe si celula e shoqërisë, si dhe bazohet shumë edhe te marrëdhëniet që krijojnë anëtarët e familjes me njëri-tjetrin. Autori gjithashtu e ndërthur edhe

8. Xhemal Balla, *Edukimi i fëmijëve me ndjenjën e familjes*, gazeta "Drita Islame", gusht 2007, nr. 8, f. 13.

me aspektin edukativ ku thekson rolin kryesor që familja ka në edukimin e fëmijëve në të gjitha aspektet e jetës, duke vazhduar nga shpjegimi i rëndësisë së familjes. Një rëndësi të madhe autori i jep edhe aspektit fetar, sepse feja dhe besimi janë bazat morale mbi të cilat duhet të zhvillohet edukimi i fëmijëve dhe i shoqërisë, pasi mungesa e besimit në Zot është një ndër faktorët kryesorë që ndikon në shthurjen e familjes dhe të shoqërisë.

Adoleshenti, familja, shkolla, komuniteti

Adoleshenti është brumi që gatitet njëherësh nga tri duar. Dora e parë është familja që prin, udhëheq, dora e dytë është shkolla dhe dora e tretë komuniteti. Të tria këto duar duhet të jenë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën për ta gatitur adoleshentin të futet e të integrohet mirë në jetë. Kur njëra nga këto duar shfaq mangësi, brumi del i pa gatuar mirë e për rrjedhojë i serviret shoqërisë një bukë e padëshiruar. Adoleshenca është kalimi i vështirë nga bota e fëmijës në botën e të rriturve. Adoleshenti është në kërkim të krijimit të personalitetit të tij. Ai kërkon të sillt si i rritur, ndërsa prindërit e shikojnë ende si fëmijë. Adoleshenti përjeton ndryshime të dukshme fizike. Këto ndryshime të jashtme reflektojnë ndjeshëm në botën e tij të brendshme që sjellin reagime të shumta, të

paraparashikueshme. Në njërin kah është adoleshenti me ndryshimet e veta dhe në kahun tjetër është rreptësia e familjes dhe shkollës.

Shtrohet pyetja: Ku dhe pse ekziston ky lloj rreptësie? Së pari duhet të jemi të ndërgjegjshëm që familja merret e duhet të merret me edukimin e fëmijës në të tëra fazat e zhvillimit të tij, siç thuhet, që në barkun e nënës. Është e vështirë dhe e lehtë të merresh me edukimin e fëmijës në moshat e vogla. Madje prindi nuk ndien lodhje në përkujdesjen ndaj rritjes së fëmijës edhe në netët pa gjumë.. Problemi qëndron në mirërritjen dhe mirë-edukimin e fëmijës në moshën e adoleshencës. Familja mbetet e befasuar. Deri tani e ka pasur shumë të qartë rolin e vet, ndërsa tani pozicionet ndryshojnë çuditërisht. Jo çdo prind është i përgatitur teorikisht e praktikisht nga ana psikologjike për të punuar në mënyrë të kualifikuar me adoleshentin. Duke lehtësuar disi prindin, familjen, autori do të ngarkojë më me përgjegjësi mësuesin, shkollën. Ai thotë se vetë natyra e punës së mësuesit është e tillë që tërë jetën punon me moshë të caktuar e pikërisht me moshën e adoleshencës. Do të thotë që mësuesi merr përvojë, kualifikohet çdo vit, pra bëhet më kompetent në mirë-edukimin e kësaj moshe. Kësisoj ai duhet të jetë konsulenti i parë, i patjetërsueshëm për familjen në gjetjen e rrugëve e të metodave

për mirë-edukimin e adoleshentit. Adoleshenti nuk është më fëmija i vogël që e përkëdhelin të gjithë, por nuk është as i rritur që ta trajtojnë si të tillë. Përballë kësaj nevojë për ndryshim, familja shpesh mbetet shumë e ngurtë dhe përpigjet t'i imponohet adoleshentit. Kjo sjell kriza të brendshme për adoleshtin, madje edhe pasoja në marrëdhëniet e tij me prindërit dhe me pjesëtarët e tjerë të familjes. Në këtë aspekt do të duhej që familja të krijonte një mjedis të kuptueshëm ndaj nevojave të adoleshentit, duke e konsideruar atë si person me mendimet dhe me dëshirat e tij, duke i transmetuar njëkohësisht edhe vlera morale.

Familja është pasqyra në të cilën i riu sheh veten dhe të ardhmen e tij. Fillimi i rrënimt të familjes ka kohë që është ndjerë tek ne. Këtë rrënim, në një farë mënyre, familja kërkon t'ia adresojë rinisë. Të rinjtë, në fakt, thithin atë që vjen nga familja. Në emër të të ashtuquajturit “modernizim i familjes” janë ndier të çara të pariparueshme në familjet tona. Ndarja, divorci, dhuna prindërore, etj., e bëjnë adoleshtin të ketë probleme madhore me jetën. Ai shkon deri aty sa të përdorë narkotikë apo të ketë çrregullime të delirimit në sjellje. Ajo që e orienton një adoleshent me këto ndryshime është familja. Rruga që ajo zgjedh për ta mbështetur atë është udhërrëfyese. Ajo që zhbëhet në familje nuk mund të riparohet e të ribëhet në shkollë

apo diku tjetër, pavarësisht se një rol mjaft të madh luajnë edhe mediat sociale, shoqëria dhe komuniteti.⁹

Adoleshenti, familja, shkolla, komuniteti. Këtë temë autori e ka trajtuar në aspektin edukativ-psikologjik dhe sociologjik. Në fillim autori flet për rëndësinë e edukimit të adoleshentit, për të pasur një mirë-edukim dhe një adoleshent me moral, edukatë dhe virtyte duhet që të tre institucionet kryesore siç janë: familja, shkolla dhe komuniteti të kontribuojnë në edukimin dhe përkujdesjen e adoleshentit, por nuk mjafton vetëm kontributi i tyre, por edhe bashkëpunimi që ato do kenë me njëri-tjetrin. Të tre këto institucione duhet të japin maksimumin e tyre pasi çdo gabim i tyre mund të ndikojë në mënyrë negative në jetën e adoleshentit. Kur fëmija kalon në periudhën e adoleshencës përballet me shumë ndryshime, si fizike ashtu edhe psikologjike, prandaj është shumë e rëndësishme roli i familjes që t'i kuptojë ato, sepse familja është pasqyra në të cilën i riu sheh veten dhe të ardhmen e tij. Shpeshherë ndodh që të ketë konflikt ndërmjet prindërve dhe adoleshentit, ngaqë ata s'arrijnë ta kuptojnë. Në këtë moment, pas familjes, roli parësor tani i takon shkollës, pra mësuesve, dhe më pas komunitetit, por sido që të jetë rolin që ka familja në edukim

9. Rifat Xhina, Drita Islame, *Adoleshenti, familja, shkolla, komuniteti*, gazeta “Drita Islame”, shtator 2008, nr. 9, f. 14.

nuk mund ta zëvendësojë askush tjetër, sepse ajo që bëhet në familje nuk mund të riparohet e të ribëhet as nga shkolla as nga komuniteti.

Familja shkolla më e mirë për edukimin e njeriut

Mënyra me të cilën familja kryen funksionin e saj si celulë kryesore e jetës, përcakton një pjesë të madhe të shanseve të të rinjve për t'ia dalë mbanë në rrugën e tyre drejt autonomisë sociale. Si pasojë, para se të kenë një problem personal, të rinjtë në vështirësi kanë shpesh një problem familjar; para se të ndihen keq vetë, të rinjtë në vështirësi ndihen keq në familje. Për mirë apo për keq secili prej nesh është produkt i familjes së tij të origjinës, si në formimin fizik, ashtu edhe në atë psikologjik, social dhe moral. Prindërit tanë kanë ushtruar te ne një ndikim fizik, psikologjik dhe social. Gjërat që ne i konsiderojmë të rëndësishme në jetë (vlerat), qëllimet që ne ndjekim, arsyet që ne mbrojmë, miqtë që ne kemi, mënyra jonë për të zënë një vend në shoqëri, janë në funksion të vlerave të mësuara në mjedisin familjar. Fëmija varet nga prindërit në trupin e tij, në kokën e tij, në grupin e tij shoqëror. Ja pse marrëdhënia prind-fëmijë është një përbërës kryesor në zhvillimin e të rinjve. Megjithatë familjet s'janë të gjitha të njëjta. Portretet e familjeve janë të shumëëllojshme këto vitet e fundit.

Familja është një institucion social që ka jo vetëm funksione biologjike, por së pari sociale dhe edukative. Ajo është organizata e shoqërisë që ka më shumë mundësi që të funksionojë si strukturë sociale me unitet të fortë edukativ midis pjesëtarëve të saj, në radhë të parë midis prindërve dhe fëmijëve të tyre. Mungesa e “unitetit edukativ” në familje ka pasoja fatale në deformimin e personalitetit dhe “prishjen edukative” të fëmijëve të saj. Ky është kushti që siguron atmosferën e një respekti të ndërsjellë në familje, si parakusht për edukimin e fëmijëve tanë. Nuk edukohet fëmija nëse familja nuk bëhet vërtet një “skuadër” që funksionon dhe ndërtohet e bazuar në parime edukative unike, njerëzore, të përbashkëta dhe të miratuara e të pranuar nga të gjithë, nga prindërit dhe fëmijët e tyre. Vetëm kjo atmosferë krijon kushte që prindi të ketë një ndikim edukativ personal të frytshëm dhe të qëndrueshëm mbi fëmijët e vet. Thelbi i suksesit apo i dështimit në punën edukative në familje, është i lidhur ngushtë me mënyrën se si ne prindërit i shikojmë problemet që kanë fëmijët me veten dhe moshën e tyre, por që në të njëjtën kohë, i kemi edhe ne në marrëdhëniet që ndërtojmë me ta. Edukimi i fëmijëve dhe adoleshentëve në kohën tonë nuk bëhet me acarime prindërore anti-edukative, por duke ndryshuar dhe

përmirësuar raportet, ndërveprimet, marrëdhëniet prind-fëmijë. Sa herë që fëmijët tanë kanë probleme edukative, aq më shumë kjo kërkon që ne të merremi me kujdes, të komunikojmë dhe të ndërveprojmë me ta. Të rinjtë mund të edukohen në familje, por vetëm kur ajo bëhen mjedis ku fëmijët dhe prindërit e duan dhe e respektojnë njëri-tjetrin. Në familjen që bëhet sundues detyrimi me forcë, minimalisht edukimi mungon. Në këtë rast vlera edukative e familjes shqiptare do të vazhdojë të jetë në “rënie të lirë”, duke e bërë atë thjesht një mjedis familjar biologjik, por pa funksionin dhe rolin e rëndësishëm edukativ. Përkujdesja aktive për fëmijën apo adoleshentin është një tjetër aftësi prindërore shumë e rëndësishme. Për të ushtruar këtë ndikim, për të aktualizuar rolet dhe lidhjet afektive, prindi duhet të qëndrojë pranë fëmijës, të përfshihet në mënyrë aktive në botën e tij. Një pjesë e mirë e të rinjve që kanë probleme psiko-sociale, kanë një mungesë përkujdesjeje apo pranie të prindërve pranë tyre. Për të luajtur mirë rolin e prindit duhet t'i qëndrosh pranë fëmijës, të përjetosh gjërat me të; ndryshimet bëhen aq shpejt në jetën e fëmijës sa është shumë e vështirë për prindin të ruhet realiteti i fëmijës pa qëndruar pranë tij. Mbështetje, vazhdimësi dhe respekt, ja tre kategoritë e mëdha të nevojave që shfaqin të rinjtë në lidhje me familjet

e tyre dhe për më tepër në lidhje me shoqërinë e zgjeruar.¹⁰

Familja shkolla më e mirë për edukimin e njeriut. Autori e ka trajtuar këtë temë më shumë në aspektin edukativ ku tregon rëndësinë që luan familja në edukimin e fëmijës, gjithashtu autori thekson se rolin kryesor dhe më primar në edukimin e fëmijëve e luan pikërisht familja. Në qoftë se do donim një brez të edukuar dhe me moral atëherë këtë duhet ta kërkojmë nga familja e cila është shembulli dhe pasqyrimi i fëmijës. Edukata, morali, dashuria, etj., të gjithë këto elementë kryesorë të shoqërisë marrin vlerë në momentin që përfaqësuesit e saj ushqehen me këto cilësi nga edukatorja e parë që është familja. Për një familje sa më të konsoliduar, sa me më shumë vlera dhe moral, rolin parësor dhe kryesor e luan pikërisht edukimi familjar, sepse ashtu siç është bërthama e shoqërisë, po ashtu do jetë dhe shoqëria. Prandaj familja nuk duhet të harrojë rolin e saj kryesor, që është roli edukativ. Në qoftë se ky rol kryhet me sukses nga ana e saj, atëherë edhe brezi i ardhshëm do jetë një brez me vlera dhe prosperitet për kombin dhe shoqërinë.

Konkluzion

Familja është vendi i parë i humanizmit, ajo është institucioni

10. Dila Nikolla, *Familja shkolla më e mirë për edukimin e njeriut*, gazeta “Drita Islame”, shtator 2010, nr. 9, f. 13.

më hyjnor dhe përbën bërthamën më të rëndësishme të shoqërisë. Familja është struktura më themelore e ekologjisë humane, ajo është vendi i edukimit të vërtetë dhe të mirë.

Me të vërtetë që një thesar i çmuar siç është “Drita Islame”, në tematikat e trajtuara meriton të nënvizohet trajtimi i çështjeve të familjes, të cilave u ka dhënë një rëndësi mjaft të madhe. Duke trajtuar çështjet e familjes te periodiku “Drita Islame” arrita në përfundimin se “Drita Islame” (1992-2017) ka dhënë një kontribut mjaft të madh

në konceptin se si duhet të jetë një familje dhe rolet që ajo ka, pasi e ka trajtua familjen në shumë aspekte, si në atë të edukimit të fëmijëve me edukimin dhe moralin islam, po ashtu edhe në aspekte të tjera, si ai ekonomik, psikologjik, patriotik, etj.

Është pikërisht mirë edukimi i fëmijëve me vlera dhe moral ai i cili ndikon drejtpërsëdrejti në një familje të qëndrueshme dhe të lumtur, por s’duhet harruar që një familje e tillë është garancia edhe për një shoqëri po me këto cilësi.

Bibliografia

- Nahi, Hasan, *Kurani i madhbërishëm*, Tiranë, AIITC, 2006.
- Neveviu, Imam, *Rijadus Salihin*, Prishtinë 2004.
- Ahmed Ibn Abdul-Latif Zebidi, Zejnudin, *Mubtesar Sahib El-Buhari*, Shtypshkronja Mileniumi i Ri, Tiranë 2015.
- *Gazeta "Drita Islame"*, Botimi: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë 1992-2011.
- *Revista "Drita Islame"*, Botimi: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë 2012-2017.
- Gylen, M. Fethullah, *Dritë E Pashuar 2*, Shtëpia Botuese Prizmi, Tiranë 2007.
- Gylen, M. Fethullah, *Nga fara te lisi*, Shtëpia Botuese Prizmi, Tiranë 2008.
- Nezir, Reyhan, *Familja në Islam*, Shtëpia Botuese Kreuzlingen, Zvicër 2006.
- Dervishi, Zyhdë, *Sociologjia (tekst për klasën e XI të shkollave të mesme Republikës së Shqipërisë)*, Tiranë: Shtëpia Botuese SHBLSH e Re, 2010.
- Halid, Amër, *Rëndësia e Familjes në Islam*, Shtëpia Botuese Furkan Ism, Shkup 2008.
- Kutub, Sejjid, *Fij dhilalil Kuran*, Shtëpia Botuese Daru esh-Shuruk, Kajro 1993.
- KMSH, *Bibliografia e gazetës Drita Islame, janar 1992 – dhjetor 2011*, Tiranë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2015.

Ndikimi i gjuhës së fesë në ndryshimet shoqërore

Prof. dr. Muhamed Mustafi
Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup

Abstrakt

Ndryshimet shoqërore janë pasojë e faktorëve të ndryshëm, që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në kahet e ndryshme.

Një ndër faktorët e rëndësishëm, që ndryshojnë mendimet dhe botëkuptimet, është feja, nëpërmes gjuhës së saj.

Gjuba e fesë mund të formojë hapësirë të volitshme dhe të përshtatshme për njerëzit, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre, ose ndikon negativisht dhe krijon opinionin e urrejtjes se ndërsjellë mes njerëzve, etnive apo popujve të ndryshëm.

Gjuba e fesë konsiderohet pjesë e rëndësishme e formimit të lidhjeve të ngushta ndërs shoqërore, nëse praktikohet me mençuri dhe kujdes të veçantë, nëse nuk ofendon asnjë dhe nëse nuk mbështetet në parimin e mbivlerësimit.

Pra, gjuba pozitive e fesë hap dyert e një komunikimi më të gjerë shoqëror në nivele të ndryshme lokale dhe botërore. Përdorimi i gjuhës negative do të ngushtojë jetën dhe do të ofrojë një kooperim të vështirë dhe të kufizuar.

Ky lloj gjuhe ndikon në ndryshimet vitale shoqërore, të cilat mund të kenë fund të çlirët shoqëror dhe mirëkuptim të përgjithshëm në të gjitha sferat e jetës, pa marrë parasysh frymën politike që ekziston në shoqëri, ngase këto lidhje do të jenë rezultat i një botëkuptimi më të gjerë dhe universal.

Fjalët kyçe: *Gjuhë, fe, ndikim, shoqëri, ndryshime.*

Hyrje

Në botën e fesë ekziston një koncept

shumëdimensional dhe kozmopolit dhe për këtë arsye është shumë e vështirë të jepet një analizë përfundimtare dhe vendimtare. Në këtë botë komplekse, studiuesit përpiqen të japin një pasqyrë objektive, një analizë të thellë ose një pasqyrim të faktorëve, por, duke qenë se feja nuk është një shkencë ekkzakte, ne përsërisim mendime dhe ide të ndryshueshme.

Të gjitha studimet për fenë japin shtjellime për natyrën e fesë dhe në të gjitha studimet vërejmë se feja konsiderohet një faktor i rëndësishëm dhe vendimtar në shoqëri apo në ndryshimet shoqërore.

Komponentët fetarë janë të ndryshëm, por gjuha fetare konsiderohet si një nga faktorët kryesorë të ndryshimeve shoqërore për shkak të interpretimeve të ndryshme mbi rolin dhe funksionin e fesë në shoqëri.

Ky shqyrtim i kësaj dukurie do të ndihmojë për të kuptuar segmentin e ndikimit të gjuhës fetare në ndryshimet shoqërore bazuar në mendimet e studiuesve perëndimorë, të cilët hulumtojnë çështjet dhe dukuritë që janë nën ndikimin e fesë dhe gjuhës së saj.

Në kërkimin ekkzakt, hulumtimi është më i lehtë sepse rezultatet vijnë

nga dëshmi të verifikuara përmes eksperimenteve dhe rezultateve empirike, ndërsa në këtë fushë është e vështirë të thuhet fjala e fundit, sepse kemi të bëjmë me çështje teorike, të cilat mund të ndryshojnë herë pas here.

Ndikimi i gjuhës fetare nëpërmes përkufizimeve të ndryshme

Përkufizimet e çështjeve të ndryshme japin një pasqyrë më të përgjithshme të esencës dhe thelbit të shqyrtimit dhe kuptimit të proceseve të ndryshme shoqërore.

Edhe çështja e ndikimit të gjuhës fetare është e lidhur ngushtë me kuptimin e përkufizimeve të ndryshme që ekzistojnë mbi fenë dhe natyrën e saj.

Nuk ka asnjë përkufizim absolut të fesë. Përkufizimi i secilit autor do të ndryshojë nga një tjetër. Këtu janë disa përkufizime të fesë:

Besimet, simbolet dhe ritualet janë komponentët kryesorë të feve dhe shumë shkencëtarë socialë kanë sugjeruar se ato janë “blloku i ndërtimit” kryesor të institucioneve fetare. Besimet janë ide të mbajtura fort; simbolet janë ide dhe imazhe; ritualet janë pak a shumë sekuenca fikse sjelljesh që marrin një rëndësi të veçantë kur kryhen brenda një konteksti fetar. Shkencëtarët socialë pretendojnë se besimet, simbolet dhe ritualet janë të nevojshme për krijimin dhe mirëmbajtjen e

institucioneve fetare në mbarë botën.

Feja është një grup kuptimesh dhe sjelljesh, duke u referuar individëve që janë ose ishin ose mund të ishin fetarë. Përsëri, feja është një term i përgjithshëm që i referohet të gjitha feve të imagjinueshme, formale ose joformale.

Feja është një sistem i unifikuar besimesh dhe praktikash në lidhje me gjërat e shenjta, domethënë gjëra të veçuara dhe të ndaluara - besime dhe praktika, që bashkohen në një bashkësi të vetme morale për të gjithë ata që u përmbahen atyre.

Feja është një sistem besimesh dhe praktikash me anë të të cilave një grup njerëzish interpretojnë dhe përgjigjen ndaj asaj që ata mendojnë se është e mbinatyrshme ose e shenjtë.¹

Nga përkufizimet e mësipërme mund të shohim se feja nënkupton besime dhe praktika si dhe drejton një individ, një organ që mban bashkësinë, dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në ndryshimet shoqërore përmes gjuhës dhe interpretimeve të ndryshme.

Ndikimi grupor i gjuhës fetare

Gjuha është një element kyç i kulturës, por të flasësh të njëjtën gjuhë nuk do të thotë domosdoshmërisht që njerëzit ndajnë të njëjtat bindje kulturore. Për shembull, anglishtja

1. Gangte, Tingneichong (2018), *An essay on religion and society*, JETIR, December, Volume 5, Issue 12, f. 67.

flitet në Australi, Kanada, Xhamajkë, Indi, Belize dhe Nigeri, midis vendeve të tjera. Po ashtu, edhe brenda Shteteve të Bashkuara, njerëzit nga rajone të ndryshme mund të kenë identitete të ndryshme kulturore edhe pse flasin të njëjtën gjuhë.

Ata që ndajnë një etni, nuk ndajnë automatikisht një gjuhë. Familjet që kanë emigruar në këtë vend disa breza më parë mund të identifikohen me kulturën e tyre të origjinës, por nuk mund ta flasin më gjuhën e tyre. Anglishtja është gjuha më e zakonshme në Shtetet e Bashkuara, por 18 për qind e popullsisë totale raportojnë se flasin një gjuhë tjetër në shtëpi, përveç anglishtes.²

Të gjitha aktivitetet fetare ndërliken drejtpërdrejt me gjuhën dhe interpretimin e ritualeve dhe koncepteve fetare. Në vijim do të veçojmë shpjegimet e koncepteve të ndryshme, të cilat janë formuluar mbi natyrën dhe mënyrën e veprimtarive fetare dhe që shpjegohen përmes gjuhës.

1. Feja është një fenomen grupor: - Feja edhe pse mund të jetë një çështje individuale, zakonisht është një çështje grupore. Individualiteti në fe mund të marrë format e vetmitarëve ose murgjve.

2. Amoah, H., (2021), *The Impact of Religion Views on Culture and Values, Introduction to Multicultural Studies in the 21st Century*, Creative Commons, Spring, f. 5.

Feja është një fenomen i komunitetit që përfshin një grup të tërë njerëzish. Feja, në masën më të madhe, është shoqëria. Ajo, në përgjithësi, përfshin një grumbullim ose një mbledhje ceremoniale që përfshin një grup të madh njerëzish. Për shembull, një kishë, një tempull ose një xhami.

2. Feja ka të bëjë me të shenjtën dhe të mbinatyrshmen: - Pothuajse të gjitha fetë në botë përfshijnë të shenjtën ose të mbinatyrshmen. Budizmi është e vetmja që nuk përfshin asnjërin. Çdo fe tjetër flet për të shenjtën ose mbinatyrroren si tipar kryesor të saj.

3. Feja përfshin një sërë praktikash: - Besimet rrjedhin nga përvojat në jetë. Një anëtar i thuhet të besojë dhe më pas të komunikojë me Zotin. Kështu, ajo çon në një besim në zot. Trupi i besimit duhet të përjetohej në shumicën e feve. Feja përfshin gjithashtu një sërë faktesh, të cilat gjenden në libra të shenjtë, si Bibla, Kur'ani, Teurati, etj.

4. Feja përfshin praktika të ndryshme: - Fillimisht vjen besimi për ekzistencën e një fuqie të mbinatyrshme, pastaj për ta pasqyruar këtë, ndiqen praktikën. Feja përfshin praktika dashurie, pageje, bamirësie, etj. Por mbi të gjitha, ajo përfshin praktikën e riteve dhe ritualeve. Feja përfshin shumë praktika, të cilat, shpesh, pasqyrojnë besimin që ndiqet. Besimi ndjek praktikën në çdo fe.

Kështu, këto janë disa nga karakteristikat e fesë që pasqyrojnë se feja është sociale dhe përfshin shumë rite dhe rituale që duhen ndjekur nga besimtarët e çdo besimi të caktuar.³

Gjatë interpretimit të përkufizimeve mbi fenë, vërejmë se gjuha luan një rol të rëndësishëm në shpjegimin e natyrës së fesë dhe se në asnjë mënyrë nuk mund të ndahet nga komentet, teoritë dhe praktikën fetare.

Roli i gjuhës në kontaktet shumë-fetare

Stilet e komunikimit dhe metodat jo-verbale të komunikimit janë gjithashtu aspekte të rëndësishme të grupeve kulturore. Çështje të tilla, si përdorimi i komunikimit të drejtpërdrejtë kundrejt atij të tërthortë, hapësira e përshtatshme personale, parametrat shoqërorë dhe shfaqja e kontaktit fizik, përdorimi i heshtjes, mënyrat e preferuara të lëvizjes, kuptimi i gjesteve, shkalla në të cilën argumentet dhe konfrontimet verbale, janë të pranueshme dhe shkalla e formalitetit pritët në komunikim. Kontakti do të pasqyrojë kulturalisht dallimet shumë themelore, etnike dhe kulturore.

Më konkretisht, rëndësia relative e mesazheve jo-verbale ndryshon shumë nga kultura në kulturë.

3. Gangte, Tingneichong (2018), *An essay on religion and society*, JETIR, December, Volume 5, Issue 12, f. 67.

Grupet kulturore me kontekst të lartë i kushtojnë rëndësi më të madhe shenjave jo-verbale dhe kontekstit të mesazheve verbale sesa grupet kulturore me kontekst të ulët. Për shembull, shumica e amerikanëve aziatikë vijnë nga grupe kulturore, në të cilat mesazhet e ndjeshme janë të koduara me kujdes për të shmangur ofendimin.⁴

Kontaktet shumë-fetare do të kontribuojnë në një interpretim më të përshtatshëm të karakteristikave të feve, për të forcuar koherencën e tyre të brendshme dhe për t'u marrë me strukturat specifike në mënyrë më të përshtatshme. Vëmendje më e qartë i kushtohet në media, gjithashtu, imazheve të trashëguara ose të ndërtuara nga fetë. Informacioni më i saktë shpesh ndihmon për të zbërthyer imazhet e rreme dhe për të kapërcyer paragjykimet.

Përveç diskutimit rreth kuptimit pluralist ekskluziv, gjithëpërfshirës, pluralist ose gjithëpërfshirës të dialogut ndërfaqet, çështja e përfshirjes së besimit personal të partnerëve të dialogut dhe e fesë së vetë dialogut ndërfaqet është një aspekt vendimtar. Për të mbrojtur dialogun ndërfaqet, duhet t'u japim përparësi tre kriterëve:

1. Praktikimi i qëndrimit themelor të ndjesisë së shëndoshë të dialogut dhe autokritikës;

2. Të jesh i ndjeshëm ndaj vlerësimit për nënshtrimin e njerëzve ndaj autoritetit të Traditës dhe ndaj qëndrueshmërisë së besimeve të dikujt, duke qenë se feja është në kufijtë e arsyes; dhe

3. Dialogu ndërfaqet ka të bëjë me një “konvertim të ndërsjellë”, me arsyetimin se evolucioni i sistemit simbolik pasurohet dhe sfidohet nga ai i besimeve të tjera.

Kjo nënkupton se statusi i dhënë feve në dialogun ndërfaqet është i një rëndësie vendimtare për besueshmërinë përfundimtare. Praktika e dialogut ndërfaqet, që synon ndryshimin personal të partnerëve të përfshirë, nuk është një çështje thjesht individuale, por ndikon edhe në strukturën e institucioneve fetare.⁵

Gjuha ndërfaqetare është mënyra më e përshtatshme për të hapur dyer të mbyllura dhe për të komunikuar me njëri-tjetrin, sepse vetëm komunikimi i ndërsjellë mund të ndihmojë në anulimin e stereotipeve, të cilat formohen nga mungesa e komunikimit dhe izolimi.

Ndikimi pozitiv i gjuhës së fesë

Religjioziteti (fetaria) funksionalizohet duke e kategorizuar kampionin në tre grupe: anëtarët kryesorë që i përkasin një feje dhe

4. Amoah, H., (2021), *The Impact of Religion Views on Culture and Values, Introduction to Multicultural Studies in the 21st Century*, Creative Commons, Spring, f. 6.

5. Lombaerts, Herman, (2011), *The Impact of the Status of Religion in Contemporary Society upon Interreligious Learning, The Person and the Challenges*, Volume 1 (2011) Number 2, f. 46.

ndjekin shërbesat fetare të paktën një herë në muaj; anëtarët marginalë që i përkasin fesë, por nuk kanë frekuentim të shpeshtë ose e marrin fenë thjesht si identitet; dhe jo anëtarë që janë krejtësisht laikë, pa përkatësi fetare.

Së pari, arsyeja për përdorimin e këtij klasifikimi është funksioni i shumanshëm i fesë.

Ndikimi fetar në qëndrimet dhe sjelljet përfshin institucionet normative, nga mësimdhënia, dhe institucionet organizative, nga angazhimi i komunitetit. Prandaj, pjesëmarrja aktive do të luajë një rol shtesë.

Së dyti, provat empirike mbështesin efektin shumëdimensional të religjiozitetit dhe religjioziteti nominal lidhet më fort me etnocentrizmin, ndoshta për shkak të efektit sinjalizues të identitetit fetar.⁶

Svallfors-i përcaktoi tre koncepte kryesore në kuadrin shpjegues:

Ndarjet politike - Do ta filloj diskutimin me komponentin e parë shpjegues: çarjen politike, duke filluar me procesin e marrëveshjeve dhe riorganizimit në politikën evropiane, siç është parë vitet e fundit me rënien e çarjes së vjetër të krishterë dhe ngritjen e një çarjeje

të re kulturore. Emigracioni ka qenë një pikë qendrore në ndarjen e re kulturore. Megjithatë, grupi i emigrantëve mund të mos jetë ende në gjendje të ndërtojë vetë një ndarje ndikuese, drejt së cilës shqyrtimi aktual synon të kontribuojë dhe të eksplorojë më tej.

Institucionet politike - Institucionet politike janë komponenti i dytë shpjegues në kuadrin teorik. Shqyrtimi aktual hulumton rolin e fesë në institucionet politike nga aspektet normative shoqërore, organizative, normative politike dhe ligjore.

Artikulimet politike - Në kuadrin aktual teorik, artikulimi politik është lidhja ndërmjetëse midis faktorëve shpjegues dhe rezultateve. Aktorët politikë përkatës, duke përfshirë partitë politike, aktivistët dhe mediat, ndërmarrin artikulime politike përmes diskurseve politike, politizimit, fushatave politike, shenjave simbolike dhe prezantimit mediatik, për të ngritur ose ripërcaktuar rëndësinë e çështjes, duke ndërmjetësuar dhe rritur ndikimin e ndarjeve politike dhe institucioneve politike mbi rezultatet e qëndrimeve dhe sjelljeve.⁷

Interpretimi i fesë nëpërmjet gjuhës së saj është “një strategji përballuese aktive për të kapërcyer

6. Weiqian, Xia, (2021) *The Political Sociology of Religion The Impact of Religion on Political Attitudes and Behaviors in Secularizing European Societies*, Universities service US-AB, Stockholm 2021, p. 37.

7. Swallfors, Stefan, (2007) *The Political Sociology of Welfare State, Institutions, social cleavages, and orientations*, Stanford: Stanford University Press, f. 1-29.

më mirë problemet e ekzistencës, pasi personit i lejohej të kërkojë një kuptim ekzistencial për situata të caktuara stresuese të jetës, të ndërtojë ose rindërtojë probleme ose ngjarje të jetës në kuptimin më të thellë, për të siguruar proceset e përballimit me një sistem orientimi ekzistencial, për të përkthyer sistemin e orientimit në metoda specifike të përballimit, për të kërkuar kuptime në procesin e përballimit përmes mekanizmave për ruajtjen dhe transformimin e kuptimit nga ngjarjet jetike, për të provuar zgjidhjen e problemeve në disa mënyra, që janë bindëse për ta dhe për të zgjidhur problemet nëpërmjet mekanizmave të futur në sistemin e tyre kulturor”.⁸

Gjuha e fesë mund të përdoret si mjet pozitiv dhe si mjet negativ për të ndikuar te grupet fetare, në varësi të pozicionit që mban folësi.

Nëse dikush dëshiron t'i shërbejë popullit, përdor një gjuhë të kujdesshme në të gjitha ngjarjet shoqërore, kolektive, politike, fetare dhe kulturore.

Gjuha kundërshtuese do të ishte shumë e rrezikshme dhe do të nxiste përleshje me pasoja të paimagjinueshme.

8. Ana, Salgado C., (2014), *Review of empirical studies on impact of religion, religiosity and spirituality as protective factors*, Propósitos y Representaciones Ene.-Jun. 2014, Vol. 2, N° 1. <http://dx.doi.org/10.20511/pyr2014.v2n1.55> p. 146.

Ndikimi pozitiv i fesë nëpërmjet gjuhës

Objektivi i parë i kësaj sinteze dhe riformulimi është të ofrojë kritere përshkruese, me anë të të cilave ne mund të dallojmë një këndvështrim fetar të shëndetshëm nga ai i pashëndetshëm.⁹

Si feja ashtu edhe spiritualiteti mund të kenë një ndikim pozitiv në shëndetin mendor. Në disa mënyra, ato japin të njëjtin ndikim. Për shembull: Si feja, ashtu edhe spiritualiteti mund ta ndihmojnë një person të tejkalojë stresin duke prodhuar paqe, qëllim dhe falje. Por, përfitimet në përgjithësi, ndryshojnë midis të dyve për shkak të natyrës së tyre të ndryshme. Feja u jep njerëzve diçka për të besuar, ofron një ndjenjë të strukturës dhe zakonisht ofron një grup njerëzish për t'u lidhur me besime të ngjashme. Këto aspekte mund të kenë një ndikim të madh pozitiv në shëndetin mendor - hulumtimet sugjerojnë se religjioziteti redukton shkallën e vetëvrasjeve, alkoolizmit dhe përdorimit të drogës. Këtu janë disa nga përfitimet kryesore të fesë për shëndetin mendor. Komuniteti fillon lidhjet sociale me anëtarët e tjerë. Komuniteti krijon një ndjenjë të përkatësisë në një grup dhe ofron një angazhim social të besueshëm dhe të sigurt.

9. Vicky, Genia, (1990) *Religious Development: A Synthesis and Reformulation*, *Journal of Religion and Health*, Vol. 29, No. 2, 1990, f. 85

Feja i ndihmon njerëzit të përballen me situata të vështira jetësore (p.sh. një ceremoni për humbjen e një personi të dashur) dhe siguron strukturë, rregullsi dhe parashikueshmëri, si dhe ofron kohë për të pushuar gjatë pushimeve dhe periudhave të tjera të veçanta gjatë vitit.

Feja jep mësim dhe udhëzime për të jetuar (d.m.th. rëndësia e të bërit gjënë e duhur), mëson dhembshurinë, faljen dhe mirënjohjen si dhe identifikon mësimet e jetës edhe nga situatat sfiduese. Spiritualiteti është një ndjenjë e lidhjes me diçka më të madhe se ne, ajo e ndihmon një person të shikojë në brendi dhe të kuptojë veten e tij, por, gjithashtu, edhe të gjejë përgjigjen më të madhe se si përshtatet me pjesën tjetër të botës. Me fjalë të tjera, feja i ndihmon njerëzit të kuptojnë interpretimin e tyre për kuptimin e jetës.¹⁰

Pasi kemi shfletuar literaturën mbi fenë dhe shëndetin, do ta mbyllim me një sërë propozimesh përmbledhëse, duke përmbledhur pjesën më të madhe të diskutimit të rishikimit aktual, por të ofruara në mënyrë që t'i nënshtrohen diskutimeve të mëtejshme, përsosjes dhe kërkimit të mundshëm empirik:

1. Feja ka të bëjë me shëndetin në kuptimin e saj më të gjerë, atë të tërësisë ose të mirëqenies.

2. Pjesëmarrja fetare kontribuon në shëndetin fizik e mendor dhe mirëqenien subjektive, përmes formësimit të sjelljes, krijimit të sistemeve të kuptimit, ndryshimit të këndvështrimit të dikujt për jetën, ndërtimit të komunitetit dhe mbështetjes sociale, mbështetjes së besimeve morale dhe përmes një eksperience të transcendentit.

3. Format e përbashkëta të pjesëmarrjes fetare ndikojnë më fuqishëm në shëndetin e jo praktikave private.

4. Komunitetet dhe personat fetarë mund të promovojnë shëndetin përmes kujdesit, ndërhyrjeve për promovimin e shëndetit, kujdesit shpirtëror në mjediset mjekësore dhe ato në fund të jetës, ndërhyrjet e faljes dhe thjesht duke ofruar një formë të pjesëmarrjes kuptimplote shoqërore.

5. Një kuptim fetar i shëndetit, sëmundjes dhe mirëqenies, dhe i veprimeve të nevojshme për të promovuar shëndetin, shpesh do t'u bëjë thirrje koncepteve teologjike, si mëkati, shpëtimi, karakteri, dashuria, veprimi hyjnor dhe falja.¹¹

Gjuha e matur e fesë ka ndikim në shoqëri dhe në të gjitha organizatat shoqërore. Ndryshime të tilla sociale mund të jenë pozitive nëse interpretimet janë pozitive.

10. Amoah, H., (2021), *The Impact of Religion Views on Culture and Values, Introduction to Multicultural Studies in the 21st Century*, Creative Commons, Spring, f. 6

11. Tyler, VanderWeele J., (2019), *Religion and health: a synthesis*, Harvard T.H. Chan, School of Public Health, 2019/01, Oxford University press, f. 391

Përfundim

Nga hulumtimi në këtë punim, shihet qartë se përdorimi i gjuhës së matur dhe të kujdesshme gjatë shpjegimit të fesë dhe nocioneve fetare ofron një përfitim të madh në shoqëri dhe nuk krijon urrejtje reciproke ndërmjet popujve, kulturave dhe feve të ndryshme.

Duhet të themi se është thelbësore të lihen mënjane paragjykimet e stereotipet dhe, përkundrazi, duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për kryerjen e punëve kërkimore me saktësi shkencore për të përballuar sfidat e pasurisë dhe kompleksitetit të qenies njerëzore.

Gjuha e fesë sqaron nëse feja mund të ketë një rol të rëndësishëm në interpretimet dhe shtjellimet e fesë. Religjioziteti dhe spiritualiteti, si faktorë mbrojtës në jetën e njerëzve, mund të evidentohet jo vetëm në shëndetin e tyre, por edhe në mënyrën se si ata ndërveprojnë me mjedisin, duke ndikuar në marrëdhëniet e tyre familjare, romantike, akademike, të punës e sociale dhe duke ndikuar në vizionet e tyre për veten dhe botën përreth tyre.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet se gjuha e fesë u jep njerëzve diçka për të besuar, ofron një ndjenjë të strukturës dhe zakonisht u ofron njerëzve pikënisje për t'u lidhur me besime të ngjashme. Komuniteti fetar fillon lidhjet shoqërore përmes leksioneve,

bisedave dhe shpjegimeve me anëtarët e tjerë dhe krijon një ndjenjë përkatësie në një grup, si dhe ofron një angazhim social të besueshëm dhe të sigurt.

Në kohën e krizës bashkëkohore, gjuha pozitive e fesë mund të ketë ndikim më të madh se çdo gjuhë tjetër dhe mund të kontribuojë në qetësimin e mendjes njerëzore, ushqen shpirtin e zbrazët, zhduk urrejtjen nga brendia e njerëzve dhe shëron shëndetin psiko-fizik.

Përdorimi i një gjuhe të butë dhe mirëkuptimi mund të ndalojë çdo luftë dhe mund të ndihmojë në zhdukjen e përdorimit të armëve midis popujve të botës, sepse pas çdo gjuhe të ashpër, ka një luftë të ashpër dhe pas çdo gjuhe mirëkuptimi, ka afrim dhe dialog, që sjell paqe për të gjithë.

Pra, gjuha e mirëkuptimit fetar është mënyra më e përshtatshme për të siguruar ndikimin pozitiv në ndryshimet shoqërore.

Keqinterpretimet dhe përdorimi i gjuhës fyese, gjatë shpjegimit të mësimave fetare në shoqëri, mund të ndikojnë në ndarjen e njerëzve dhe komuniteteve të ndryshme.

Pra, predikuesi i fesë mund të ndikojë pozitivisht në forcimin e lidhjeve shoqërore dhe të shmangë çdo grindje eventuale nga mosmarrëveshjet, të cilat formohen nga gjuha e sharjeve dhe e fyerjeve ndaj të tjerëve.

Referencat

- [1] Amoah, H., (2021), The Impact of Religion Views on Culture and Values, Introduction to Multicultural Studies in the 21st Century, Creative Commons, Spring.
- [2] Vicky, Genia, (1990) Religious Development: A Synthesis and Reformulation, Journal of Religion and Health, Vol. 29, No. 2, 1990.
- [3] Lombaerts, Herman, (2011), The Impact of the Status of Religion in Contemporary Society upon Interreligious Learning, The Person and the Challenges, Volume 1 (2011) Number 2.
- [4] Ana, Salgado C., (2014), Review of empirical studies on impact of religion, religiosity and spirituality as protective factors, Propósitos y Representaciones Ene.-Jun. 2014, Vol. 2, N° 1. <http://dx.doi.org/10.20511/pyr2014.v2n1.55>.
- [5] Swallfors, Stefan, (2007) The Political Sociology of Welfare State, Institutions, social cleavages, and orientations, Stanford: Stanford University Press.
- [6] Gangte, Tingneichong (2018), An essay on religion and society, JETIR, December, Volume 5, Issue 12.
- [7] Tyler, VanderWeele J., (2019), Religion and health: a synthesis, Harvard T.H. Chan, School of Public Health, 2019/01, Oxford University press.
- [8] Weiqian, Xia, (2021) The Political Sociology of Religion The Impact of Religion on Political Attitudes and Behaviors in Secularizing European Societies, Universities service US-AB, Stockholm 2021.

Legjislacioni Shqiptar në lidhje me Komunitetin Mysliman, në vitet 1944-1967

Dr. Denald Prifti

Historian, autor në fushën e botimeve mbi religjionet dhe propagandën

Abstrakt

Partia Komuniste krijoi një situatë krejt tjetër për komunitetet fetare, dhe në vitet e para të qeverisjes dha përshtypjen e një regjimi që respektonte dhe garantonte zbatimin e standardeve demokratike në fushën e besimit dhe të lirisë së ndërgjegjes. “Këtë përshtypje ai – pushteti – e krijoi duke u mbështetur në dy faktorë: Së pari, ai u bazua në dy dokumente të rëndësishme ligjore, në deklaratën e të drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, të miratuar në Mbledhjen II të KANÇ-it në Berat (tetor 1944) dhe, më kryesorja, në Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946...”.

Politikat ligjore të ndjekura nga shteti shqiptar në vitet 1944-1990 nuk ishin të njëjtat me politikat e mëparshme të ndjekura nga Ahmet Zogu në periudhën 1925-1939. Pushteti shtetëror synonte realizimin e objektivave të vendosura nga ai vetë. Është i njohur fakti se në këtë kohë nuk ishte në nivelet e dubura liria e fesë dhe e besimit. Raportin midis institucioneve fetare dhe atyre të shtetit filloi ta dominonte pushteti politik. Marrëdhëniet vinin gjithnjë e më shumë duke u vështirësuar, si ‘de jure’ ashtu edhe ‘de facto’. Pushteti, gjithnjë e më shumë, e shtriu ndikimin dhe dominimin e tij, duke mos lënë ndarjen e fesë nga ndikimi i pushtetit. Për sa i përket lirisë së ndërgjegjes dhe asaj të besimit, si dhe e ushtrimit të fesë, në shumë raste vërehen shkelje të rënda.

Në praktikën reale, sidoqoftë, regjimi i ri shqiptar kërkoi të shkatërronte rolin dhe ndikimin e fesë dhe të organizatave fetare kombëtare. Gjatë viteve 1945 dhe 1946 shteti nxori jashtë ligjit shkollimin fetar, si dhe mbylli shkollat fetare private që kishin mbetur; institucionet fetare humbën të drejtën e mbajtjes së tokës nga Ligji i Reformës Agrare të vitit 1946; të gjitha botimet dhe komunikimet fetare, duke përsërirë edhe predikimet, dusheshin

shqyrtuar dhe miratuar nga autoritetet shtetërore, përpara se ato të jepeshin në publik; si dhe të rinjtë e kombit u nxitën të mos marrin pjesë në shërbimet dhe veprimtarinë fetare.

Shqipëria, për afro gjysmë shekulli, përjetoi një formë komunizmi të ndryshëm nga ai i pjesës tjetër të Evropës Lindore. Kjo ishte “një përzierje fatale e diktaturës dhe izolimit, që e mbajti këtë vend të vogël ballkanik në gjendjen e më të varfrit dhe më të shtypurit në të gjithë Evropën. Gjatë mbretërimit të tij 40 vjeçar, udhëheqësi shqiptar Enver Hoxha ndaloi fenë, ...dhe e shpalli të paligjshme pronën private. Çdo lloj forme rezistence ndaj sundimit të tij u ndesh me shtypje të egra, që nga internimet, burgimet e gjata e deri tek ekzekutimet¹”.

Aktet juridike të nxjerra gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ishin: “Rezoluta e Konferencës së Pezës (16 shtator 1942)”, me të cilën Këshillat Nacionalçlirimtare autorizoheshin të mbanin rregullin dhe qetësinë dhe t’i dënonin tradhtarët, elementët e kolonës së pestë dhe në përgjithësi të luftonin kriminalitetin; “Rregullorja e Këshillave Nacionalçlirimtare”, e miratuar në Labinot (5 shtator 1943), që në fakt ishte një lloj ligji penal, ku u parashikuan llojet më të rëndësishme të veprave penale si dhe dënimet ndaj atyre që i kryejnë

1. Human Rights Watch/Helsinki, *Të drejtat në Shqipërinë Post-Komuniste*, New York, 10 maj 1996, f. 1.

ato. Lidhur me këtë, në një urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Brigadës së I të Ushtrisë Nacionalçlirimtare (5.09.1943), jepej nocioni i krimin politik².

Mbledhja e dytë e Këshillit Nacionalçlirimtar, në datat 20-30 tetor 1944, e mbajtur në Berat, vendosi për miratimin e një deklarate të drejtave të qytetarëve, në të cilën garantohej mbrojtja e lirisë, të drejtave të përgjithshme, liria e besimit dhe e ndërgjegjes, dhe iu njohën të drejta të barabarta të gjitha besimeve fetare³.

Por përpara se të miratohej kjo deklaratë, në kohën e “Republikës I-rë Shqiptare, në vitin 1925, ishin sanksionuar parimet e laicitetit të shtetit dhe të lirisë së ndërgjegjes e të besimit fetar, parime këto, që gjetën riafirmim edhe në Statutin e Mbretërisë Shqiptare (përkatësisht artikujt 5,5).⁴”.

Pas vitit 1944 pushteti nuk vlerësoi siç duhej, madje filloi ta shkelë edhe më tej parimin e vendosur në vitin 1922, ku thuhej se:

2. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, *Studime Juridike nr. 1*, Luarasi, Tiranë, 2002, f. 83.

3. Giovanni Cimbalò, *Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri*, Naimi, Tiranë, 2013, f. 89.

4. Aurela Anastasi, *Historia e të Drejtës Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, PEGI, Tiranë, 2007, f.194

“Shteti s’ka fe zyrtare. Të gjitha fetë janë të nderueme dhe liria e ushtrimit dhe e praktikimit të jashtëm të tyre asht e sigurueme. Ndryshimi i fesë nuk formon ndalim ose pazotësi juridike për pasjen ose ushtrimin e të drejtave civile e politike.”⁵”.

Partia Komuniste krijoi një situatë krejt tjetër për komunitetet fetare dhe në vitet e para të qeverisjes dha përshtypjen e një regjimi që respektonte e garantonte zbatimin e standardeve demokratike në fushën e besimit dhe të lirisë së ndërgjegjes. “Këtë përshtypje ai – pushteti – e krijoi duke u mbështetur në dy faktorë: Së pari, ai u bazua në dy dokumente të rëndësishme ligjore, në deklaratën e të drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, të miratuar në Mbledhjen II të KANÇ-it në Berat (tetor 1944) dhe, më kryesorja, në Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946...”⁶.

Politikat ligjore të ndjekura nga shteti shqiptar në vitet 1944-1990 nuk ishin të njëjtat me politikat e mëparshme të ndjekura nga Ahmet Zogu në periudhën 1925-1939. Pushteti shtetëror synonte realizimin e objektivave të vendosura nga ai vetë. Është i njohur fakti se në këtë kohë nuk ishte në nivelet e duhura liria e fesë dhe e besimit. Raportin midis institucioneve fetare dhe atyre

të shtetit filloi ta dominonte pushteti politik. Marrëdhëniet vinin gjithnjë e më shumë duke u vështirësuar, si ‘de jure’ ashtu edhe ‘de facto’. Pushteti, gjithnjë e më shumë, e shtriu ndikimin dhe dominimin e tij, duke mos lejuar ndarjen e fesë nga ndikimi i pushtetit. Për sa i përket lirisë së ndërgjegjes dhe asaj të besimit, si dhe e ushtrimit të fesë, në shumë raste vërehen shkelje të rënda.

Në praktikën reale, sidoqoftë, regjimi i ri shqiptar kërkoi të shkatërronte rolin dhe ndikimin e fesë dhe të organizatave fetare kombëtare. Gjatë viteve 1945 dhe 1946 shteti nxori jashtë ligjit shkollimin fetar, si dhe mbylli shkollat fetare private që kishin mbetur; institucionet fetare humbën të drejtën e mbajtjes së tokës nga Ligji i Reformës Agrare të vitit 1946; të gjitha botimet dhe komunikimet fetare, duke përfshirë edhe predikimet, duheshin shqyrtuar dhe miratuar nga autoritetet shtetërore, përpara se ato të jepeshin në publik; si dhe të rinjtë e kombit u nxitën të mos marrin pjesë në shërbimet dhe veprimtarinë fetare.⁷

Më 17 mars 1945 qeveria shqiptare, me anë të një qarkoreje, njoftonte që mësimet e fesë do të zhvilloheshin në shkollat publike,

5. *Po aty*, vep. e cit., f.194

6. Shyqyri Hysi, *Legjislacioni fetar në Shqipëri, në Studime Historike, Nr.1-2*, Tiranë, 2006, f.171

7. Nicholas Pano, *Feja në Shqipëri: Trashëgimia e epokës komuniste. Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e Ri*, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004, f. 150.

duke lënë në dispozicion për këtë lëndë vetëm disa orë mësimi në muaj.⁸

Në vitin 1945 e në vazhdim, shteti shqiptar i asaj kohe do të krijonte një Komitet për çështjet fetare, ku do të kontrollonte projektstatutet dhe projekt rregulloret e komuniteteve fetare, do të kontrollonte përbërjen e këtyre komuniteteve, buxhetin dhe veprimtarinë e tyre. Pra shteti, pak nga pak, po e vinte nën kontroll aktivitetin e komuniteteve fetare dhe politikën e komuniteteve tashmë nuk ishin si më parë, pasi kontrolloheshin nga pushteti.

Liria e besimit u zëvendësua gradualisht me politika që do të shpinin në mohimin e plotë të fesë, edhe pse në aktet e para ligjore e kushtetuese njihet *de jure* kjo liri. Që në Kushtetutën e parë komuniste, atë të vitit 1946, ishte sanksionuar liria e ndërgjegjes dhe e besimit, liria e ushtrimit dhe e praktikimit të besimeve fetare, ndërsa shteti, ashtu si më parë, ishte asnjans dhe laik. Por, në këtë Kushtetutë, në paragrafin e katërt të nenit 18, thuhet se “ndalohej që kisha dhe feja të shpërdoreshin për qëllime politike, [dhe kjo] shërbeu si bazë për persekutimin e dhjetëra klerikëve, të cilët u akuzuan për pjesëmarrje politike, me qëllim rrëzimin e regjimit.”⁹

8. Cimbalo. vep. e cit., f. 110.

9. Nicholas Pano, *Feja në Shqipëri...* vep. e cit., f. 209.

Që në fillim, në vitet 1947 dhe 1949, shteti filloi të ushtrojë ndikim te komunitetet fetare, për shkak të rezistencës që ata bënin, por edhe për faktin se një pjesë e tyre kishin bashkëpunuar dhe i kishin shërbyer regjimeve të cilët kishin qenë aleatë me Boshtin, gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Më poshtë do të shohim më gjerë se si ka ndikuar pushteti i asaj kohe, pas vitit 1944 e në vazhdim, në marrëdhëniet midis bashkësive fetare dhe shtetit, të liritë dhe të drejtat njeriut, për sa i përket besimit, si dhe mohimit gradual i tyre.

Legjislacioni i Komunitetit Mysliman

Qysh në vitin 1923, bashkësia myslimane shqiptare kishte shpallur Autoqefalinë e Xhamisë Shqiptare. Vitet ‘20-‘30 ishin vitet e fillimit të reformave edhe në këtë bashkësi. “Me Kodin e ri Civil shqiptar, statusi fetar u zëvendësua me statusin personal laik... Duke zbatuar ligjin për komunitetet fetare të vitit 1929, sunitët shqiptarë, në Kongresin e tyre, morën një varg masash radikale, si: përdorimin ekskluziv të gjuhës shqipe për lutjet dhe predikimin; administrimin e centralizuar të gjithë pasurive të vakëfeve;... Bektashinjtë,...gjetën mbështetje të veçantë nga qeveria shqiptare e kohës¹⁰.”

10. Aurela Anastasi, *Historia e të Drejtës...* vep. e cit., f. 197-198.

Këshilli Drejtues i rinisë myslimane aktivizohet fuqishëm për rikthimin e statutit të vitit 1929 të këtij komuniteti, por më “22 dhjetor 1945 qeveria miratoi statutin e ri të komunitetit mysliman shqiptar, i cili edhe pse mbështetej në atë të 1929-s, kishte në përbërjen e tij një parathënie dhe 10 kapituj, si dhe, aty këtu, kishte disa ndërhyrje dhe modifikime në krahasim me atë të kohës së Zogut¹¹”.

Vazhdimësinë legislative e ndërpriste teoria socialiste pasí, për sa: “i përket anës së brendshme, teoria socialiste e së drejtës i është përmbajtur parimit se revolucioni ndërpret çdo vazhdimësi midis shtetit të vjetër dhe shtetit të ri dhe se tipi i ri i shtetit, veçanërisht ai socialist, nuk ka asnjë vazhdimësi ligjore me shtetin e vjetër të përmbysur. Në bazë të këtij parimi, pas çlirimit të vendit, me ligjin Nr. 61, dt.17 maj 1945 të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar u shfuqizuan dhe u shpallën si të paqena të gjitha normat juridike të nxjerra gjatë kohës së pushtimit italian dhe gjerman...¹²”.

Edhe parimi i unitetit të pushtetit, i cili në fillim u përfytyrua si një parim që nëpërmjet epërsisë së organit më të lartë përfaqësues do të siguronte zbatimin e vullnetit të popullit, u shndërrua në praktikë në

një fasadë prapa së cilës Asambleja Përfaqësuese (në Shqipëri Kuvendi Popullor) votonte mekanikisht projektligjet që i paraqiteshin dhe që kishin marrë paraprakisht pëlqimin e organeve të larta partiake.¹³

Në vitin 1947 nisi ndikimi kundër klerit mysliman. “Me dekretin Nr. 392, të janarit 1947, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, sqarohet se: dispozitat që ekzistonin përpara 7 prillit 1939 nuk mund të shërbenin në asnjë rast si dispozita në fuqi, se ato mund të shërbenin si rregulla ndihmëse, kur nuk ishin në kundërshtim me rendin e ri dhe përkohësisht, derisa të viheshin norma pozitive të reja.¹⁴”.

Por liria e ndërgjegjes dhe e fesë është një liri thelbësore, e brendshme e çdo individi dhe që s’duhet kufizuar e shmangur. Secili duhet të zgjedhë ose të ndryshojë bindjet ose fenë, si dhe t’i shfaqte bindjet fetare individualisht ose kolektivisht, në publik ose privatisht. E drejta dhe liria e fesë përfshin manifestimin e saj të jashtëm nëpërmjet riteve dhe praktikave.

Në nenin 18 të Deklaratës Universale të vitit 1948, thuhet se: “Çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet si dhe lirinë për të manifestuar fenë ose bindjet, vetëm për vetëm

11. Cimbalo, vep. e cit, f. 92-93.

12. Luan Omari, *Parime dhe Institucione të së Drejtës publike*, “Elena Gjika”, Tiranë 2004, f. 280- 281.

13. *Po aty*, vep. e cit, f. 268, 277.

14. *Po aty*, f. 281.

apo bashkërisht, si në publik ashtu edhe privatisht, nëpërmjet arsimit, praktikave, kultit dhe kryerjes së riteve.¹⁵⁷

Por a ekzistonin në Shqipëri liria për të mbajtur institucione bamirësie, liria për të praktikuar kultin, për të blerë e për të shitur, liria për të shtypur, shkruar e shpërndarë botime në fushën fetare, për të mësuar një fe, për të kërkuar e për të marrë ndihma vullnetare financiare, liria për të përgatitur, emëruar, zgjedhur ose caktuar sipas radhës drejtues të përshtatshëm në përputhje me normat e fesë e të besimit, liria për të pasur mundësi komunikimi me individë, liria për të pasur ditë pushimi, për të shënuar festat fetare, etj.? Përgjigjen do ta shohim më poshtë më gjerësisht.

Me miratimin e ligjit të ri për komunitetet fetare më 1949, nuk u shtuan më shumë të drejtat dhe liritë e komuniteteve fetare, por u pakësuan më shumë se ç'ishin më parë. Ligji i ri hynte në mënyrën e organizimit të komuniteteve fetare dhe në modifikimin e vullnetit të këtyre komuniteteve. Ai prekte lirinë e komuniteteve fetare në shumë aspekte. Nëpërmjet tij pushteti gjithnjë e më shumë do të fillonte të zgjeronte kontrollin mbi bashkësitë fetare. Jo vetëm që do t'u cenohej

pavarësia e këtyre komuniteteve, por kjo pavarësi me kalimin e kohës do të zhdukej pothuajse tërësisht. Nëpërmjet ndërhyrjeve pushteti do të ndikonte te komunitetet fetare por edhe tek ai mysliman që të ndryshonin statutet, rregulloret, mendimet dhe qëndrimet e tyre, si dhe çdo aspekt tjetër që binte ndesh me politikën e ndjekur nga pushteti i asaj kohe.

Dekret-ligji i Komuniteteve fetare i vitit 1949 parashikonte se: “Çdo komunitet fetar duhet të rishikojë statutin e vet për ta përshtatur me 37 nenet e dekretit e më pas t’ia paraqesë atë për miratim Këshillit të Ministrave. Në këtë mënyrë sheshohen veçoritë e kulteve të ndryshme... dekreti parashikon ta thjeshtojë përbërjen e organizatave fetare (neni 8)... Sipas Statutit të ri, zgjedhjet e drejtuesve të komunitetit fetar, të rregullores së tij, buxhetit, botimeve, të vulave dhe shenjave të tjera simbole, duhet të kenë miratimin e Këshillit të Ministrave... Duke e krahasuar këtë dekret me atë të kohës së Zogut, mund të thuhet se ai mbart ndryshime rrënjësore në statusin juridik të komuniteteve fetare, pasi u kufizon ndjeshëm lirinë e veprimit dhe ndërhyrjen në punët e brendshme.¹⁶⁷

Ky Dekret-ligj kërkonte të dhëna biografike për personelin fetar, si dhe çdo veprim që do të bëhej, do të bëhej vetëm me miratimin e qeverisë.

16. Cimbalo. vep. e cit, f. 116.

15. *Të drejtat e Njeriut. Përmbledhje aktesh ndërkombëtare.* Botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Shtëpia botuese Enciklopedike TEKNOTRADE LTD, Tiranë 1993, f. 27.

Gjithashtu duhej të dëshmohej besnikëri ndaj pushtetit në fuqi, të ushtrohej kontroll ekonomik mbi buxhetin e komunitetit, ndalohej ose kufizohej ndërtimi i institucioneve arsimore, kulturore e humanitare të këtyre komuniteteve.

Në nenin 12 të këtij dekret-ligji thuhej se: “Komunitetet fetare me aktivitetin e tyre duhet të zhvillojnë në besimtarët ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit të popullit...¹⁷”. Ky nen shkelte lirinë e besimit, edhe pse liria e besimit: “është një liritë mjaft të rëndësishme dhe e kushtëzuar nga roli i fesë në zhvillimin e personalitetit të njeriut. Në anën tjetër, kjo paraqet kusht dhe garanci të lirive dhe të drejtave personale e politike të tjera të njeriut.¹⁸”.

Statuti i 29 qershorit 1950, i Komunitetit Mysliman Shqiptar, në nenin 2 vinte kushte pasi në të thuhej se: “Komuniteti Mysliman Shqiptar ka për detyrë të ngjallë e të zhvillojë në besimtarët ndjenjat e dashurisë e të besnikërisë... ndaj pushtetit popullor...¹⁹”.

Ndikimi politik me anë të ligjeve e të urdhëresave do të vinte duke u rritur gjithnjë e më shumë me kalimin e viteve dhe konsolidimin

e mëtejshëm të pushtetit popullor, të partisë. Botimet që duhej të bëheshin, mund të botoheshin vetëm pasi të ishin kontrolluar nga organet e pushtetit, dhe buxheti i bashkësisë myslimane varej nga shteti dhe të gjitha pasuritë e tyre ishin nën kontrollin dhe verifikimin e shtetit. Siç e shohim, komunitetet fetare, si dhe ai mysliman, nuk kishin autonomi në administrimin e tyre dhe ishin të kontrolluara.

Në nenin 52, po të Statutit të 1950, shihet më qartë kjo që shprehëm më sipër, pasi aty thuhej se: “Nuk mund të pranohen n’asnjë mënyrë, ose të dërgohen dhuratë ose subvencione nga shtetet e huaja përveç kur është pëlqyer nga Kryeministria.²⁰”. Pra “Komuniteti Mysliman shqiptar financohej nga shteti; të ardhurat e veta nga vakëfet dhe ndihma të ndryshme, duke u përjashtuar ndihmat nga jashtë.²¹”.

Gjithashtu, drejtuesit e institucioneve fetare duhet të kishin bekimin e Partisë dhe të pushtetit përpara se të zgjidheshin në krye të institucioneve të këtyre komuniteteve. Sipas dokumenteve të kohës del se, “nëse Partija dhe Qeverija e jonë demokratike e

17. Azem Qazimi, *Komunitetet fetare...* vep. e cit., f. 24.

18. Kurtesh Salju, *E Drejta Kushtetuese*. Libri I (Botimi i katërt), Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2004, f. 226.

19. Azem Qazimi, *Komunitetet fetare...*, vep. e cit., f. 57.

20. AQSh, F. Kryeministria, nr. 490, viti 1950, d. 2211, fl. 7. Dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi aprovimin e Statutit të Komunitetit Mysliman, dhe Azem Qazimi, *Komunitetet fetare...*, vep. e cit., f. 71.

21. “Gazeta Zyrtare”, 12 dhjetor 1949; Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, 55, Tiranë, 2006, f. 635.

ka ngrit besimin ndaj personit tonë, lutemi me na njoftue që të hiqen nga ofiqet e Drejtorit të përgjithshëm të vakfve dhe nga ai i Kryesisë së Komunitetit Mysliman; tue ndej gjithmonë besnik i patundun i Partisë, i Qeveris dhe i principeve demokratike të regjimit t'onë popullor.²²”. Sipas nenit 13 të dekret ligjit për komunitetet fetare të vitit 1949: “pasi të zgjidhen ose të emërohen nga organet fetare kompetente, duhet të aprovohen nga Këshilli Ministerial.²³”.

Edhe në rregulloren e aprovuar në vitin 1951 të Komunitetit Mysliman Shqiptar, kishte ndikime të pushtetit. Në nenin 49 thuhej se: “I gjithë personeli i trupit mësimuer për t'u marrë në shërbim duhet të ketë këto kondita: - ku veç të tjerave, kërkohej edhe - c) të ketë sjellje morale e politike të mira, të vërtetuara nga organet kompetente të Shtetit.²⁴”.

Po kështu, edhe në emërimin e vaizit, sipas nenit 91 të rregullores së mësipërme, dhe të funksionarëve të komunitetit, në nenet 113, 107, duhej patjetër të kishin dokumente mirësjellje, sjellje të mirë politike dhe të paraqisnin biografite e tyre.

22. AQSH, F, Komuniteti Mysliman Nr.482, viti.50, d. 2215, fl. 6.

23. Azem Qazimi, *Komunitetet fetare...*, vep. e cit., f. 24.

24. AQSh, F, Kryeministria, nr. 490, viti 1954, d. 1109, fl. 7.

Më konkretisht në nenin 91 thuhej se: “Për emnimin e Vaizit, Imamit nevojiten konditat që vijojejnë: b) të ketë dokumenta mirësjellje, morale dhe politike nga organet Shtetnore kompetente. c) Të paraqesin biografite e tyre dhe dokumentet e studimeve që kanë bërë. Gjithashtu, në nenin 113 thuhej se: Funksionarëve t'administratës së Komunitetit dhe të Drejtorisë Përgjithshme të vakfeve, kur nuk respektohen udhënimet e Statutit dhe të rregullores në të kryemit e detyrave të tyre, mirren masa disiplinore, sipas randësisë së rastit, të cilat janë: 1) Vërejtje e lehtë; 2) Vërejtje me shkrim dhe shënim në biografi...²⁵”. Edhe Rregullorja e Medresesë së Përgjithshme të Komunitetit Mysliman Shqiptar, në nenin 3 të saj sanksiononte se: “në Medresenë e Përgjithshme pranohen ata studenta që kanë këto kondita ... [ku ndër të tjera kërkohej edhe]... b) Të ketë sjellje të mira morale e politike²⁶”.

Po kështu, edhe në nenin 52 të kësaj rregulloreje kërkohej që: “Kandidatët për bursë ose me pagesë duhet t'i paraqesin në Kryesi të Komunitetit Mysliman dokumentet e nevojshme. Këto dokumenta janë: [veç të tjerave edhe] ... ç) certifikata e mirësjelljes së kandidatit ku të

25. *Po aty*, fl. 14,16.

26. *Po aty*, Rregullorja e Medreses Përgjithshme të Komunitetit Mysliman Shqiptar, fl. 2.

shënohet dhe gjendja shoqërore e politike e familjes së tij...²⁷”.

Edhe rregullorja e sektit Halveti, që varej nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në nenet 19-18 të saj shprehej se: “Të gjithë Klerikët e sektit halveti duhet të jenë... përkrahës t’interesave të popullit dhe besnik të Pushtetit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë... - për kryerjen e detyrave duhet të kenë - konditë të mirë morale shoqërore e politike, duhet të jenë besnik të Pushtetit Popullor.²⁸”.

Gjatë kësaj kohe, kur në Shqipëri u cenonin liritë dhe të drejtat, në vendet e zhvilluara perëndimore vepronte Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e vitit 1953, ku në nenin 9 të saj thuhej: “1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si dhe lirinë për të shfaqur fenë e vet ose bindjet qoftë individualisht, qoftë së bashku me të tjerë, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë ose bindjeve mund t’i nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve që janë të parashikuara me ligj dhe janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurimit publik, për mbrojtjen e rendit,

27. *Po aty*, fl. 6.

28. AQSh, F. Kryeministria, nr. 490, viti 1954, d. 1110, fl. 2. Rregullore Themeltare e sektit Halevit.

shëndetit dhe moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.²⁹” Jo vetëm që s’u arritën kërkesat e nenit 9 të Konventës Evropiane, ku Shqipëria u bë pjesë më 1995, por nuk u respektuan as të drejtat më minimale lidhur me lirinë dhe të drejtat e besimit.

Në statutin e Komunitetit Mysliman Shqiptar të vitit 1964, në nenin 2 të tij thuhej se: “Komuniteti Mysliman Shqiptar ka për detyrë... të zhvillojë ndjenjat e dashurisë e të besnikërisë ndaj... Pushtetit të Popullit...³⁰”. Po kështu edhe rregullorja e re e brendshme e Komunitetit Mysliman, e vitit 1964, në nenin 42/b sanksiononte se: “Në Medrese pranohen nxanës që kanë këto kondita: b)Të kenë sjellje të mira morale dhe politike.³¹”.

Po kështu kërkohej në nenet e tjera të kësaj rregulloreje lidhur me emërimin e Vaizit e të Imamit, dhe të nëpunësve të tjerë të administratës së Komunitetit Mysliman Shqiptar. Në relacionet mbi rregulloren e re thuhej se duhej të kërkohej më shumë lidhur me sjelljen shoqërore e politike të funksionarëve të komunitetit dhe ndaj besimtarëve.

29. Arben Puto, *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në përfaqje me Kushtetutën e Shqipërisë*, Albin, Tiranë 2002, f. 55.

30. AQSh, F. Kryeministria, nr. 490, viti 1964, d. 1253 Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar, 1963, fl. 14.

31. *Po aty*, Rregullore e Mbrendshme e Komunitetit Mysliman Shqiptar, fl. 95.

Në përfundim duhet të theksojmë se: Goditja kundër klerit, mendoj se u bë sipas këshillës që Stalini i dha udhëheqësit shqiptar që klerikët nuk duhen akuzuar në rrafshin fetar, por në atë politik, pra që shkelin ligjet e shtetit, të cilët janë njësoj për të gjithë shtetasit, dhe nuk duhet lejuar që kleri të jetë shtet brenda shtetit. Dhe kështu pjesa më e madhe e klerikëve të goditur, kryesisht katolikë, u akuzuan si bashkëpunëtorë me pushtuesit, si agjentë të shërbimeve të huaja, tradhtarë të vendit, sabotatorë, etj., pra krime që konsideroheshin si krime kundër shtetit.

Propaganda antifetare zhvillohej në një front shumë të gjerë, me të gjitha mjetet që shteti kishte në dispozicion, për të mos e lënë klerin që të reagonte dhe të zhvillonte propagandën e tij. Prandaj, propaganda e klerit u kufizua vetëm në objektet e kultit dhe nuk lejohej jashtë tyre, duke nxjerrë pengesa të shumta për zhvillimin e ceremonive dhe festave fetare jashtë objekteve të kultit.

Regjimi komunist, duke e ditur se propaganda fetare mund të ishte shumë e suksesshme te nxënësit e shkollave, që në fillim e hoqi mësimin e fesë nga shkolla dhe këtë e shpalli laike, e në këtë mënyrë në shkolla organizoi propagandën e tij, e cila sulmonte besimet fetare si mbeturina të së kaluarës, që pengonin zhvillimin dhe ecjen

përpara të vendit, që e mbanin femrën të ndrydhur, etj.

Në format e propagandës, regjimi komunist u mbështet në:

- Propagandën antifetare me anë të shtypit të përditshëm, me artikuj të shumtë në gazetat e përditshme, të cilët kishin orientim që të kritikonin besimet fetare, të nxirrnin në pah arritjet e shkencës dhe që “Zoti nuk dukej gjëkund”, se “Zoti nuk ekziston, pasi ai deri më sot nuk ka ndëshkuar ata që bëjnë keq”, që të mos besonin te nuskat dhe hajmalitë por të shkonin te mjekët për t’u vizituar për sëmundje të ndryshme, etj.

- Propaganda me anë të shtypit periodik, sidomos revistat shkencore. Duhet thënë se këto botime përgjithësisht ishin përkthime të revistave sovjetike dhe të tjera antifetare që botoheshin jashtë vendit.

- Me anë të librave të ndryshëm që kishin objekt të tyre besimet fetare, të cilët ishin libra teorikë që hidhnin poshtë teoritë e ekzistencës së Zotit, që çdo gjë e vinin në balancë me shkencën, me zhvillimin e aviacionit, shkuarjen në hapësirë, etj. Këtu mund të përmendim librin Bibla për ata që besojnë dhe nuk besojnë, ku me argumente shkencore hidhen poshtë shumë teori të Biblës për lindjen e njeriut dhe të jetës në tokë. Por ka pasur edhe botime të tjera, siç i kemi përmendur në këtë studim, si ato të R. Beqajt, H. Hakos, etj.

- Propaganda me anë të dokumentarëve të ndryshëm që shfaqeshin nëpër fshatra dhe zona të tjera të banuara, ku përsëri, me figurë jepej predikimi i fetarëve me nuska dhe hajmali, gjë e cila të çonte në vdekjen e foshnjave dhe personave të tjerë, të cilët refuzonin të merrnin ndihmën e mjekëve.

- Krijimi i grupeve të të rinjve, të udhëhequr nga mësues, të cilët propagandonin kudo kundër besëtytnive dhe mbeturinave të së kaluarës, për përfshirjen e të rinjve, po sidomos të të rejave në aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive, pasi shumë prej këtyre besëtytnive kishin origjinë fetare.

- Organizimi i rretheve të pionierëve dhe të rinjve ateistë, detyra kryesore e të cilëve ishte lufta kundër fesë.

- Krijimi i bibliotekave kudo, nëpër shkolla, qytete, lagje, edhe fshatra, ku përveç letërsisë artistike, një vend të rëndësishëm zinte edhe literatura me karakter shkencor, propagandistik, revolucionare e materialiste. Një vend të veçantë kishte dhe revista Shkenca dhe feja, që merrej vetëm me diskreditimin

e besimeve fetare.

- Shtetëzimi i pronave të komuniteteve fetare, tatimi mbas luftës, taksat që u viheshin këtyre komuniteteve, bënë që fuqia ekonomike e tyre të dobësohej shumë dhe të mos arrinin që të mbanin veten. Megjithëse shteti përcaktonte një buxhet për këto komunitete, me kalimin e kohës ai u shkurtua aq shumë sa vetë komunitetet filluan të shkurtojnë organikat e tyre, pasi nuk kishin mundësi financiare për t'i mbajtur.

- Organizimi i konferencave të ndryshme me karakter antifetar, ku merrnin pjesë me detyrim, të rinj e të reja, banorë të lagjeve, të fshatrave, etj.

Duket, pas viteve 1960, kleri në Shqipëri kishte marrë goditje të rënda, pasi nuk po ftoheshin më nëpër aktivitete kombëtare, lidhjet me jashtë vendit pothuajse ishin ndërprerë përfundimisht, buxhetet kishin arritur në minimum, propaganda antifetare kishte bërë punën e vet, dhe regjimi mendoi se ndoshta kishte ardhur momenti që gradualisht të shkohej drejt zhdukjes së besimeve fetare në vend.

Bibliografia

- AQSh, F. Kryeministria, nr. 490.
- Arben Puto, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në përfaqje me Kushtetutën e Shqipërisë, Albin, Tiranë 2002.
- Aurela Anastasi, Historia e të Drejtës Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939), PEGI, Tiranë, 2007.
- Azem Qazimi, Komunitetet fetare në Shqipërinë komuniste (Dokumente), West Print, Tiranë 2014.
- Giovanni Cimbalo, Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri, Naimi, Tiranë, 2013.
- Kastriot Dervishi, Historia e shtetit shqiptar 1912-2005, 55, Tiranë, 2006.
- Kurtsh Saliu, E Drejta Kushtetuese. Libri I (Botimi i katërt), Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2004.
- Human Rights Watch/Helsinki. Të drejtat në Shqipërinë Post-Komuniste. New York, 10 maj 1996.
- Luan Omari, Parime dhe Institucione të së Drejtës publike, “Elena Gjika”, Tiranë 2004.
- Nicholas Pano, Feja në Shqipëri: Trashëgimia e epokës komuniste. Fetë dhe Qytetërimet në Mijëvjeçarin e Ri, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2004.
- Të drejtat e Njeriut. Përmbledhje aktesh ndërkombëtare. Botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Shtëpia botuese Enciklopedike TEKNOTRADE LTD, Tiranë 1993.
- Shyqyri Hysi, Legjislacioni fetar në Shqipëri, në Studime Historike, Nr.1-2, Tiranë, 2006.
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Studime Juridike nr. 1, Luarasi, Tiranë, 2002.
- “Gazeta Zyrtare”, 12 dhjetor 1949.

Poligamia në histori dhe në perspektivën islame

Prof. dr. Bekir Topaloglu

Abstrakt

Martesa me më tepër se një grua, dy, tri apo katër, në Islam, nuk është ndonjë detyrim farz apo urdhër vaxhib, por është një leje që njerëzit të largohen nga imoraliteti. Por edhe kjo leje është kushtëzuar me mundësitë dhe drejtësinë. Ajeti kur'anor (Nisa', 4:3) na shpjegon se në bashkëshortësi është kryesore të mjaftohesh me një grua, duke theksuar se martesa me një grua është më afër plotësimit të të drejtave.

Të përkujtojmë se në të drejtën islame, gruaja ka të drejtë të kërkojë që burri të mos i martohet me një grua tjetër, për aq kohë sa është e lidhur në kurore me të. Pas aktit që do të kryhet në mënyrë ligjore, marrëveshja që do të bëhet do të aktive, dhe nëse ajo e ndalon burrin të martohet rishtas, e ndërkohë ai martohet, gruas së parë i lind e drejta e shkurorezimit. Në një hadith thuhet: "Kushti që më së shumti meriton ta plotësoni është ai që e keni pranuar gjatë kurorezimit."

Në këtë rast, gruaja, në poligami do të ketë të drejtë vote. Do të eliminohen dëmet shpirtërore që i takojnë. Në shumë vende të botës zyrtarisht nuk ekziston poligamia. Por, faktikisht ajo vazhdon të përhapet. Për këtë arsye, kohë pas kohe sillen ligje të ndryshme që të përcaktohet origjina e fëmijëve sipas sistemit juridik.

Në fund, mund të thuhet se Feja Islame e ka aprovuar poligaminë për shkak të disa domosdoshmërive. Nëse njerëzia ende nuk e di dobinë e poligamisë dhe nuk e aprovon atë, s'mund të thuhet se një ditë, pas përvojave të ndryshme, nuk do ta provojë.

"Njeriu që ka dy gra në kurore dhe anon drejt njëres më shumë sesa tjetrës, në Ditën e Gjykimit do të vijë me njëren anë të trupit të paralizuar." (Profeti Muhamed a.s.)

Martesa me shumë gra në sistemin e vjetër Juridik Religjioz

Në të drejtën e vjetër egjiptiane e cila iu jepte më shumë të drejta grave, në krahasim me atë greko-romake, gruaja, nëse nuk i takonte klasës klerikale, në kushte të caktuara burri mund të merrte më shumë se një grua.¹

Në të drejtën e Babilonit, sipas ligjeve të Hamurabit, nëse gruaja nuk mund të lindë ose nëse lëngon nga ndonjë sëmundje e rëndë, burri mund të marrë robëreshë.²

Ndërsa në të drejtën kineze, burri mund të martohet me gra nga rendi i dytë, nëse e lejojnë kushtet financiare. Por, me kusht që fëmijët që do të lindin nga këto gra, të numërohen si fëmijë të vërtetë të gruas së parë.³ Te brahmanët e vjetër, sipas librit të Vishnus, burrat, sipas klasave që u takojnë, mund të marrin një, dy, tri ose katër gra. Ndërsa në librin Apastamba, vërehet një kufizim: nëse një grua i plotëson obligimet e veta dhe, nëse mund të lindë djalë, burri i saj nuk mund të martohet me një grua tjetër. E në të kundërtën, mund të martohet. Sipas rregullave Manu, një burrë duhet ta zgjedhë gruan e parë nga kasta e vet. Si grua të dytë mund të marrë një grua nga kasta më e ulët. Dhe në fund, sipas institucioneve të

Naradës, burri sipas kastave mund të martohet me një, dy ose tri gra. E sipas disa institucioneve edhe gruaja ka pas të drejtë që ndonjëherë të ketë më shumë burra.⁴

Edhe në Persinë e lashtë që aprovuar poligamia.⁵ Në të drejtën romake ekziston istifraşi që do të thotë - bashkëjetesa me një grua pa kurorëzim ligjor.⁶

Në Dhiatën e Vjetër theksohet se Daudi (a.s.) që martuar me disa gra.⁷ Kur shpjegohen dispozitat që bëjnë fjalë për ndarjen e pasurisë së babait midis fëmijëve nga dy gra, flitet në mënyrë normale, pa ndonjë farë turpi.⁸ Prandaj, nga kjo kuptohet se edhe te hebrenjtë kishte poligami.⁹

Në Dhiatën e Re nuk ekziston asnjë pasazh me anë të të cilit ndalohet martesa me më shumë se një grua. Por, këshillohet se “Një grua është e mjaftueshme për një njeri”. Martesa me më shumë gra në botën e krishterë, deri në shekullin XVI ishte gjë normale. Westermarck në veprën e tij historike këtë e thekson duke dhënë edhe shembuj. E dimë edhe atë se në botën e krishterë, bashkë me robërimin, ekzistonte edhe istifraşi.

Në siujdhesën arabike, ku lindi dhe u zgjerua Islami, nuk kishte

4. Po aty, f. 139, 141, 149, 165.

5. Po aty, f. 173, 175.

6. R. Honig, “Roma Hukuku”, f. 171, 175

7. Samueli, 2/12; 7/8.

8. “Libri i Ligjit të Përtërirë”, 21/15-17.

9. M. Es’ad, “Tarihu ilmi’l-Hukuk”, f. 193.

1. M. Es’ad, “Tarihu ilmi’l-Hukuk”, f. 44.

2. Po aty, f. 74.

3. Po aty, f. 97.

kurrfarë kufizimi lidhur me këtë. Ashtu siç burri ka mundur të marrë sa gra të dojë, po ashtu ka qenë e mundur edhe të këmbehen gratë midis burrave. Kanë ekzistuar edhe gra “të lehta” që llogariteshin si pronësi e përgjithshme.

Poligamia në Islam

Islami, me ajetin 3 të sures Nisa’, lejon të merret më shumë se një grua, në të cilin thuhet:

“Në qoftë se frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri a me katër. E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm me një, ose (martohuni) me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robëreshat). Ky (përkufizim) është më afër që të mos gaboni.” Në këtë ajet theksohet “nëse nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve.”

Lidhur me të, Aishja (r.anha) shpjegon: *“Bonjakja ndodhet nën kujdesin e zotërisë dhe ai dëshiron ta marrë atë me ndonjë mebr të thjeshtë, duke vënë merak në bukurinë dhe pasurinë e saj. Të këtillëve u ndalohet martesa me bonjaket, edhe nëse japin mebr të caktuar dhe nëse sillen në mënyrë të drejtë- u është urdhëruar të marrin gra të tjera përveç bonjakeve.”*¹⁰

Ndërsa Ibn Xherir et-Taberi thotë: Disa kanë thënë se domethënia e këtij ajeti është: “Ashtu siç frikësoheni nga pamundësia e plotësimeve të të drejtave ndaj

10. Buhari, v. VI, f. 116.

bonjakeve, në të njëjtën mënyrë duhet të frikësoheni nga prostitucioni me gratë. Mos bëni prostitucion, por nga gratë që u janë të lejuara merrni nga dy, tri ose katër.”

Edhe Sheukani përmend të njëjtën domethënie në tefsirin e tij “Fethu’l-kadir”.

Duket se martesa me më tepër se një grua, dy, tri e në fund katër nuk është ndonjë detyrim farz ose urdhër vaxhib, por është një leje në mënyrë që t’i iket prostitucionit. Por edhe kjo leje është kushtëzuar me mundësitë dhe drejtësinë. Ajeti na shpjegon se në bashkëshortësi është kryesore të mjaftohesh me një grua, duke theksuar se martesa me një grua është më afër plotësimit të të drejtave. Kështu, mund të japim një rezymë lidhur me poligaminë në Islam, para lindjes së të cilit, nuk pati ndonjë kufizim:

1. Përkufizimi i numrit. Është e lejuar martesa me katër gra më së shumti. Ajeti i lartpërmendur e shpreh këtë sipas specifikës së gjuhës arabe. Vërtetimi se martesa me më shumë se katër gra është e lejuar, duke u mbështetur në këtë ajet, është gabim, mosnjohje e gjuhës arabe. Pejgamberi a.s. i urdhëroi ata që u bënë myslimanë të rinj dhe kishin më shumë se katër gra, që të shkurorëzohen me ato mbi katër.¹¹

2. Drejtësia si kusht.

11. Ibn Kethir; “Fet’hu’l-kadir”; M. Z. El-Keutheri, “Makalatu’ el-Keutheri” f. 217; “El-Muakki’in”, v. IV, f. 343.

3. Urdhëroi që individi të mjaftohet vetëm me një, nëse nuk ka mundësi për drejtësi. Duhet pasur parasysh se këtu theksohet llogaria për drejtësinë midis grave si në ushqim, veshmbathje, strehim, në respektim, në dashuri e kështu me radhë. Le ta veçojmë pakëz vetëm dashurinë. A është e mundur që, të duhen në mënyrë të barabartë gratë e bukura dhe ato më pak të bukura, të rejat dhe ato më të vjetrat? Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë nuk ka drejtësi. E kur nuk ka drejtësi atëherë njeriu duhet të mjaftohet vetëm me një grua. E në këto kushte nuk krijohet poligamia.

Disa argumentojnë se, në Islam, është asgjësuar kjo leje, me qëllim që të pengohet poligamia. Por, ky është mendim i gabuar, meqë nyja është zgjidhur me ajetin ku flitet për poligaminë. Tani e tutje, njeriu që do të ketë më tepër se një, e më së shumti katër gra, do ta kryejë detyrimin ndaj shpirtit të vet, që s'varet nga ai, pas plotësimit të kushteve materiale siç është ushqimi, veshmbathja, strehimi e të tjera, madje edhe fjetjen me to:

“Ju kurrësi nuk do të mund ta mbani drejtësinë mes grave edhe nëse përpiqeni, pra mos anoni krejtësisht nga njëra e ta leni tjetrën të varur. E nëse përmirësoheni dhe i ruheni (padrejtësisë), Allahu ju fal dhe ju mëshiron.”¹²

Pejgamberi (a.s.) bënte drejtësi midis grave të tij, dhe thoshte kështu:

12. Nisa', 4:129.

*“O Zot, kjo është drejtësia që kam në duart e mia. Mos më merr si përgjegjës nga drejtësia që Ti ke e që unë nuk e zotëroj.”*¹³

Burri e respekton barazinë mes tyre në të gjitha sjelljet e veta, përveç në dashuri, sepse ajo nuk varet prej tij. Pejgamberi a.s. thotë: *“Njeriu që ka dy gra në kurorë dhe anon drejt njëres më shumë sesa tjetrës, në Ditën e Gjykimit do të vijë me njëren anë të trupit të paralizuar.”*¹⁴ Nëse njëra nga gratë nuk është myslimane, ajo gëzon të njëjtat të drejta si gratë e tjera.¹⁵

A ka nevojë për poligami?

Siç dihet, kurora në Islam mbështetet në qetësinë dhe paqen, dashurinë, simpatinë, ndershmërinë shpirtërore dhe në vazhdimësinë e gjeneratave, e jo vetëm në kënaqësinë seksuale. Pejgamberi (a.s.) për këtë temë, thekson: *“Martohuni, por mos shkurorezoni, meqë Allahu i Lartësuar nuk i do burrat dhe gratë që varen nga kënaqësitë (pasionet).”*¹⁶

Në këtë mënyrë ai e ndaloi përhapjen e martesës në favor të kënaqësive të ulëta. Atëherë, bie poshtë pohimi se gratë janë të robëruara kundrejt kënaqësive të burrave, duke pasur parasysh lejimin e poligamisë në Islam. E ritheksojmë se poligamia nuk është ndonjë gjë e

13. Mishkatu'l-mesabih, v. II, f. 196.

14. Po aty, v. II, f. 196.

15. Ibnu'l-Humam, “Fet'hu'l-kadir”, v. II, f. 517

16. Sujuti, “El-Xhamiu' es-sagir”, v. I, f. 448, 449.

urdhëruar, kryerja e së cilës është e domosdoshme si farz ose vaxhib, por është një mënyrë e ruajtjes nga prostitucioni dhe nga imoraliteti. Siç do të shpjegojmë më tutje, Islami mundohet t'i mbyllë rrugët për të rënë në prostitucion, kështu që parasheh dënime, madje edhe me vdekje.

Shkencëtarët e Islamit i radhisnin disa prej arsyeve pse poligamia do të ishte e nevojshme:

1) Kur gruaja të jetë e sëmurë nga impotenca që në lindje dhe të mos ketë ndjenja për marrëdhënie intime;

2) Të jetë e sëmurë, aq sa të mos ketë mundësi të plotësojë detyrimet bashkëshortore;

3) Kur nuk lind fëmijë. Shkurorëzimi do të sillte dëme dhe halle më të mëdha nga rimartesa. Gruaja që do të përjetonte këtë, nuk do të mund të martohej me të tjerë dhe do të shkatërrohej.

4) Gruaja kalon nëpër periudha të menstruacionit mesatarisht një javë në muaj, ndërsa pas secilës lindje, dyzet ditë lehon. Në këto periudha sipas Islamit, është haram të kryejë marrëdhënie seksuale. Veç kësaj, veçanërisht gjatë kohëve të fundit të shtatzënisë, shpeshherë nuk mund të plotësohen detyrimet ndaj bashkëshortit. E disa burra nuk janë të durueshëm, ndaj anojnë nga prostitucioni.

5) Aftësia seksuale e gruas dobësohet dhjetë deri në njëzet

vjet më herët në krahasim me atë të burrit. Ndërsa, sipas gjendjes familjare, gjatë kësaj kohe, mund të dëshirohet madje edhe fëmijë.

6) Mungesa e meshkujve për shkak të tragjeditive, kryesisht nga luftërat. Shembull më i mirë është Gjermania pas luftës së Dytë Botërore. Të gjithë e dimë gjendjen e mjerueshme të grave gjermane, madje edhe kërkesat e tyre për “importimin e burrave”. Faraoni në kohën e Musait a.s. i vriste bijtë e izraelitëve, ndërsa bijat e tyre i linte të jetojnë. Këtë mos-baraspeshim, Kur’ani e quan “torturë, dhimbje të madhe dhe shkatërrim.”¹⁷

Evropa, që e kundërshton me ashpërsi poligaminë në Islam, të gjitha këto domosdoshmëri përpiqet t'i mbulojë me një gjë: “mos-mbikëqyrjen e prostitucionit”. Prostitucioni, prostituta dhe fëmija jo legjitim, preferohen në vend të kurorës ligjore, gruas dhe fëmijës ligjor. Mirëpo, mendimtarët evropianë filluan të shikojnë drejt poligamisë në mënyrë pozitive, të cilën, e pranuan për shkak të çekuilibrit në numër mes grave dhe burrave, për ta ruajtur nga shkatërrimi jetën dhe pronat e burrave, si dhe duke pasur parasysh edhe shtimin e vrasjeve e të aborteve, me qëllim të pengimit të fëmijëve të paligjshëm.

Westermarck, në veprën e tij historike, thotë: “Poligamia, pas

17. Bekare, 2:49; Kasas, 28:4.

ndalimit në Perëndim, s'është shmangur nga praktsa. Më pastaj, a është sistemi më i përkryer dhe i fundit, ai në të cilin do të kënaqet njerëzimi vetëm me një grua?"

Përgjigjet janë të ndryshme. Sipas Herbert Spenserit, sistemi i fundit është monogamia.

Ndërsa sipas Lebonit: "...ligjet evropiane për një kohë të shkurtër do ta lejojnë poligaminë."

Prof. Ehrenfeli mendon se poligamia është e domosdoshme për shkak të ruajtjes së racës ariane. Shpjegim më të mirë lidhur me këtë çështje nxjerrim nga vepra e prof. Muhamed Hamidullahut:

"Monogamia, faktikisht, është dukuri më e rrallë në krahasim me bigaminë, që llogaritet si gabim i rrezikshëm dhe mosrespektim i ndalimeve dhe rregullave të shenjta. Përveç kohëve të fundit, kur u zhvillua në mënyrë të shpejtë kultura e Perëndimit, s'mund të gjendet një nocion ideal dhe parimor, kuptim që s'mund të shtrembërohet. Madje edhe në doktrinën e krishterë, asgjë s'është thënë që të japë argumente të një pasqyre të këtillë."¹⁸

"Askush nuk ka të drejtë të thotë se krishterimi është ai që e detyron botën e civilizuar të Perëndimit në monogami. Krishterimi nuk e ka ndaluar haptazi poligaminë, veç kryepeshkopëve dhe gjakonëve (Timotheu 3/2,12)..."

18. Shikoni "Encyclopedia Britannica" me titull "Marriage" dhe "Polygami".

Asnjë nga koncilët e krishterë nuk e kundërshtuan poligaminë; nuk u pengua që kjo të vazhdojë as nga mbretërit, aty ku ekzistonte poligamia në kohën e idhujtarisë. Në mes të shekullit të VI mbreti i Irlandës Diarmait, kishte dy mbretëresha dhe dy robëresha. (D'Arbois de Jubainville, VI, 292). Poligamia është vënë në praksë pa kurrfarë pengesash gjatë kohës së mbretërisë së Merovingienit. Karli i Madh kishte dy mbretëresha dhe shumë robëresha, e njëri ndër ligjet e tij theksonte se poligamia nuk është e panjohur për murgjit¹⁹. Më vonë Filipe de Hesse dhe Frederic - Guillaume de Prusse nga sekta luterian marrin nga dy gra me lejen e murgjive.²⁰ Lutheri personalisht ia lejoi bigaminë të lartpërmendurit. Të njëjtën gjë e bëri edhe Melanchetoni.²¹ Shumë herë Lutheri vetë personalisht, fliste për poligaminë me një tolerancë të madhe: "Kjo (poligamia) s'është e ndaluar nga Zoti... Nuk ka dyshim se poligamia preferohet në vend të shkurorëzimit."²² Më 1650

19. Thierry, "Narratives of the Merovingian Era", f. 17 dhe vazhdimi; Hellwald, "Die Menshilche Familie", f. 558 I.; Hallam, "Europe During the Middle Ages" I, f. 420, n. 2.

20. Friedberg, "Lehrbuch des kath, u evang Kirchenrecht", 436, n. 2 paragrafi 143.

21. Koestlin, Martin Luther, II, 475 dhe vazhdimi.

22. E njëjta vepër, V. I, 137; v. II, f. 693 dhe vazhdimi.

pas marrëveshjes së Westfalisë, Parlamenti Ushtarak i Frankonit (Kriegstag) lëshoi vendim, që prej atëherë, çdo burrë mund të marrë nga dy gra, si preventivë kundër zvogëlimit të popullatës, pas luftimeve tridhjetëvjeçare.²³ Disa sekte të krishtera luftuan shumë për poligaminë. Më 1531, në Munster anabaptistët bënë përpjekje duke dashur që, në mënyrë të hapët, ta zgjerojnë poligaminë dhe thanë se i krishteri i vërtetë duhet të ketë shumë gra.²⁴ Dhe, siç e dimë, Mormonët e shikonin poligaminë si një institucion hyjnor.²⁵

Në njoftimin e princit gjerman Philippe de Hesse, që ia dërgoi teologut Marthin Bucer, lidhur me ca pyetje që i kërkoji t'ua parashtrihen shkencëtarëve të tjerë fetarë (Martin Lutherit dhe Filippe Melancheton), shënohet “(Paragrafi i X): “E di se Luteri dhe Melancheton e kanë këshilluar mbretin anglez që të martohet me një grua tjetër para se të ndahet prej së parës.”^{26, 27}

Gruas së parë në poligami, do t'i lëndohet krenaria. Do të ndjejë xheloz

dhe brenja për shkak të martesës së burrit të saj me një grua tjetër. Por, nga ana tjetër, në martesën jo ligjore që i takon jetës së prostitucionit me dashnore, ekzistojnë edhe rreziqe të tjera: humbja e nderit të burrit që hyn në prostitucion dhe të gruas së tij, dëmin që do të pësojë gruaja e një burri të tillë, për shkak të jetës së përbashkët me një njeri të pandershëm, dhe mundësia që burri të ndjekë rrugë të këqija, si dhe dëmi, që ai do të pësojë në këtë mënyrë. Nga ana tjetër edhe burri i asaj gruaje, me të cilën ky i fundit kryen prostitucion, dëmtohet nga marrëdhënia e tyre... Nga të gjitha këto marrëdhënie jo ligjore shfaqen fatalitete shoqërore si mbytja e fëmijëve, shtimi i sëmundjeve veneriane dhe armiqësia midis palëve... Duket se kur ndalohet poligamia, megjithëse ekziston nevoja dhe domosdoshmëria për të, tragjeditë pasojnë njëra-tjetrën, e vijnë deri aty ku “mbushet kupa”.

Të përkujtojmë se në të drejtën islame, gruaja ka të drejtë të kërkojë që burri të mos i martohet me një grua tjetër, për aq kohë sa është e lidhur në kurorë me të. Pas aktit që do të kryhet në mënyrë ligjore, marrëveshja që do të bëhet do të aktive, dhe nëse ajo e ndalon burrin të martohet rishtas, e ndërkohë ai martohet, gruas së parë i lind e drejta e shkurorëzimit. Në një hadith thuhet: “*Kushti që më së shumti meriton ta plotësoni është ai që e keni pranuar gjatë kurorëzimit.*”²⁸

28. Buhari, v. VI, f. 138; Ibnu'l-Humam,

23. Helvalld, f. 559 dhe vazhdimi.

24. Vepra e njëjtë, v. I, f. 558.

25. Westermarck, III, 50-51.

26. J. P. Bossuet, “Histoire des variations des Eglises protestantes”, Libri i VI, prej vitit 1537 deri në vitin 1546: Oeuvres complètes de Bossuet nouvelle. Bar-le-Duc 1877, v. III, f. 233-250, veçanërisht f. 244. Shikoni “Dictionnaires de la Bible” F. Vigoreux. Paris, 1912, materia Poligamia, v. IV, f. 513.

27. Muhammed Hamidullah, “Islam'a Giris”, v. I, f. 139.

Në këtë rast, gruaja, në poligami do të ketë të drejtë vote. Do të eliminohen dëmet shpirtërore që i takojnë. Në shumë vende të botës zyrtarisht nuk ekziston poligamia. Por, faktikisht ajo vazhdon të përhapet. Për këtë arsye, kohë pas

“Fet’hu’l-kadir”, v. II, f. 458; “I’lamu’l-Muakki’in”, v. II, f. 335; “Islam’a Giris”, f. 140; ‘Ömer Nasuhi Bilmen, “Hukuk-i Islamiye ve Istilahat-i Fikhiyye Ka’musu”, v. II, f. 38-40, 120.

kohe sillen ligje të ndryshme që të përcaktohet origjina e fëmijëve sipas sistemit juridik.

Në fund, mund të thuhet se Feja Islame e ka aprovuar poligaminë për shkak të disa domosdoshmërive. Nëse njerëzia ende nuk e di dobinë e poligamisë dhe nuk e aprovon atë, s’mund të thuhet se një ditë, pas përvojave të ndryshme, nuk do ta aprovojë.

Ndikimi i reformizmit dhe iluminizmit te Hafiz Ali Korça

Dr. Azmir Jusufi

Abstrakt

Rrethana të caktuara janë një faktor vendimtar në formimin e personaliteteve të shquara, roli dhe rëndësia e të cilëve është e pamohueshme dhe puna e tyre është universale. Elemente të tilla gjenden në librat e historisë së të gjitha kombeve, faqet e të cilëve janë plot me figura të rëndësishme që shënojnë një epokë të caktuar si: patriotë, heronj, kolosë dhe reformatorë.

Fryma reformiste dhe ndryshimi i ndërgjegjes fillon me revolucionin mendor të një individ apo një grupi që përpiqet të ngrejë vetëdijen e shoqërisë së tij. I njëjti mendim duhet të frymëzohet, sepse frymëzimi është shpirtësi shpirtëror i njeriut, ndërsa shpirti reformues ushqehet me bindje ideologjike, artistike dhe fetare.

Hafiz Ali Korça, aktivitetin e tij intelektual e zgjeroi, përveç atij në fushën e alfabetit shqip, edhe në një fushë tjetër, kur u emërua anëtar i "Komisionit Letrar", ku së bashku me veteranët: Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Mati Logoreci e Sali Nivica, veproi me përkushtim në fushën e gjuhësisë. Në këtë Komision, kontributi i Hafiz Aliut për pastërtinë e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja, është i pamohueshëm.

Pikëpamjet e tij politike, arsimore-edukative janë rezultat i natyrshëm i Lëvizjes Kombëtare, që ndihej nga mesi i shek. XIX, dhe që mori përmasa më të mëdha në vitet '20-30 të shek. XX.

Hyrje

Rrethana të caktuara janë një faktor vendimtar në formimin e personaliteteve të shquara, roli dhe rëndësia e të cilëve është e

pamohueshme dhe puna e tyre është universale. Elemente të tilla gjenden në librat e historisë së të gjitha kombeve, faqet e të cilëve janë plot me figura të rëndësishme që shënojnë një epokë të caktuar

si: patriotë, heronj, kolosë dhe reformatorë.

Fryma reformiste dhe ndryshimi i ndërgjegjes fillon me revolucionin mendor të një individi apo një grupi që përpiket të ngrejë vetëdijen e shoqërisë së tij. I njëjti mendim duhet të frymëzohet, sepse frymëzimi është shtytësi shpirtëror i njeriut, ndërsa shpirti reformues ushqehet me bindje ideologjike, artistike dhe fetare.

Jehona e mendimit fetar reformist që vinte nga Lindja Arabe, gjegjësisht nga Egjipti, kishte depërtuar në tërë botën islame, si p.sh., në Indi, Turqi, Rusi dhe veçanërisht në Kaukaz. Edhe fati i tokave shqiptare dhe atyre boshnjake nuk ishte më i vogël se sa ai i botës islame.

Meqë Universiteti i Ez'herit ishte qendër e mësimave dhe edukimit në të gjitha fushat shkencore, të rinjtë shqiptarë drejtoheshin drejt tij për të mësuar shkenca të ndryshme, dhe në këtë mënyrë u formuan marrëdhënie vëllazërore fetare mes dijetarëve të Ez'herit dhe studentëve shqiptarë. Shumë studentë shqiptarë më vonë u bënë dijetarë të njohur, me autoritet dhe të suksesshëm për kohën.

Ashtu si natyra rilind në fillim të pranverës dhe sjell gjallëri e jetë, ashtu edhe Ali Korça lulëzoi me idetë e tij kur populli i tij kishte më shumë nevojë për një njeri të tillë, pikërisht në kohën e rilindjes shqiptare.

Reformizmi dhe përtëritja e mendimit islam

Nëse bëhet një rezyme e ideve dhe fjalëve të Hafiz Ismet Dibrës në lidhje me reformizmin dhe përtëritjet e mendimit islam, do të arrijmë te konkluzioni se ai mendonte se Islami nuk kundërshton progresin shkencor dhe sfidat e kohës si dhe pranon reformat në disa çështje për të cilat flasin edhe hadithet e Pejgamberit a.s., përkatësisht për çështje që kanë natyrë dhe karakteristikë specifike e të pranojnë të reformohen, ndërsa parimet fetare dhe bazat e besimit nuk mund të reformohen kurrë, ngase në këtë mënyrë shkatërrohet feja që nga themeli i saj.¹

Çështja e gruas myslimane dhe pozita e saj shoqërore

Ndër çështjet politike në të cilat ishin përqendruar reformistët, ishte edhe çështja e gruas myslimane dhe pozita e saj shoqërore², e cila, në krahasim me gruan perëndimore, ishte e prapambetur, regresive dhe jetonte e mbyllur në prangat e traditës. Asaj nuk i lejohej të merrej me aktivitete politike e as me ato shoqërore, etj. Ide të tilla reformiste ndikuan dukshëm në mendimet dhe idetë e shqiptarëve që mësonin dhe studionin në Egjipt, Turqi dhe

1. Mbi polemikat e tilla shih më gjerësisht: Ali M. Basha, *Islami në Shqipëri gjatë shekujve*, f. 140-141.

2. Shih: Gazmend Shpuza, *Kuvendime për historinë kombëtare*, f. 231-236, 237-242.

Indi, që njëherazi konsideroheshin qendra ndërkombëtare të diturisë dhe kulturës, andaj, kur u kthyen në vendlindje, erdhën me idetë reformiste e ripërtëritëse.³

Sipas disa burimeve historike është zhvilluar një debat i gjatë dhe i ashpër mes mendimtarit dhe studiuesit shqiptar, Mehdi Frashëri dhe Hafiz Ismet Dibrës. Mendimtari shqiptar Mehdi Frashëri kishte botuar një varg artikujsh në disa gazeta shqiptare rreth reformave që mund të zhvillohen në fenë islame. Këto artikuj bënë që Hafiz Ismet Dibra të reagojë në revistën islame mujore, “Zani i Naltë”. Kjo revistë përfshinte në vete artikuj dhe mendime të tilla, dhe për këtë shkak gëzonte autoritet dhe pozitë të lartë te myslimanët dhe njerëzit në përgjithësi.

Çështja e femrës kishte marrë jehonë të madhe mes dijetarëve dhe mendimtarëve shqiptarë, ashtu siç kishte marrë jehonë edhe në mesin e mendimtarëve dhe dijetarëve arabë, posaçërisht polemikat rreth emancipimit dhe mbulesës së fytyrës e të duarve të femrës. Arsyeja kryesore që i shtyu dijetarët myslimanë të diskutojnë rreth kësaj çështjeje, ishte fakti se disa shkrimtarë laikë shqiptarë kishin shkruar një artikull historik ku thuhej se perçja i takonte historisë shqiptare të krishterë, gjegjësisht

periudhës së murgeshave të virgjëra e beqare të kohës së mbretëreshës së krishterë, Katerina de Medici, si dhe kohës së vejushave të krishtera, të cilat e mbulonin fytyrën për nder të burrave të tyre. Autori i artikullit më tej vazhdon e thotë se perçja apo mbulesa e fytyrës nuk ka ekzistuar për gratë myslimane në periudhën e parë të Islamit. Në Bagdad dhe në Kordobë kishte mësuese dhe dijetare femra që merreshin me arsim e që i kishin fytyrat e zbuluara.⁴

Çështja e zëvendësimit të alfabetit shqiptar me shkronja latine

Çështja tjetër që kishte pësuar ndryshime ishte përpjekja e parlamentarëve për ta penguar alfabetin arab në shkrimet shqipe dhe zëvendësimin e tij me alfabetin latin. Në vitin 1929 u organizua një konferencë e madhe në Shqipëri, ku u takuan dijetarë të mëdhenj sunitë dhe morën disa vendime që ishin të vështira, por të pranuar nga mbretëria e Mbretit Ahmet Zogu. Në atë konferencë u vendos që arabishtja të përdoret vetëm në ligjërata, vaze, lutje e derse, të gjitha shkollat fetare dhe qendrat edukative të jenë nën kontrollin e mbretërisë shqiptare dhe të mbyllen shumica e xhamive të mëdha, përveç dy ose tri xhamive në çdo qytet.

3. Hajredin Hoxha, *Doktrinat e tefsirit në trojet shqiptare*, Shkup, 2010, f. 85.

4. Ali M. Basha, *Islami në Shqipëri gjatë shekujve*, f. 142-143.

Erërat e doktrinës reformiste fetare frynin në të gjitha sferat e jetës fetare, kulturore dhe shkencore shqiptare. Ndër çështjet tredimensionale (shkencore, kulturore dhe fetare) ishte edhe çështja e vazhdimit të alfabetit arab ose zëvendësimi i tij me alfabetin latin. Dobësimi i shtetit osman arriti kulmin aty nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX. Krerët e rezistencës kundër shtetit osman filluan të paraqiten aty këtu nga vetë turqit dhe nga kombet e tjera. Historikisht është vërtetuar se mësimi dhe shkrimi i alfabetit shqip ishte i ndaluar shekuj me radhë nga shteti osman, përderisa ishte i lejuar për pakicat e tjera hebraike, serbe, greke, kurde. Ndoshta një gjë e tillë ka ndodhur nga arsyeja se shteti osman i konsideronte të gjithë myslimanët si një popull, edhe pse dalloheshin në gjuhë e komb, dhe se gjuha e tyre duhet të jetë vetëm gjuha e shtetit osman.⁵

5. Sipas prof. dr. Behaaddin Muhammed Husejn, nëse osmanlinjtë vërtetë i konsideronin myslimanët një popull, atëherë do të duhej t'i mësonin arabisht e jo turqisht, ngase arabishtja është gjuhë e Kur'anit dhe Sunetit të Pejgamberit a.s., si dhe gjuhë e halifatit të Hulefai-rashidinëve dhe të Abasidëve. Sipas tij, elementi nacionalist ka ndikuar që osmanlinjtë dhe turqit t'ua ndalojnë popujve të tjerë përdorimin e gjuhëve të tyre dhe t'ua mësojnë turqishten, dhe ky fenomen sipas tij, konsiderohet thyerje e të drejtave të tyre në mënyrë shumë të vrazhdë. Shih në: Hajredin Hoxha, *Doktrinat e tefsirit në trojet shqiptare*, f. 94.

Shkaku që shteti osman nuk i kishte miratuar kërkesat e shqiptarëve rreth çështjes së alfabetit, ishte edhe frika nga kryengritja dhe rebelimi i tyre, sepse pas kërkesave të tyre fshihej synimi për pavarësi të plotë dhe përfundimtare nga shteti osman.

Në një nga mitingjet e organizuara rreth futjes së shkronjave latine, Hafiz Ali Korça në fjalimin e tij, ndër të tjera, kishte thënë: "... Shkronjat shqipe që kemi pranuar, janë vegla me të cilat shkruhet kjo gjuhë, por, kjo nuk do të thotë se ne i urrejmë shkronjat arabe me të cilat e mësojmë Kur'anin... Shkronjat e një gjuhe nuk kanë të bëjnë as me fenë as me halifenë. Shkronjat janë vegla: S'janë as mu'min as qafir..."⁶

Kjo frikë dhe droje e kishte shtyrë Shejhul-islamit që më 22 mars 1920, të dilte me një fetva të prerë, ku kategorikisht ndalonte përdorimin e alfabetit latin, dhe pas pak kohe filloi procedura e mbylljes së shkollave shqipe. Mirëpo, këto orvatje të shtetit osman nuk zgjatën shumë, kështu që, befasisht, Ministria e Punëve të Brendshme të shtetit osman, lëshoi vendimin me të cilin lejohej hapja e të gjitha shkollave që ishin mbyllur, madje lejohej edhe hapja e shkollave të reja.

Zërat pro reformimit shoqëror dhe fetar në trurin e shqiptarëve

(fusnota 240).

6. Ismail Ahmedi, *Hafiz Ali Korça – Jeta dhe vepra*, f. 51. Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, f. 89.

filluan të dëgjohen më zhurmshëm në fillim të shekullit XX. Në këtë kohë kishte filluar të përhapet e t'i përforcojë rrënjët e veta edhe ideologjia komuniste në tërë territorin shqiptar.⁷

Mirëpo, nga një ngjarje të cilën e shënon vetë Hafiz Ali Korça në librin e tij “Shtatë ëndrrat e Shqipërisë”, ai si personalitet dhe mendimet e tij për kërkimin e së drejtës për mësim dhe shkrim në gjuhën amtare, nuk do të thotë se ka qenë i prirur kundër shtetit Osman, gjuhës turke apo arabe. Këtë e kuptojmë nga ngjarja e radhës, ku në një takim, pasi disa intelektualë kishin mbajtur fjalime, i vjen radha që të mbajë fjalim edhe Hafiz Ali Korçës, dhe ky, pasi e përfundoi fjalimin, i lutet Zotit të Madhërisëm në tri gjuhë: në arabisht, turqisht dhe shqip, pastaj e falënderon Zotit për të mirat që ia ka dhënë dhe për krijimin e popujve të ndryshëm, që flasin gjuhë e dialekte të ndryshme, dhe më tej vazhdon duke thënë se kjo nuk nënkupton që ne ta urrejmë arabishten, ngase në gjuhën arabe mësojmë Kur'anin, por pasi që me ligjin e ri të Turqisë të shpallur në vitin 1908, lejohet një gjë e tillë, atëherë edhe ne me padurim dhe me gëzim të madh do ta mësojnë gjuhën tonë amtare dhe alfabetin, dhe nuk ka asnjë forcë që mund të na pengojë në këtë çështje.⁸

7. Hajredin Hoxha, *op. cit.*, f. 91-92.

8. Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*,

Talat Pasha kërkoi nga Hafiz Ali Korça që të shkruante një artikull në gjuhën shqipe, po me alfabetin arab, dhe për këtë i premtonte postin e kadiut në Bejrut. Hafiz Aliu nuk e pranoi këtë ofertë, ashtu sikurse nuk pranoi akuzën se me shkronjat latine bënin gjynah ndaj Kur'anit. Talat Pasha iu kërcënua se Shqipëria përmes shkronjave do të ndahet nga Turqia, por këtë nuk do ta arrijë kurrë...⁹

Pas kësaj pushteti osman fillon ta akuzojë Hafiz Ali Korçën si latinxhi, përkatësisht si hoxhë perëndimor, apo me mendime *vesterniane*, në kuptimin e sotshëm, ngase në raport me alfabetin arab, sipas tyre, Hafizi preferonte alfabetin latin. Për këto qëndrime të tij, ai kërcënohej me dënim dhe internim, por ai shumë herë, nuk hezitonte t'ua sqaronte faktin se çdo gjuhë ka karakteristikat dhe rregullat e veta, dhe meqë gjuha shqipe është gjuhë indo evropiane, atëherë edhe ajo duhet t'i ketë karakteristikat e veta, dhe kjo gjë nuk ka të bëjë fare me rrëzimin e kalifatit apo me distancimin nga ai. Shkronjat e gjuhës janë instrument shkrimi, nuk janë as besimtarë e as jobesimtarë, ashtu sikurse nuk mund të trajtohen as si myslimanë e as si jomyslimanë.¹⁰

Shtypshkronja e shtetit, II, 1944, 25-60.

9. Ismail Ahmedi, *Hafiz Ali Korça – Jeta dhe vepra*, f. 61.

10. Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, f. 25-60.

Sipas mendimit të prof. dr. hfz. Hajredin Hoxhës, kolonializmi perëndimor evropian dhe sllav ishte ai që i nxitte intelektualët të ringjallin idenë e alfabetit latin, si hap i parë për shkatërrimin e Islamit dhe devijimin e Kur'anit, duke u përqendruar në përdorimin e dialekteve në vend të gjuhës letrare, dhe një gjë e tillë vërehet mjaft qartë, në shkrimet e hershme dhe të mëvonshme të disa orientalistëve bashkëkohorë.¹¹ Pra, siç vërehet, qëndrimi i studiuesit dallohet nga mendimi i intelektualëve për futjen e alfabetit latin në përdorim, pra edhe mendimit të vetë Hafiz Ali Korçës, alfabeti arab, i cili, njëherazi, ishte alfabeti i Kur'anit Fisnik dhe haditheve të Pejgamberit a.s., përveç kësaj, me plot të drejtë shtrohet pyetja se çfarë e dëmtoi Japoninë, Kinën, Tajvanin, Korenë dhe shtetet e tjera në rrugën e tyre drejt progresit dhe zhvillimit industrial e teknologjik, kur dihet se këto shtete akoma sot e kësaj dite vazhdojnë të përdorin alfabet interesant që ka simbole të posaçme dhe një intonacion që i ngjan alfabetit arab?! Prandaj, sipas mendimit të dr. Hajredin Hoxhës, pa marrë parasysh se çfarë forme ka alfabeti, ai nuk mund ta pengojë kurrësi progresin, por në fakt ekzistojnë faktorë të tjerë konkretë dhe abstraktë që çojnë popujt kah progresi dhe përparimi ose kah prapambetja dhe regresi.¹²

11. Hajredin Hoxha, *ve. cit.*, f. 124-125.

12. Shih në: Hajredin Hoxha, *ve. cit.*, f. 124-

Kontributi për alfabetin e gjuhës shqipe

Hafiz Ali Korça, çështjen e alfabetit dhe të shkollës shqipe, e shtroi në Kongresin e Dibrës më 23-29 korrik 1909. Roli i këtij personaliteti në këtë Kuvend ka rëndësi historike, për problemet arsimore dhe kulturore që paraqiti para delegatëve, të cilët u pajtuan dhe i përkrahën në tërësi.¹³

Dr. Ismail Ahmedi, me plot të drejtë, i jep një vend mjaft parësor pjesëmarrjes së Hafiz Ali Korçës në Kongresin e Dibrës, në një kongres ku kishte mbi 300 delegatë nivelesh dhe përcaktimesh të ndryshme, personalitete deri atëherë të formuara dhe shumë të afirmuara në çështjen kombëtare e kulturore rreth çështjes së alfabetit të gjuhës shqipe.

Lidhur me këtë me të drejtë konstatohet se ai ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në kahen që mori puna e Kongresit e veçmas në vendimet suplementare që dolën nga ky Kongres, të cilat u arritën vetëm në saje të diskutimeve të fuqishme dhe të argumentuara të Hafiz Ali Korçës. Dhe pikërisht këto diskutime ndikuan te pjesëmarrësit që të marrin edhe vendime suplementare, që i dhanë Kongresit kahen e kundërt nga ajo që dëshironin organizatorët e tij apo politika aktuale xhonturke,

125.

13. Konferencë shkencore ndërkombëtare, *Hafiz Ali Korça – 55 vjet pas (1873-1956)*, Korçë, Shqipëri, 2011, f. 31.

që ishte bërë fuqi e përshtatshme politike e Turqisë.

Në Kongres u formuan dy grupe delegatësh: Ata që përkrahnin organizatorët e Kongresit, pra politikën xhonturke, që kërkonte të shfuqizohen vendimet e Kongresit të Manastirit, që gjuha shqipe të shkruhej me alfabet latin dhe të pranohet vetëm alfabeti arab për shkrimin e shqipes, që ishte një numër fare i vogël i tyre, dhe në ata që përkrahnin vendimet e Kongresit të Manastirit që gjuha shqipe të shkruhej ekskluzivisht me alfabetin latin.¹⁴

Përrjashtim i alfabetit arab për gjuhën shqipe, shkaktoi reagimin e qeverisë xhonturke. Ajo filloi një fushatë të gjerë kundër shkronjave latine. Autoritetet qeveritare u përpoqën në forma të ndryshme të bindnin shqiptarët që të heqin dorë nga këto shkronja.¹⁵

Si kundërpërgjigje ndaj Kongresit të Manastirit dhe përhapjes së shkrimit latin, qeveria xhonturke organizoi Kongresin e Dibrës, siç përmendëm më sipër, me anë të të cilit synonte të dëshmonte përpara opinionit ndërkombëtar se të gjithë myslimanët e Perandorisë ishin osmanlinj.¹⁶

14. Dr. Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare* 2, Studime dhe recepsione, Shkup, 2000, f. 129-130.

15. Konferencë shkencore ndërkombëtare, *Hafiz Ali Korça – 55 vjet pas (1873-1956)*, ve. cit., f. 119.

16. Po aty, f. 119.

Krahas kësaj, në vitet 1909-1910, me nxitjen e autoriteteve osmane, disa myslimanë organizuan mitingje kundër përdorimit të shkronjave latine në gjuhën shqipe. Nëpërmjet një telegrami që myderrizi i Manastirit i dërgonte atij të Korçës, e njoftonte këtë të fundit për mitingjet e zhvilluara në Manastir dhe Shkup. Myderrizi i Manastirit kërkonte nga kolegu i tij në Korçë që edhe në qytete të tjera shqiptare të organizoheshin mitingje të tilla.

Për ta detyruar të hiqte dorë nga alfabeti shqip, autoritetet osmane ushtruan një presion të madh mbi Hafiz Ali Korçën. Ata nxitën elementet fanatike myslimane të hidhnin gurë mbi shtëpinë e tij. Ky presion vazhdoi për 6-7 muaj, por ai kurrë nuk u dorëzua.¹⁷

Hapja e shkollave normale

Në këto vendime suplementare thuhet se kudo që flitet shqip duhet të hapen edhe shkollat shqipe, madje kërkesa e Hafiz Ali Korçës ishte që të hapen shkolla profesionale, shkolla normale dhe një fakultet. Për këto propozime të Hafiz Aliut ishin një numër i madh i delegatëve dhe prandaj u pranua të hyjnë në vendimet suplementare. Meqë vendimet suplementare në tërësi ishin të konceptuara nga Hafiz Aliu, lajmi u përhap edhe në qarqet qeveritare turke. Për këtë dukuri, dr.

17. Shih në librin e Hafiz Ali Korçës, *Shtat ëndrrat e Shqipërisë*, f. 50, 65.

Ismail Ahmedi ka hulumtuar edhe gazetatat turke të kohës që shkruanin për rrezikun që i kërcënohej politikës qeveritare xhonturke, të cilat nuk ngurruan të kërkojnë që organizatori ta ndërpresë punën e Kongresit dhe ta arrestojë organizatorin e këtyre plotësimeve të vendimeve, Hafiz Ali Korçën. Kongresi nuk i ndërpreu punimet në sajë të reagimit të opinionit dibran që u mblodh rreth ndërtesës së Kongresit, as vendimet suplementare nuk u anuluan, por ndaj Hafiz Ali Korçës u morën masat më të rrepta në stilin “shtrëngo e liro” që ta frikësojnë që të heqë dorë nga kërkesa për përdorimin e alfabetit latin për shkrimin e gjuhës shqipe.¹⁸

Hafiz Ali Korça, aktivitetin e tij intelektual e zgjeroi edhe në një fushë tjetër, kur u emërua anëtar i “Komisijës Letrare”, ku së bashku me veteranët: Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Mati Logoreci e Sali Nivica, veproi me përkushtim në fushën e gjuhësisë. Në këtë Komision, kontributi i Hafiz Aliut për pastërtinë e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja, është i pamohueshëm.

Pikëpamjet e tij politike, arsimore-edukative janë rezultat i natyrshëm i Lëvizjes Kombëtare, që ndihej nga mesi i shek. XIX, dhe që mori përmasa më të mëdha në vitet ‘20-30 të shek. XX.¹⁹

18. Dr. Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare 2*, op. cit., f. 130.

19. Konferencë shkencore ndërkombëtare,

Hapja e medresesë së Tiranës dhe reformat arsimore në të

Shekulli i fundit i Perandorisë Osmane ishte i mbushur me sfida të mëdha, të cilat ishin kryesisht në fushat politike dhe ekonomike.

Mirëpo kjo gjë reflektonte në të gjitha fushat dhe shtresat shoqërore. Njëra nga këto fusha ishte dhe fusha e arsimit fetar në të gjithë perandorinë. Mejtepet dhe medresetë, tanimë, nuk po luanin rolin që kishin luajtur dikur, ku nxirrnin kuadro të zotë si në fushën fetare ashtu edhe në atë shkencore e shoqërore. Ndër shkaqet më kryesore që çoi në rënien e këtyre medreseve ishte mos reformimi i procesit arsimor sipas nevojave të vendit dhe kohës, si dhe metodat e vjetra dhe jo të përshtatshme të mësimdhënies dhe edukimit fetar.

Në të kaluarën këto medrese, krahas arsimimit fetar, zhvillonin edhe mësimdhënie të lëndëve shkencore. Kjo bënte që shumë nxënës të zgjuar të zgjidhnin këto shkolla dhe krahas hoxhallarëve të dilnin edhe shkencëtarë të mirëfilltë. Ndërsa heqja e këtyre lëndëve nga programi mësimor bëri që të binte interesimi për këto medrese. Si rezultat shumë nxënës të zgjuar zgjidhnin shkollat moderne ku mungonte arsimimi fetar. Ky fenomen bëri që të bijë sukcesi i këtyre shkollave dhe të mos kryhej funksioni që kishin...²⁰

Hafiz Ali Korça – 55 vjet pas (1873-1956), op. cit., f. 32.

20. <https://www.islamgjakova.net/artikulli>.

Në një letër të hapur që u kishte dërguar Hafiz Aliu ulemasë shqiptare, ndër të tjera u thotë: “Në qoftë se medresetë nuk do t’i pajosim si lipset, edhe në qoftë se myslimanët pasunike do të kursejnë të hollat ahëre t’a dimë bukur se medreset që sodit pa na thonë lam t’u mirë, edhe padyshim ashtu edhe feja myslimane që prej tashti po na thotë ‘El-veda...’”.²¹ Dhe u thotë më tej: “Na Shqiptarët po nuk përgatitëm për çdo katund nga një alim i cili fare pak të ketë vazhdu në medreset (5) vjet q’aty të bëjë imamët e hatibet edhe të mësojë dhe çunat si pas nevojës të kohës dhe po nuk qitëm për çdo qytet fare pak nga dhjetë Fahrudina, nuk mundim me mbajte as fe as Shtet...”.²²

Më 1924 në nivelin e gjimnazit klasik e teologjik, me personel tërësisht shqiptar u themelua Medreseja e Përgjithshme e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Tiranë. U hap në bazë të vendimit Nr. 105/1 dhe Nr. 125/2 të Qeverisë Shqiptare dhe u organizua në përputhje me artikullin 60 të Statutit të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Hapat e parë të medresesë në Tiranë u bënë në disa rrethana të veçanta historike, që po kalonte shoqëria shqiptare në atë kohë. Më 1931 në gjirin e Komunitetit

Mysliman ishte krijuar dega kulturore, e cila që miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më 20.07.1931 dhe firmosur nga K/Ministri Pandeli Vangjeli dhe ministrat H. Mosi, M. Tutulani, etj.

Më 1931 përfunduan punimet e ndërtesës së re të Medresesë së Përgjithshme në Tiranë. Ky që një shtet për tërë botën shqiptare. Mehdi Frashëri, një nga politikanët dhe sociologët e shquar shqiptarë, në fjalën e përshëndetjes, tha: “Përparimi i vrullshëm për ne shqiptarët është një nevojë e jetës, se për të mjeruarit në këtë botë s’ka mëshirë. Mëshira mund të jetë personale, por jo midis popujve, d.m.th. se s’është internacionale.”²³

Gjatë viteve 1918-1924 Hafiz Ali Korça ishte në krye të këshillit të Sheriatit në Tiranë. Derisa qëndroi në këtë funksion, ai ndërmoi një varg hapash të rëndësishme. Së pari hapi Medresenë e Tiranës dhe po aty që mësimdhënësi i parë.²⁴ Kërkoji po ashtu, zbatimin e planeve dhe programeve mësimore bashkëkohore

23. Dr. Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, Instituti Shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, Tiranë, 2007, f. 117.

24. Sipas prof. Hajrullah Koliqit, Hafiz Ali Korça në Medresenë e Tiranës punoi deri në vitin 1949, kur pushteti komunist e internoi në Kavajë, ku edhe vdiq në vitin 1956. Në Medrese ai jepte gjuhën arabe dhe logjikën. Shih në: Konferencë shkencore ndërkombëtare, *Hafiz Ali Korça – 55 vjet pas (1873-1956)*, ve. cit., f. 127 (fushnota nr. 78).

php?id=560, shikuar më: 26.11.2018.

21. Hafiz Ali Korça, *Publicistikë dhe shkrime të tjera*, Vepra 12, Logos-A, Shkup, 2006, f. 64.

22. Po aty, f. 69.

në të gjitha medresetë e Shqipërisë, hartues i të cilave ishte vetë. Në këtë frymë, ai hartoi një numër tekstesh shkollore për shkollën shqipe.²⁵

Njëra ndër pikat e dobëta ku Hafiz Ali Korça ngulmonte më shumë ishte mësimdhënia dhe metodat e mëimit të gjuhës arabe. Kjo gjuhë për shekuj kishte qenë gjuha e qytetërimit dhe urë lidhja midis popujve myslimanë. Kështu që çelësi për të arritur thesaret klasike të qytetërimit islam ishte gjuha arabe. Mirëpo medresetë që kishin për detyrë të mësonin këto gjuhë studentëve të rinj, nuk po e kryenin si duhet funksionin. Sipas Hafiz Ali Korçës arsyeja kryesore ishte metoda e gabuar e mësimdhënies së gjuhës arabe. Me gjithë kohëzgjatjen prej dhjetë vjetësh, përsëri nxënësit që diplomoheshin nga këto medrese nuk arrinin të përvetësonin gjuhën arabe. Kjo gjë reflektonte edhe në shkencat e tjera islame, sepse librat klasikë ishin në këtë gjuhë. Kështu që myslimanët në asnjë fushë nuk po përparonin.²⁶

Siç e theksuam, këtë çështje Hafiz Ali Korça e quan çështje ontologjike për myslimanët, si në botë ashtu edhe në Shqipëri. Në qoftë se duam të jetojmë si myslimanë dhe të mbajmë fenë e Hz. Muhamedit a.s.,

25. Konferencë shkencore ndërkombëtare, *Hafiz Ali Korça – 55 vjet pas (1873-1956)*, ve. cit., f. 33.

26. <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=560>, shikuar më: 26.11.2018.

medoemos duhet të ripërtërijmë dhe reformojmë arsimin në medresetë ekzistuese. Kështu që të mundim të nxjerrim dijetarë si Fahrudin Razi, Ibn Sina, Sujuti, Gelenbeviu, Mulla Fenari, Hoxha Tahsini, etj.

Ai e kritikoi ashpër sistemin pedagogjik të medreseve të kohës, që nuk nxirrnin kuadro të afta për t'u regjistruar pa vështirësi në universitetet e ndryshme. Më tepër kritikon metodikën e mëimit të gjuhëve të huaja, sidomos metodikën e mëimit të gjuhës arabe..²⁷

Këto pikëpamje dhe mendime Hafiz Ali Korça i pati shprehur në kongresin e Dibrës, kur midis pesë pikave që i kishte propozuar komisionit, pika e parë dhe e dytë ishte për mësimdhënien e gjuhës shqipe nëpër shkolla dhe përmirësimin e programit mësimor nëpër medresetë e vendit. Këto pika komisioni i pati pranuar me kënaqësi. Më pas Hafiz Ali Korça kishte botuar edhe shumë artikuj nëpër gazetatat turke që dilnin në Stamboll atë kohë lidhur me përmirësimin e programit mësimor në të gjithë perandorinë, mirëpo, fatkeqësisht, askush nuk ia vuri veshin. Në këtë periudhë perandoria po përjetonte momente të vështira të shoqëruara me dekadencë dhe humbje territoriale, kështu që nuk ishin në gjendje të mendonin shumë lidhur me këtë problem, edhe pse ishte “problem ontologjik” për ta.

27. Dr. Ismail Ahmedi, *Hafiz Ali Korça – Jeta dhe vepra*, Logos-A, Shkup, 2006, f. 44-45.

Disa vite më pas, kur në Shqipëri ndodhej princ Vidi, Hafiz Ali Korça u emërua si drejtor i Drejtorisë Arsimore për disa rrethe ku u mundua të çelte një medrese me pikëpamje dhe program të tillë, mirëpo konservatorët fetarë e penguan, sepse nuk përputhej me metodën e tyre mësimore. Gjatë luftës së Parë botërore kur Shqipëria ishte e pushtuar nga Austro-Hungaria, H. Ali Korça emërohet Anëtar i Këshillit të Lartë të Sheriatit dhe i Besueshmi i Fetvave nga përfaqësuesi i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, August Krali. Këtë detyrë ai e zhvillonte në Shkodër dhe përveç kësaj kishte edhe detyrën e anëtarit të Komisionit të Gjuhës, bashkë me Ndre Mjedën dhe disa figura të tjera. Këto mendime H. Ali Korça ia shpalos popullit të Shkodrës dhe gjen mbështetje. Për këtë blihet toka dhe mblidhen 1000 korona nga 2000 që ishin planifikuar. Mirëpo nga disfata e Austro-Hungarisë dhe koha e luftës koronat e mbledhura u dogjën në bankë.²⁸

Hafiz Ali Korça gjithashtu mundohet që kjo medrese të njihet në nivelin e një shkollë të mesme, mirëpo shteti i atëhershëm nuk ia vuri veshin. Nga ana tjetër nga reformat e bëra në kuadrot fetare nuk gjeti mbështetje dhe kështu Hafiz Ali Korça nuk arriti të realizojë planet dhe ëndrrat e tij për këtë vend.²⁹

28. <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=560>, shikuar më: 26.11.2018.

29. <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=560>, shikuar më: 26.11.2018.

Iluminizmi dhe ndikimi te Hafiz Ali Korça

Sipas Immanuel Kantit “Iluminizmi çliron njeriun nga paaftësia e funksionimit të intelektit pa ndonjë udhërrëfyes të jashtëm. Kjo paaftësi vjen nga humbja e trimërisë dhe nga insistimi i funksionimit të intelektit pa udhërrëfyes”.³⁰

Në kuptimin më specifik iluminizmi ndërlihet me një lëvizje intelektuale në Evropë nga shekulli XVI-XVIII që beson se fuqia e arsyes njerëzore mund të kuptojë botën dhe ta udhëheqë sjelljen njerëzore. Iluminizmi shënon kulmin e skepticizmit, racionalizmit dhe empirizmit të kohës së re, rryma këto në sajë të të cilave shpirti njerëzor ka shpëtuar nga devijimet, padituria dhe paragjykimet e periudhës, të cilën filozofët francezë e quanin “mesjeta e errët”.³¹

Në planin iluminist nuk është aspak i vogël kontributi i Hafiz Ali Korçës për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe në të gjitha territoret ku flitet kjo gjuhë, natyrisht për kohën kur Turqia, jo de juro por de facto,

php?id=560, shikuar më: 26.11.2018. Rreth hapjes së kësaj medreseje në Tiranë dhe futjen e metodave moderne për atë kohë në mësimdhënie, Hafiz Ali Korça flet edhe në librin: *Rubajjati a katrorët (të Umer Khajjamit)*, Vepra 10, Logos-A, Shkup, 2006, f. 129-133.

30. Murad Vehbe, *El-Mu'xhemu El-Felsefiju*, Daru thekafetil-xhedideti, bot. 3., 1979, f. 135. Sipas: Hajredin Hoxha, *ve. cit.*, f. 176.

31. Ali Pajaziti, *Fjalor i sociologjisë*, Logos-A, Shkup, 2009, f. 256.

e ndalonte shkollën shqipe, veçmas atje ku përdorej alfabeti latin. Po Hafiz Ali Korça, thotë me të drejtë studiuesi ynë, kërkon edhe zgjerimin e rrjetit shkollor dhe reformimin e tij. Zgjerimin në aspektin e hapjes së shkollave profesionale dhe të shkollave të larta dhe reformimin në ndryshimin e plan programeve, ndryshime në metodën e mësimin të gjuhëve të huaja, në pasurimin e plan programeve me lëndë shkencore jofetare.

Në monografinë Hafiz Ali Korça, jeta dhe vepra dr. Ismail Ahmedit³², një vend të merituar i jep edhe përpjekjes së Hafiz Aliut për hapjen e shkollave fetare islame në gjuhën shqipe dhe çështjes së përpilimit të teksteve mësimore për këto shkolla, ku edhe vetë ka qenë njëri nga pedagogët që ka ligjëruar disa lëndë. Në këtë rast do të kishim përmendur Medresenë e Përgjithshme të Tiranës që shquhej për nivelin e lartë të përgatitjes shkollore të pedagogëve të saj, por edhe për lëndët nga shkencat jofetare dhe për gjuhët e huaja që mësoheshin. Nga kjo shkollë dolën shumë kadro shkencorë që me sukses i kanë kryer universitetet në Evropë dhe janë bërë shkencëtarë dhe albanologë, si Shaban Demiraj, Mahir Domi, etj. Ndër themeluesit e këtij institucioni është edhe Hafiz Ali Korça i cili dha edhe mësim dhe

32. Shih në: Dr. Ismail Ahmed, *Hafiz Ali Korça – Jeta dhe vepra*, Logos-A, Shkup, 2006.

sot shumë nxënës e mbajnë në mend si pedagogun e tyre të vyeshëm, të urtë e të dijshtëm.

Karakteristikat e kësaj filozofie ishin: Çlirimi i intelektit dhe mendjes nga besëtytnitë fetare e religjioze; çlirimi i intelektit dhe trurit nga irracionalizmi dhe metodat regresive; transferimi nga tirania politike; amoraliteti dhe tortura e përhershme në progres e përkryerje. Me zhvillimin e këtyre fuqive intelektuale, njerëzit do të mund të ecin dhe të përparojnë deri në përkryerje.³³

Përfundim

Personaliteti universal, karakteri dhe virtytet e një personi formohen në frymën e edukimit familjar, kushteve kohore dhe materiale, si dhe arsimimit të një personi të caktuar. Faktorët e përmendur, ndër të tjera, ndikuan në personalitetin e plotë të studiuesit dhe kolosit shqiptar Hafiz Ali Korça. Ai gjithë jetën ia kushtoi shërbimit të fesë dhe atdheut, për t'i ardhur në ndihmë popullit të tij dhe për të kontribuar në arsimimin e përgjithshëm fetar të shqiptarëve.

Ai gjatë gjithë jetës së tij luftoi me dije dhe zemër për një të nesërme më të mirë të popullit shqiptar në ngritjen e vetëdijes fetare e kombëtare, duke besuar se njerëzit që humbasin besimin do të humbasin edhe atdheun.

Hafiz Ali Korça hasi vështirësi në sistemin dhe rendin shoqëror të

33. Hajredin Hoxha, *ve. cit.*, f. 177-178.

atëhershëm, pothuajse gjithë jetën e tij e kaloi nën mbikëqyrjen e elitës politike dhe njerëzve në pushtet. Mirëpo, ai asnjëherë nuk u dorëzua dhe as devijoi nga rruga e drejtë, por ishte këmbëngulës në synimin dhe dashurinë ndaj rregullave fetare dhe interpretimit të mesazheve nga Kur'ani dhe hadithi i Muhamedit a.s. Dashurinë që synonte ta përcillte në mënyrën më të mirë të mundshme, në gjuhën e popullit të tij ose, më

saktë, metodologjinë me të cilën interpretonte predikimet fetare sipas rrethanave shoqërore.

Fatkeqësisht, personaliteti i Hafiz Ali Korçës, edhe sa ishte gjallë, u la nën hijen e harresës dhe u dëmtua më së shumti gjatë regjimit të dhunshëm të diktaturës komuniste në Shqipëri, një sistem famëkeq që kërkonte të zhdukte çdo gjë fetare dhe kombëtare te populli shqiptar.

Haki Sharofi

Drejtor i Medresesë së Tiranës, Drejtor i Revistës “Zani i Naltë”

Abstrakt


Haki Sharofi lindi në Dibër të Madhe, por veprimtarinë e tij si mësues, publicist dhe përkthyes e zhvilloi larg lindjes, në Gjyrash të Manastirit (1912), në Peshkopi (1914), ku hapi shkollën e parë shqipe, në Trujak dhe në Sllovë të Dibrës (1916 dhe 1920), në Kastriot (1923), në Krumë (1928), në Vlorë (1929). Pas viteve 1930, ai vendoset përfundimisht në Tiranë ku zhvillon një veprimtari të dendur, si drejtor i Medresesë së Tiranës, si drejtor i revistës “Zani i Naltë” (organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar), në krye të së cilës ai qëndroi në vitet 1930-1939.

Gjatë punës së tij në fushën e botimeve u dallua për trajtime serioze të temave me karakter fetar, social, etik dhe filozofik. Shkroi edhe shumë poezi. Në mënyrë të veçantë ka meritën për hartimin e serisë së librave “Edukatë fetare e morale”, tekste mësimore këto që u shfrytëzuan për mësimin e besimit në shkolla shtetërore, ku jepej dhe mësimi i fesë. Te librat “Edukata fetare e morale” spikasin disa kërkesa të moralit islam në kushtet tona, ku zënë vend disa parime themelore të këtij morali, të shpjeguara thjeshtë e për masat e të gjitha moshave të asaj periudhe me shtrirje të kufizuar të arsimit laik. Këto tekste kanë një ndërtim dhe strukturë delikate shumë të përshtatshme për kohën që u botuan. Duke u nisur nga këto vlera, biblioteka myslimane shqiptare e Miçiganit (SHBA) i ka ribotuar ato kohët e fundit.

Haki Sharofi në vitet e fundit të jetës së tij ka bashkëpunuar me Arkivin Qendror të Shtetit dhe Arkivin e Institutit të Historisë, duke dhënë një kontribut të vyer në përkthimin e dokumenteve me rëndësi historike, që ishin në gjuhët e lindjes: arabe, turke dhe perse. Ai ka lënë një trashëgimi të pasur me përkthime, siç janë: “Tefsiri shqip”, “Parimet e nalta të Islamit”, “Ajete të Kur’anit”, etj.

Haki Sharofi, “Mësuesi i Popullit”, është një personalitet i shquar i kombit tonë. Ai lindi në Dibër të Madhe më 1894 dhe vdiq në Tiranë më 1977. Veprimtarinë e tij si mësues, publicist dhe përkthyes e zhvilloi larg lindjes, në Gjyrash të Manastirit (1912), në Peshkopi (1914), ku hapi shkollën e parë shqipe, në Trujak dhe në Sllovë të Dibrës (1916 dhe 1920), në Kastriot (1923), në Krumë (1928), në Vlorë (1929). Pas viteve 1930, ai vendoset përfundimisht në Tiranë ku zhvillon një veprimtari të dendur, si drejtor i Medresesë së Tiranës, si drejtor i revistës “Zani i Naltë”, etj. Ai studioi në normalen e Elbasanit si dhe kishte ndjekur shkollën pedagogjike “Darul-Mualiminë” të Dibrës.

Për 63 vjet me radhë Haki Sharofi kontribuoi në disa fusha të jetës shqiptare. Hulumtuesit e paktë të veprimtarisë së gjerë dhe shumëplanëshe të tij, që, deri më sot, kanë arritur të prekin vetëm një pjesë të vogël të saj, janë mrekulluar nga vlerat e mëdha që ajo përmban. Dijet dhe energjia e tij më të shumta Haku i derdhi në fushën e mësuesisë, sepse mendonte ai, populli dhe vendi kishin shumë nevojë për t’u arsimuar. Misionin e mësuesit-edukator ai e nisi qysh në rininë e hershme, duke u mësuar gjuhën amtare bashkëqytetarëve dibranë dhe vazhdoi gjer në pleqëri, duke u mësuar osmanisht punonjësve



shkencorë të Arkivit Qendror të Shtetit. Për shumë vite ai qe pedagog dhe drejtor i Medresesë së përgjithshme në Tiranë, ku u shqua si organizator i punëve të shkollës, si mësimsdhënës dhe si edukator i talentuar. Si teolog islam me kulturë të gjerë dhe i emancipuar, Haku dha ndihmesë të madhe nëpërmjet shkrimeve të shumta, për formimin me dituri kur’anore-shkencore të besimtarëve myslimanë shqiptarë, duke luftuar njëherësh përmes këtyre shkrimeve origjinale apo përkthimeve çrrënjësive e fanatizmit dhe të paragjykimeve, që kishin zënë vend në mendjet e shumë njerëzve, për t’i bërë të qëndrueshme parimet dhe të vërtetat e fesë islame te besimtarët, ai kërkonte që Kur’ani të përkthehej shqip në mënyrë që lexuesit ta kuptonin, ta ndjenin dhe ta besonin me ndërgjegje. Haku dhe

ndihmesë me fjalë e shkrime që në Shqipëri të lulëzonte sa më shumë harmonia ndërjetare.

Për dhjetë vjet radhazi, 1930-1939, ai kreu me shumë sukses detyrën e rëndësishme të drejtorit përgjegjës të revistës “Zani i Naltë”, organi i Komunitetit Mysliman Shqiptar. Kjo revistë dinjitoze u dallua gjithmonë në shtypin e kohës si një tribunë e rëndësishme ku shpaloseshin jo vetëm dituria dhe kultura islame, por edhe probleme nga më të ndryshmet për të gjitha fushat që shqetësonin shoqërinë shqiptare. Në faqet e saj shkruan dhe diskutuan pena të shquara të mendimit dhe të kulturës shqiptare të atyre viteve dhe për këtë Haki Sharofi ka një meritë të veçantë.

Gjatë punës së tij në fushën e botimeve u dallua për trajtime serioze të temave me karakter fetar, social, etik dhe filozofik. Shkroi edhe shumë poezi. Në mënyrë të veçantë ka meritën për hartimin e serisë së librave “Edukatë fetare e morale”, tekste mësimore këto që u shfrytëzuan për mësimin e besimit në shkolla shtetërore, ku jepej dhe mësimi i fesë. Te librat “Edukata fetare e morale” spikasin disa kërkesa të moralit islam në kushtet tona, ku zënë vend disa parime themelore të këtij morali, të shpjeguara thjeshtë e për masat e të gjitha moshave të asaj periudhe me shtrirje të kufizuar të arsimit laik. Këto tekste kanë një ndërtim dhe strukturë delikate shumë të përshtatshme për kohën që u botuan. Duke u nisur

nga këto vlera, biblioteka myslimane shqiptare e Miçiganit (SHBA) i ka ribotuar ato kohët e fundit.

Krahas veprave të mësipërme, duhet shënuar se edhe “Kalendari mysliman”, që u botua për disa vite me radhë është vepër e tij.

Haki Sharofi në vitet e fundit të jetës së tij ka bashkëpunuar me Arkivin Qendror të Shtetit dhe Arkivin e Institutit të Historisë, duke dhënë një kontribut të vyer në përkthimin e dokumenteve me rëndësi historike, që ishin në gjuhët e lindjes: arabe, turke dhe perse. Ai ka lënë një trashëgimi të pasur me përkthime, siç janë: “Tefsiri shqip”, “Parimet e nalta të Islamit”, “Ajetet të Kur’anit” etj.¹

Hakui ka shprehur mendim mjaft interesante për detyrat dhe rolin e shtypit, të cilat i ruajnë vlerat dhe sot. Në gazetën “Besa”, 5 korrik 1931, ndër të tjera ai shkruan: “Shtypi është si syri i mjekut. Ai sheh shumë larg, sheh plagët e popullit më të izoluar nga shoqëria dhe nga mjetet e lumturisë, sheh mjerimin e kombit... I kontrollon këto plagë e pastaj studion mënyrën e shërimit të tyre, të cilën nga një anë ua parashtron kompetencave për të marrë masat, në anën tjetër, ia vë përpara opinionit publik për ta gjykuar ashtu siç bëjnë mjekët kur konsultojnë ndonjë të sëmurë. Shtypi, pra, është pasqyra në të cilën populli sheh nevojat e veta, ashtu siç ‘sheh i sëmurit organet e veta në rëntgen’”.

1. Për më tepër shih: gazeta “Drita Islame”, nr. 7, 1992: 5.

Më tej ai skicon figurën e njeriut të popullit që do t'i bëjë këto punë, gazetarit: "Gazetar d.m.th. luftëtar i hedhur në një fushë të rrezikshme, që do të luftojë injorancën, do të luftojë me idetë e gabuara, do të luftojë me veset e rrezikshme. Ai do t'i gjykojë ngjarjet ashtu siç janë e jo siç duken, do t'i japë dritë popullit që të dallojë të drejtën nga e shtrembra, ai do të flasë shumë herë edhe kundër miqve të tij të ngushtë, do të sakrifikojë shpeshherë edhe rivalët e tij e kështu mund t'i rrëshqasë ndonjë gabim, që mund ta përcjellë në postat e gjykatores e ta prezantojë përpara ligjit.

Gazetaria ka këto përfundime, por gazetari nuk duhet të tronditet, shpirti i tij do të jetë i gjallë, i pa vyshkur, aktiv dhe i patundur; ai do të ndjekë vetëm idealin që i ka vënë vetes, të transformojë një popull të mbetur prapa në një popull të qytetëruar e të përparuar.

Këtë karakter duhet ta ketë çdo gazetar. Interesi publik është më i shenjtë se interesi privat."

Haki Sharofi qe një orientalist i mbaruar dhe jo vetëm një përkthyes i thjeshtë nga osmanishtja. Ai dha ndihmesë të madhe në fushën e hulumtimeve dhe të studimeve të krijimtarisë letrare të autorëve shqiptarë të shek. XVIII-XIX, që shkruan me alfabet turk-arab.

Kontributi i tij në orientalistikë është një thesar i vërtetë që duhet bërë i njohur. Në revistën "Zani i

Naltë" u botuan herë pas here vjersha e krijime letrare të panjohura të këtyre autorëve si dhe analiza e vlerësime të Hakiut për ta.

Në arsenalin e veprimtarisë së tij si studiues duhet nënvizuar fakti se ai i qëndroi besnik gjithnjë parimit të paanshmërisë dhe objektivitetit shkencor të vlerësimit të proceseve historike apo letrare, ngjarjeve dhe veprimtarive, pjesëmarrësve në to, etj.

Në sajë të punës së tij ngulmuese për hulumtimin dhe studimin e shkrimeve të ndryshme, u bë e mundur të hidhej më shumë dritë mbi jetën dhe veprën e Nesim Berati (Frakullës), Hasan Zyko Kamberit, Ismail Floqit dhe shumë shkrimtarëve të tjerë të këtij grupimi, tek të cilët spikasin përveç vlerave islame edhe ato laike, si vargjet kundër padrejtësisë shoqërore, vargjet për natyrën, për dashurinë, etj.

Jeta e këtij njeriu qe e mbushur çdo ditë me punë. Ai kaloi një jetë private të thjeshtë dhe lidhi marrëdhënie të pastra me të gjithë njerëzit me të cilët iu desh të jetonte e të punonte.

Mjerisht gjatë viteve të sistemit komunist puna e tij prej dijetari atdhetar nuk u vlerësua, madje shihej shtrembër si intelektual mysliman që ishte.²

2. Marrë nga "100 personalitete shqiptare të kulturës islame", Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2015, f. 54; "Haki Sharofi – Njeriu dhe njerëzimi", biblioteka "Haki Sharofi", Tiranë, 2018, f. 10-12.

Randsi e martesës

Ferit Vokopola

Abstrakt

Ç'është pra martesja? A vetëm një detyrë natyrale? A po njerëzore edhe sociale? Mbase njeriu me ndërgjegjen qi ka ndodhet i ngarkuëm me ca detyra q'u përkasin edhe të tjerve natyrisht martesja është një detyrë njerëzore edhe sociale; dashunia e Prindëvet kundrejtë të pjellunve të t'ynë në mënyren më të dhimsbëme ka qenë e rënjosur në shpirtin e njeriut qi ditën e krijimit. Kjo dashuni e dhimsunië ka krijuë bazën e bashkë-rrojtjes, e mprojtjen kundrejt egërsinave të Natyrës. Shtazët e tjerë mbase nuk e kanë ketë dhimsuni e dashtuni kaqi sa njeriu nuk janë të shtrenguë me ligjë të vueme me mbajtur rregullimin e jetës së tyne.

Sosieteja, nuk mund të rronjë kurrë pa qenë jeta familjare, por kjo bazën e vetë e ka të ngrefun me kushtet e martesës... dhe me të vertet po të mejtohemi pakë me pa anësi nuk është e mundun qi mos t'a pobjmë se fatbardhësia e vertet dhe e qendrushme, nuk mund të gjindet kurrë për njerin për veç se në Jetët familjare e cilla i detyrohet kryekëput martesës.

Ku do qi kthejmë sytë rreth gjanavet të ndodhuna me një herë na çfaqet një e vertetë: randësi e martesës, shtjem sytë mbi shpresët, një fuqië natyrale qi e shohim qi këto i martoni dhe i shtonë për vazhdimin e farës tyne; shtazët, dhe këta prap t'udhëhequn nga kjo fuqië e dimë qi janë tue aplikuë me besnikrië nenet e pa shkruëme të këtij Ligjit naturelë.

Po bimërat, e lulet; po fluturat e bukura qi fluturojnë mbi to!

Si është e mundun pa një marrë-dhanëje shkëmbimtare të mprojnë racën e llojin e tyne! E dashuna Naturë! Si mbase ligjit të famshëm qi të ka falun Krijuesi i vertetë sa mrekullisht je tue vazhduë në harmonin tande të kandëshme dhe të rregullshëm! Lulevet me dritën e vesen e mengjezit, me rrezet e Hanës u fale ambëlsinën e mjaltit; fluturat e bletët i shtyte të shijojmë atë huallë t'ushqimshëm për vehte por ndëmjetësuër për martesën e luleve

njena me tjetrën. Ti marton afshin avullin dhe krijon rênë, me ererat e ndryshme ku rrezonë gjethet në Vjeshtë pajosë tokën me plehurina të gjallshime për krijimin e bimës së ré. Me ererat bumbenë retë n'ujë, atë e ngref n'ajr dhe lëshon shinë kû âsht nevoja!

Ç'do lëvizje e dukshme dhe e pa pikasun n'âsht qi pjellë para teje një ndryshim, ky po bâhet në vazhdimë të martesës së fuqinave njena me tjetrën; edhe lëmshënjt e hapësirës në lëvizjet e tyne madhështore janë tue u krijuë, rrëmuë, e u shuë vetëm me marrëdhanjet shkëmbimtare të cilat pa dyshim në trajtën e martesës janë tue përplotësue qëllimin kryesuër së fuqisë Krijuëse.

Po njeriu vallë, a âsht fije për fije si këto? Ky i udhëhequn nga ligji i naturës a mjaftonë të martohet si shtëhëe e si bimrat, si gjith fuqinat pa qenë i lidhun në ligjë jo vetëm materjale por edhe shpirtënore! Kjo problemë në shekujt e kaluëm si edhe sot midis shumë dijetarëve ka shkaktuë dyshimin i cilli me të vërtetë si një sëmundje ngjitarake âsht tue përhapun peginjet damtuëse mbi bazat e qytetnimit.

Ç'âsht pra martesë? A vetëm një detyrë natyrale? A po njerzënore edhe sociale? Mbas njeriu me ndërgegjen qi ka ndodhet i ngarkuëm me ca detyra q'u përkasin edhe të tjerve naturisht martesë âsht një detyrë njerzënore edhe sociale; dashunia e Prindëvet kundrejtë të

pjellunve të t'ynë në mënyren mâ të dhimshëme ka qenë e rênjosur në shpirtin e njeriut qi ditën e krijimit. Kjo dashuni e dhimsunië ka krijuë bazën e bashkë-rrojtjes, e mprojtjen kundrejt egërsinave të Natyrës. Shtazët e tjerë mbasi nuk e kanë ketë dhimsuni e dashtuni kaqi sa njeriu nuk janë të shtrenguë me ligjë të vueme me mbajtun rregullimin e jetës së tyne.

Sosieteja, nuk mund të rronjë kurrë pa qenë jeta familjare, por kjo bazën e vetë e ka të ngrefun me kushtet e martesës. Ndodhën shumë të ditun të rinjë qi thonë: Njerzit tue formue një trup socialë mundet të rrojnë pa formue jetën familjare të cilët shembëll tregojnë ca sekte, kabile¹ të pa qytetërueme tue mos barazue se këta t'egër deri dikuë mund të kenë marëdhanje me Historin dhe kohën e kalueme të njerëzimit.

Këto janë teorina të thata, allusionë e andralle jo vetëm të pa dobishme por edhe shumë të rrezikshme për qytetnimin. Po të mejtohem rreth kushteve të Jetës së sotshme qi pështetet sosieteja njerënore pa dyshim bindemi se qytetnimi pa jetën familjare pa martesë nuk mund të jetë i forcuëm dhe i vazhduëm.

Jeta familjare fillonë me fjalën e besën qi lidhin midis tyne – në bazë të ligjit – një i rî me një të rê,

1. Kabile: fis-fise (fjalë e gjuhës arabe), shënim i redaksisë.

themelohet në martesën e këtyne qi thuret e stoliset me fletët, lulet e dashunisë së vërtetë.

Jeta familjare është një traktat social me kushte morale e materiale aqi të randa sa sicilli prej kontraktuesave për me sigurue fatbardhësin duhet me qenë respektuës e adhuruës fije pë fije në vazhdim të kohës dhe afatit të sajë. Per me qenë të lirë të larguemit nga martesja është një dam i madhë për një atdhe edhe për jetën sociale. Profeti i Naltë Muhamedi ka pas thanë:

شراركم عزابكم

“Ndër muslimanë mâ të këqijët fatzezë janë ata qi nuk martohen.”

تناكحوا تكاثروا فإني أباهي بكم
الأمم يوم القيامة.

“Kunorzohuni; shtohuni se me shtuarjen tuej para popujve të tjerë kam me u nderuë në Kijamet.”

Me të vërtetë aji njeri qi nuk është bamun kryetari i një familjes nuk mund të quhet i plotë; në kohrat e vjetra ata njerëz qi nuk kishin fitue ketë nderë nuk i përdornin as në detyrë me randsi; martesja sa mâ tepër në kohën e rinisë është një detyrë dhe një fatbardhësi, një dobijë morale për marrëvajtjen e njerzimit, një shtegtim i domosdoshëm për vazhdimin e qytetnimit.

Asht një fatbardhësi themë; po edhe jemi gati t’a vertetojmë se një jetë e ambël qi realizohet në jetën e përbashkët familjare i kanonë të gjitha dashunitë e pa lidhje e gati të çthuruna me një frymë ftoftësije.

Nuk mundë të ket qendrim kurr një dashuni e zbërdhuqun, një amor i pa pështetun me një mbesim shpirtënuër. Prudhoni ka pas thanë: “Për me pasun burr e gruë qetësin e dishirueme, për me gjetun gëzimin, dhe për me formue një familje të vërtetë me doemos kundrejt njeni tjetrit duhte t’ushqejnë një mbesim martesuër. Se pa ketë nuk është e mundun lidhënia e sinqertë. Me fjalën mbesim martesuër kemi per qellim mëndimin e pastër qi naltonë burrin e grunë sipër ndjenjave shtazor dhe q’i nderonë kundrejt njeni tjetrit. Me ketë maredhanëjet martesore mâ tepër se dashunia lidhen në një perulje shpirtënore.”

Paul de Meri thotë: “Një dashunië e tillë nga detyrat qi të ngarkon, nga jeta e rë qi pregatit për naltim pjellë një amor të këthellët e t’ambël, sa njeriu ketë pa u druajtun; pa u shtërnguë e pohonë vetë. Një burrë i rî e një gruë e rë veç kujtimeve t’orvet t’ambëlta qi kalojnë në jetën martesore nuk harrojnë kurrë fillimin plotë gëzime të rrugës së përbashkët por kujtojnë kurdoherë edhe distancat qi do të matin në jetën e ardhëme.”

Sa bukur ka pas thanë Victor Hugo-ja për të dashmen:

“Lorsqu’ en ajoutant votre âge à mon âge,

Nous ne comptons pas à deux quarante ans,

Et que, dans notre humble e petit menage,

Tout, même l'hiver, nous était printemps?"

“Kur tue mbledhun vjeçët e tua me të mijat shuma nuk kapte të dyzetat në kësollën t'onë ç'do gjâ edhe dimni na dukesh si prandvera.”. Dhe me të vertet po të mejtohem i pakë me pa anësi nuk âsht e mundun

qi mos t'a pohojmë se fatbardhësia e vertet dhe e qendrushme, nuk mund të gjindet kurrë për njerin për veç se në Jetët familjare e cilla i detyrohet kryekëput martesës.²

2. Marrë nga revista “Zani i Naltë”, nr. 6, viti 4, janar 1927, f. 182-185.

Abstracts in English no. 38

Editorial

1. On the occasion of the 100th anniversary of the Madrasah of Tirana MSc. Ndrëçim Gjimi, Director of Tirana Madrasa

Despite the challenges and changes in its 100-year path, the Madrasa of Tirana has remained a center of higher education and conscious of the needs of its society. Today it functions as a general high school, currently with 329 students, of which 75 are in lower secondary education and the rest are in upper secondary education. Since accommodation is offered as a service, students come from all over Albania, making it a hotbed where different cultures merge to create an amalgamated culture that characterizes every student who acquires it. The school has a modern infrastructure, with digital classrooms, all relevant laboratories, sports halls, multimedia halls and a conference hall. Students who graduate from this school, at the end of their education, are able to compete in all institutions of higher education, inside and outside the country... The success of this school has become a tradition; making it among the most special schools, both in terms of teaching quality and student achievement.

This 100th anniversary marks an important moment to reflect on the great contribution of the Madrasah of Tirana to Albanian history and education, as well as to express respect and appreciation for all those who have worked and contributed to this institution over the decades.

Philosophy

2. In the Beginning was Consciousness Seyyed Hossein Nasr

How we view the nature of reality has a direct bearing upon how we live as human beings. For millennia human beings lived in a universe dominated by the idea of the primacy of consciousness over all that is corporeal and material. They fought wars and there was disease but they lived in a world of meaning and beauty. They created traditional arts of surpassing beauty and lived, to a large extent, in harmony and peace with their natural environment. They knew who they were, where they came from and where they were going. The denial of the supremacy and primacy of consciousness and the substitution of a materialistic reductionism in its place, has given human beings greater domination over nature and certain earthly comforts while, needless to say, creating new discomforts. It has cured many diseases while opening the door to diseases unknown before. And it has been defended as being a way to peace while making possible wars with a degree of violence and lethal effects not imagined in days of old. But most of all it has destroyed the harmonious relation not only between man and God and the spiritual world but also between man and nature by permitting the creation of a science based not on wisdom but on power and its applications as a new technology which has the capability of destroying the very order of life on earth. On the individual level, it has taken away from human beings the ultimate meaning of life and destroyed the home which they considered the universe to

be, making human beings aliens within a world view constructed by human minds.

By denying the primacy of consciousness, modern materialism has also cast doubt on the reality of the immortality of the human soul and the afterlife... Besides the most tragic consequences for the human soul who denies such realities, the weakening of belief in eternal life also has a direct consequence on how we live in this world and more particularly, upon the destruction of the natural environment. If life on this earth is the only life we have, then we should do everything possible to live a worldly life as fully as possible.

Were we to accept the truth that “in the beginning was consciousness” and that “it is now as it was at the beginning,” we would no longer feel as aliens in a dead and forbidding cosmos, as accidents in a lifeless universe... Our rapport with animals, plants and even the inanimate world would change from one of strife and need for control and domination to one of harmony and equilibrium with a much greater possibility of intimacy with more human beings than the current mind-set makes possible.

Studies

3. 100 years Madrasa of Tirana (1924 - 2024)

MSc. Dorian Demetja

The idea of opening a madrasah posed the need to review methods, design teaching programs and define objectives for the education of students with religious and national feelings. The madrasah wasn't opened in a day; it took a lot of effort, many talks, many

issues had to be resolved, including financial issues, pedagogical personnel, the learning environment, didactic teaching literature, etc. had to be provided. The initiators, the flag bearers and then the initiators of this movement to advance the problem, became those who had studied in advanced schools of the Islamic world or who had given lectures in these schools as teachers and pedagogues. Special authors presented the personal experience of how a madrasa could be founded in the service of Islam, in the service of the Motherland.

The High Madrasah in Tirana was opened on 01.03.1924 by the decision of the First Congress of Albanian Muslims and with the permission of the Ministry of Education N. 105/1, dated 25.02.1924, to meet the needs for religious staff. This Islamic school was opened with an all-Albanian staff and the expenses for its progress were covered by the income of the Muslim Community of Albania.

Within a few years, the General Madrasah of Tirana formed its physiognomy as a serious institution, where a sound religious and national formation was received. From the beginning, she worked on the basis of a contemporary level curriculum.

From the communist regime, like religion and faith in general, the Madrasa of Tirana was hit with increasing severity, starting with the educational reform of 1946, which significantly limited religious subjects. The communist government imposed with a special decision a curriculum, which deeply affected its physiognomy and content. The Ministry of Education gradually tried to move the school curriculum towards secularism.

According to decision no. 1 dt. 22.08.1964 of the General Council, the Madrasah of Tirana is permanently closed for strong budgetary reasons and that for now there are plenty of staff. A strong blow was given to the Muslim Community, when on December 27, 1965, the building of the Tirana Madrasa was confiscated by the state without any explanation, being handed over to the Faculty of Medicine, Dentistry branch, a situation which continued even after the country transitioned to a democratic regime. This atheistic spirit continued until 1990.

In the letter of the Muslim Community of Albania dated 10.10.1991, number 1 of the protocol, addressed to the Mufti of Tirana, H. Sabri Koçi quotes: "With the decision taken by this Community, it has been decided that the school of secondary MADRASA named 'Haxhi Mahmud Dashi'. The personnel who will teach general culture will be provided with a salary by this Community based on the hours and norms in force for general education."

4. The role of schools in the development of Albanian education **Mr. Habib Ebibi**

Mektebs (various teachings given in mosques), during historical periods, had a very important role, they were in the category or level of today's primary schools. After the fall of the Ottoman Empire, and the formation of states in republics, public schools of the lower

cycle, in many Islamic countries, replaced the mektebs. In mektebs, Muslim children have learned to read the Qur'an, they have learned the basic principles of the Islamic religion; the conditions of the Islamic religion, the conditions of faith, the way of performing ablution, the way of praying, etc.

These educational institutions, usually, were built near mosques. In them, the religious teacher was engaged in teaching the children the reading of the Qur'an and the most basic things of the Islamic religion.

Sociology

5. The treatment of family issues in the newspaper “Drita Islame” (1992-2011) in the educational aspect **MSc. Migena Jani**

In recent years, an increase in the number of divorces, abandoned children, an increase in family violence, an increase in the level of conflicts between family members, a weakening of the socializing role of the family, a lack of education of values and virtues in children has been observed. We see a shaking of the foundations of the ‘small state’, which continues to lose its purpose and main functions.

This destruction and damage to the family is influenced by two main factors: the lack of education of children in the family with moral and religious values in the family institution and by the great influence of the social environment on the family.

The purpose of the research is to prove that we will deal with influence, which has a precious treasure such as the newspaper and magazine “Drita Islame”, which has played and is playing an enlightening missionary role in dealing with family issues. The questions raised about how religious education strengthens the family and how big the role of the family remains in the education of children received the right answers. The hypothesis that the periodical “Drita Islame” has played a very important role in dealing with family issues in terms of education, psychology, sociology etc., was proven very accurately.

The scientific-research work has used qualitative methodology, based on the treatment of family issues in the light of Quranic verses, the prophetic tradition treated in “Islamic Light” (1992-2017), columns which are guides for a family of strong, which is based on traditional moral and religious values and virtues, which are reinforced even now.

Key words: Albanian family, parenting, moral-religious, Quranic verses, prophetic tradition, “small state”

6. The influence of the language of religion on social change **Prof. dr. Muhammad Mustafi, Faculty of Islamic Sciences in** **Skopje**

Social changes are the result of different factors, which influence directly or indirectly in different directions.

One of the important factors that change opinions and worldviews is religion, through its language.

The language of religion can form a convenient and suitable space for people, regardless of their affiliation, or it can negatively affect and create the opinion of mutual hatred between different people, ethnicities or peoples.

The language of religion is considered an important part of the formation of close social ties, if it is practiced with special wisdom and care, if it does not offend anyone and if it does not rely on the principle of overvaluation.

Thus, the positive language of religion opens the doors to a wider social communication at various local and global levels. Using negative language will narrow life and offer difficult and limited cooperation.

This type of language affects vital social changes, which can lead to social freedom and general understanding in all spheres of life, regardless of the political spirit that exists in society, because these connections will be the result of a more broad and universal.

Key words: Language, religion, influence, society, changes.

Jurisprudence

7. Albanian legislation regarding the Muslim Community, in the years 1944-1967

Dr. Denald Prifti, Historian, author in the field of publications on religions and propaganda

The Communist Party created a completely different situation for religious communities, and in the first years of government gave the impression of a regime that respected and guaranteed the implementation of democratic standards in the field of faith and freedom of conscience. "He - the government - created this impression by relying on two factors: First, it was based on two important legal documents, the Declaration of Human and Citizen's Rights, approved at the II Meeting of the KANÇ in Berat (October 1944) and, most importantly, in the Constitution of the People's Republic of Albania of 1946..."

The legal policies followed by the Albanian state in the years 1944-1990 were not the same as the previous policies followed by Ahmet Zogu in the period 1925-1939. The state

power aimed at the realization of the objectives set by itself. It is known that at that time the freedom of religion and belief was not at the right levels. The relationship between religious institutions and those of the state began to be dominated by political power. Relations were getting more and more difficult, both 'de jure' and 'de facto'. Power, more and more, extended its influence and dominance, leaving no separation of religion from the influence of power. In terms of freedom of conscience and belief, as well as the exercise of religion, serious violations are observed in many cases.

In actual practice, however, the new Albanian regime sought to destroy the role and influence of religion and national religious organizations. During 1945 and 1946 the state outlawed religious education and closed down the remaining private religious schools; religious institutions lost their right to hold land by the Agrarian Reform Law of 1946; all religious publications and communications, including sermons, had to be reviewed and approved by state authorities before they were given to the public; as well as the youth of the nation were encouraged not to participate in religious services and activities.

Islamic jurisprudence

8. Polygamy in history and Islamic perspective

Prof. dr. Bekir Topaloglu

Marrying more than one wife, two, three or four, in Islam, is not a fard obligation or a wajib command, but it is a permission for people to get away from immorality. However, even this permission is conditional on opportunities and justice. The Qur'anic verse (Nisa', 4:3) explains to us that in marriage it is important to be satisfied with one woman, emphasizing that marriage with one woman is closer to the fulfillment of rights.

Let us remind you that in Islamic law, a woman has the right to ask her husband not to marry another woman, as long as she is married to him. After the act that will be performed legally, the agreement that will be made will be active, and if it prevents the man from remarrying, and in the meantime he marries, the first wife has the right to divorce. In a hadith it is said: "The condition you most deserve to fulfill is the one you accepted during the coronation."

In this case, the woman in polygamy will have the right to vote. The spiritual damages due to them will be eliminated. In many countries of the world polygamy does not officially exist. But, in fact, it continues to spread. For this reason, different laws are introduced from time to time to determine the origin of children according to the legal system.

In the end, it can be said that Islam has approved polygamy due to some necessity. If humanity still does not know the benefit of polygamy and does not approve of it, it cannot be said that one day, after various experiences, it will not approve of it.

History

9. The influence of reformism and enlightenment on Hafiz Ali Korça Dr. Azmir Yusufi

Certain circumstances are a decisive factor in the formation of outstanding personalities, whose role and importance is undeniable and their work is universal. Such elements are found in the history books of all nations, whose pages are full of important figures who mark a certain era, such as patriots, heroes, giants and reformers.

The reformist spirit and the change of consciousness begins with the mental revolution of an individual or a group that tries to raise the consciousness of its society. The same thought must be inspired, because inspiration is the spiritual driver of man, while the reforming spirit is nourished by ideological, artistic and religious convictions.

Hafiz Ali Korça expanded his intellectual activity, apart from that in the field of the Albanian alphabet, also in another field, when he was appointed a member of the "Literary Committee" where together with the veterans: Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Mati Logoreci and Sali Nivica, worked with dedication in the field of linguistics. In this Commission, Hafiz Ali's contribution to the purity of the Albanian language from foreign words is undeniable.

His political and educational views are a natural result of the National Movement, which was felt from the middle of the XIX century, and which took on greater proportions in the 20-30s of the XX century.

Personality

10. Haki Sharofi, Director of Tirana Madrasah and "Zani i Naltë" Magazine

Haki Sharofi was born in Dibër i Madhe, but he developed his activity as a teacher, publicist and translator far from his birth. After the 1930s, he finally settled in Tirana where he developed a dense activity, as the director of the Tirana Madrasah, as the director of the magazine "Zani i Naltë" (organ of the Albanian Muslim Community), at the head of which he remained from 1930 until 1939.

During his work in the field of publications, he was distinguished for his serious treatment of religious, social, ethical and philosophical topics. He also wrote many poems. In particular, he has the merit for drafting the series of books "Religious and Moral Education", textbooks that were used for the teaching of faith in state schools, where religion was also taught. In the books "Religious and moral education", some requirements

of Islamic morality stand out in our conditions, where some basic principles of this morality take place, explained simply and for the masses of all ages of that period with a limited scope of secular education. These texts have a subtle construction and structure very appropriate for the time they were published. Based on these values, the Muslim Albanian Library of Michigan (USA) has recently republished them.

In the last years of his life, Haki Sharofi collaborated with the Central State Archive and the Archive of the Institute of History, making a significant contribution to the translation of documents of historical importance, which were in the Eastern languages: Arabic, Turkish and Persian. He has left a rich heritage with translations, such as “Albanian Tafsir”, “High Principles of Islam”, “Verses of the Qur’an”, etc.

Retrospective

11. The importance of marriage

Ferit Vokopola

What is marriage? Is it only a natural or human and social duty? After all, man, with the conscience he has, is charged with some duties that also belong to others. Of course, marriage is a human and social duty; the love of Parents towards their offspring in the most painful way has been rooted in the soul of man since the day of creation. This love and compassion has created the basis of coexistence and protection against the savagery of Nature. Animals, since they do not have such marked compassion and love as man, are not bound by established laws to keep their lives in order.

Society can never live without the existence of family life, but this has its basis raised with the conditions of marriage... and really, if we think a little impartially, we come to the conclusion that it is not possible for us to not assert that true and lasting happiness can never be found for man except in Family Life, which is mainly due to marriage.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikulli duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.

